

# BIZNES PLANI STRATEGJIK

Departamenti i Zhvillimit te Biznesit



## PËRMBAJTJA

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
2.	ANALIZA E SITUATËS AKTUALE .....	3
2.1	Situata aktuale e sektorit energjetik.....	3
2.1.1	Situata makroekonomike.....	3
2.1.2	Sektori i energjisë.....	3
3.	HISTORIK I KOMPANISË .....	5
3.1	Pronësia dhe lloji i drejtimit të kompanisë.....	6
3.2	Struktura Aktuale e Sistemit të Shpërndarjes .....	7
4.	KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	9
4.1	Struktura e konsumit të energjisë elektrike .....	9
4.2	Profili i konsumit të energjisë elektrike.....	9
5.	TREGU I SEKTORIT ENERGJETIK.....	10
5.1	Modeli ekzistues i tregut në sektorin e energjisë .....	10
5.2	Importi i energjisë elektrike.....	11
5.3	Efiçenca e tregimit të energjisë elektrike .....	11
5.4	Modeli i tregut sipas ligjit të ri dhe sfidat e sektorit.....	11
5.4.1	Modeli i tregut .....	11
6.	PJESËMARRËSIT E TREGUT NË SEKTORIN E ENERGJISË .....	11
6.1	Enti rregullator i energjisë (ERE) .....	12
6.2	Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST).....	12
6.3	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.....	13
6.4	Prodhuesit.....	14
6.5	Klientët.....	15
6.5.1	Klientët fundorë.....	15
6.5.2	Klientët në nevojë.....	15
6.5.3	Klientët familjarë/klientët e vegjël jo familjarë .....	15
6.5.4	Klientët e shumicës .....	15
6.6	Furnizuesit .....	15
6.7	Operatori i pavarur i matjes .....	15
7.	ANALIZA SWOT DHE SFIDAT E SEKTORIT.....	16
7.1	Analiza SWOT e sistemit/operatorit të shpërndarjes .....	16
7.1.1	Pikat e dobëta .....	16
7.1.2	Pikat e forta.....	16
7.1.3	Oportunitete .....	16
7.1.4	Kërcënime.....	16
7.1.5	Masat për përmirësimin e situatës ekzistuese .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2	Sfidat e sektorit .....	17
8.	PROBLEMET E VËREJTURA KUNDREJT KONSUMATORIT .....	18
9.	SITUATA E SYNUAR.....	23
9.1	Vizioni .....	23
9.2	Misioni.....	23
10.	OBJEKTIVAT.....	23
10.1	Objektivat strategjikë.....	23
10.2	Objektivat bazikë.....	23
10.2.1	Sigurimi i cilësisë në shërbimin ndaj klientit.....	23
10.2.2	Reduktimi i humbjeve, rritja e efikasitetit të energjisë .....	24
10.2.3	Plotësimi me fleksibilitet i nevojave për energji.....	24
10.2.4	Tranzicioni i kontrolluar i procesit të liberalizimit të tregut energjetik.....	25
10.2.5	Përmirësim i vazhdueshëm i performancës së kompanisë .....	25
11.	STANDARTET E PERFORMANCËS NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES .....	25
11.1	Fusha e aplikimit .....	25

11.2	Atributet dhe kompetencat .....	25
11.3	Treguesit kryesorë të performancës .....	26
11.3.1	Ndërprerjet e furnizimit me energji Elektrike – ndërprerjet aksidentale .....	26
11.3.2	Siguria e furnizimit.....	26
11.3.3	Llojet e ndërprerjeve .....	26
11.4	Treguesit vjetorë .....	27
11.4.1	Treguesit vjetorë të performancës sipas niveleve të tensionit .....	27
11.4.2	Treguesit vjetorë lidhur me ankimet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes .....	27
11.4.3	Treguesit e Vazhdimësisë së Shërbimit .....	27
11.4.4	Treguesit vjetorë tregtarë të performancës.....	27
12.	PLANI I PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS .....	28
12.1	Objektivat për periudhën 2016-2020 .....	28
15.	PARASHIKIMET FINANCIARE 2015 – 2020 .....	32
15.1	Nevoja dhe mundësitë për investime dhe kostot e mirëmbajtjes .....	32
14.2	Supozimet bazë .....	33
14.3	Parashikimet e shitjeve .....	34
14.4	Faktorë të rëndësishëm për t’u konsideruar .....	37
14.5	Projektet madhore të investimit .....	38
15.	MEKANIZMI I MONITORIMIT TË BIZNES PLANIT STRATEGJIK.....	40
15.1	RAPORTIMI .....	42
15.2	MASAT KORRIGJUESE.....	42
	PASQYRA E LENDES .....	44
I.	PARATHËNIE .....	44
	OBJEKTIVAT BAZIKË/OPERACIONAL E VITIT XXXX .....	44
	SHTYLLA/ OBJEKTIVI STRATEGJIK 1 .....	44
	SHTYLLA/ OBJEKTIVI STRATEGJIK 2 .....	44
	SHTYLLA/ OBJEKTIVI STRATEGJIK 3 .....	44
	SHTYLLA/ OBJEKTIVI STRATEGJIK 4 .....	44
II.	VLERËSIMI I PERFORMANCËS.....	45
	Objektivi 1 .....	45
	Objektivi 2.....	45
	Objektivi 3 .....	45
	Objektivi 4.....	45
III.	SHPJEGIM I SISTEMIT TË MONITORIMIT .....	45
	Sistemi ekzistues i monitorimit në OSHEE .....	45
	Plani i punës për forcimin e sistemit të monitorimit .....	46
	SHPJEGIM I TREGUESVE.....	46
	Tregues - Objektivi 1 .....	46
	Tregues - Objektivi 2.....	46
	Treguesi - Objektivi 3.....	46

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij dokumenti është detajimi i një biznes plani strategjik për OSHEE zbatimimi i të cilit do të synojë përmirësimin e performancës operacionale dhe financiare të kompanisë.

Kapaciteti i dobët institucional dhe pasiguria rregulluese si dhe mungesa e pavarësisë së organit të mëparshëm rregullues e pavendosmëria e qeverisë së mëparshme, kanë kontribuar në një klimë jo të favorshme në sektorin e shpërndarjes privatizuar më parë, e cila në përgjithësi krijoi një nivel të ulët investimesh, nivel të lartë humbesh, mungesë zbatimi të marrëveshjeve tregtare dhe miratimin e politikave tarifore të pavarura. Kjo situatë i atribuohet të dyja palëve; qeverisë së mëparshme operatorit të mëparshëm të shpërndarjes si përgjegjës për dështimin në rimëkëmbjen e sektorit dhe garantimin e sigurisë së furnizimit.

Ky biznes plan strategjik tenton të ndihmojë në marrjen e vendimeve themelore dhe ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të orientojnë OSHEE në arritjen e objektivave strategjike të saj. Dokumenti përfshin një analizë të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të kompanisë për të identifikuar prirjet dhe paqartësitë, mundësitë dhe rreziqet e saj.

Fillimisht, në të vlerësohet gjendja aktuale e kompanisë, si brenda ashtu dhe në kontekstin e jashtëm në të cilin operon, duke konkluduar në një analizë SWOT. Më pas, procedohet me përcaktimin e objektivave duke identifikuar boshllëqet dhe mundësitë reale të kompanisë për realizimin e këtyre objektivave.

## 2. Analiza e Situatës Aktuale

### 2.1 Situata aktuale e sektorit energjetik

#### 2.1.1 Situata makroekonomike

Defiçiti fiskal i Shqipërisë u zgjerua në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2013 duke arritur vlerën prej 6.2%. Ky defiçit shënoi 3.4% në periudhën 2005-2012, përveç viteve 2008 dhe 2009 kur pati një përkeqësim të ndjeshëm. Borxhi publik u rrit që nga kriza e vitit 2008.

Qeveria e mëparshme akumuloi detyrime të prapambetura të rëndësishme buxhetore. Përveç detyrimeve të lidhura me punët publike, kishte detrimet buxhetore të lidhura me shëndetësinë (kryesisht ilaçe), edukimin, ujin, rimbursimin e TVSH, pagesat për tatimit mbi të ardhurat e korporatave, faturat e energjisë elektrike dhe benefitet sociale.

Stoku i detyrimeve të pashlyera u vlerësua në rreth ALL 72.5 miliard (US \$710 milion) ose 5.3% e PBB. Presioni fiskal u rrit akoma më shumë gjatë reduktimit të energjisë në vitin 2012, gjë e cila për qeverinë i siguroi suport financiar KESH-it në formën e garancive sovrane për të importuar energji. Qeveria pranoi ekzistencën e borxheve të prapambetura në nivelin e Qeverisë Qendrore dhe së bashku me programin e FMN po zbaton që nga fillimi i 2014 një strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

#### 2.1.2 Sektori i energjisë

Sektori i energjisë elektrike u zhyt akoma më tej në një krizë financiare në sajë të privatizimit të dështuar të kompanisë së shpërndarjes, e cila u ble në 76% të kapitalit të saj nga kompania çeke

CEZ AS. Në Tetor 2014 situata u zgjidh nëpërmjet riblerjes së aksioneve nga kompania tanimë shtetërore OSHEE, e cila zotëron 100% të aksioneve.

Varesia ndaj reshjeve ndikon në paqëndrueshmërinë e gjenerimit të energjisë të furnizuar nga KESH nëpërmjet hidrocentraleve të vetme në veri të vendit në kaskadën e limit Drin. Kjo përbën një rrezik përse i përket planifikimit të importeve, duke sjellë pra një rrezik për garancinë e furnizimit.

Me raste, ndodhin reduktime periodike të energjisë krahasuar me planifikimin e gjenerimit, për shkak të luhatjeve së reshjeve, të cilat e vënë vendin në një pozitë të vështirë për sigurimin e furnizimit të sigurtë dhe të përballeshëm duke qenë se ky furnizim varet kaq shume nga kushtet klimaterike. Sfida energjitike e Shqipërisë ndikohet gjithashtu edhe nga kapaciteti i brendshëm dhe ai ndërlihdës i transmetimit në rajon dhe volumet e reduktuara të energjisë që mund të furnizohen dhe tregtohen me vendet fqinje. Situata, në kushtet e ndikimit nga kushtet klimaterike, ndikon negativisht jo vetëm Shqipërinë, por edhe fqinjët duke shtuar efektin negativ neto të tyre.

Për shembull KESH bëri një vlerësim të një skenari të rasteve më negative të importeve që nevojiten për të mbuluar tregun e rregulluar në 2014, vlerësuar në atë kohë me 1,200 GWh ekuivalent, ose rreth 100 miliona US\$. Aktualisht, importet neto të KESH ishin 180 GWh (rreth 12 miliona US\$) gjatë vitit për shkak të përmirësimit të kushteve klimaterike në Mars dhe manaxhimit të mirë të rezervave të ujit në Kaskadën e Drinit.

Një tjetër vështirësi me të cilën po përballet sektori energjistik sot është detyrimi financiar që rrjedh nga energjia e blerë nga prodhuesitë vegjël. Ky detyrim u akumulua për shkak të shtesës së sasisë së prodhuar prej tyre krahasuar me sasinë e planifikuar dhe me tarifa të rregulluara shumë të favorshme të cilat janë shumë më të larta se çmimet e tregut të energjisë aprovuar nga ERE, me të cilat KESH bleu energjinë nga prodhuesit e vegjël, 9.3 ALL/KWh (EUR 66.4/MWh) gjatë periudhës 2012-2014. Vetëm në vitin 2014, kostoja e blerjes së energjisë nga SHPP/IPP, e pa mbuluar nga regjimi i tarifës arrinte në rreth ALL 2 miliard përkeqësuar edhe nga mos rregullimi i tarifave nga ERE në vitet 2012-2014, për shkak të konfliktit të vazhdueshëm ligjor me CEZ Shpërndarje.

Sektori i shpërndarjes po përballet me një numër të madh sfidash të cilat lidhen me energjinë e pafaturuar për shkak të mungesës së matësive ose matësive të demtuar dhe vjedhja në sistem, si edhe arkëtimi i pamjaftueshëm i energjisë së faturuar prej ekonomive shtëpiake dhe bizneseve (84 % në 2012), të cilat kanë kontribuar në problemet financiare të kompanisë private të riparshme, CEZ Shpërndarje. Tani, operatori i sistemit të shpërndarjes përballet me vështirësi financiare dhe e ka të pamundur të aksesojë tregjet e kapitalit. Ndërkohë vlera totale e kapitalit është më e ulët se ALL (-72) miliard.

Në kohën e privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, prishmëritë ishin që CEZ Shpërndarje do të reduktonte humbjet në 17% në 2014 dhe do të investonte gati 200 miliona US\$ gjatë 5 viteve në sistemin e shpërndarjes. Privatizimi i kompanisë së shpërndarjes nuk shkoi ashtu siç pritej. Pranimi i nivelit të humbjeve dhe borxheve të këqija ndodhi më vonë seç pritej dhe tarifave e pakices nuk u rregulluan në kohë. Arkëtimi i faturave nga institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore nuk u përmirësua dhe kompania e shpërndarjes menaxhuar më parë nga CEZ Shpërndarje dështoi në uljen efektive të humbjeve teknike dhe jo-teknike.

Nisur nga situata e krijuar me revokimin e licensës së CEZ Shpërndarje, dhe duke pasur parasysh mungesën e aksesit në Bankat Tregtare për të importuar energji për mbulimin e humbjeve, KESH si një furnizues i burimit të fundit, kontraktoi hua afatshkurtra nga bankat tregtare duke e çuar këtë shumë në ALL 36.26 miliard (rreth 2.6 për qind e PBB) në fund të 2014, prej të cilave ALL 10.2

miliard nuk është mbuluar nga garanci sovraane.

Humbjet e energjisë u rritën me 51.1 % nga fundi i 2012 dhe në mesatare vjetore 45% në fund të 2013, ndërkohë që pati një përmirësim të rëndësishëm me më pak se 38% në 2014. Nivelet e arkëtimeve u ulën nga 85% në 2008, në 84 % në 2012, deri në 78.7% në 2013 dhe u rritën deri në

84% në vitin 2014.

Duke konsideruar faktin që ka patur investime kapitale të pamjaftueshme nga CEZ Shpërndarje, si dhe në sajë të mungesës së resurseve, Operatori Shpërndarjes ka qenë në vështirësi për të importuar energji për mbulimin e humbjeve, shlyer detyrimet ndaj kreditorëve, dhe për më tepër nuk ka qenë në gjendje të financojë një program, i rëndësishëm ky, për uljen e humbjeve. Kompania ka kapital negativ, edhe pse detyrimet që institucionet buxhetore dhe jo buxhetore i kanë OSHEE-së janë pothuaj dyfishi i deficitit të tij aktual.

Për shkak të fakteve të lartpërmendura, si dhe duke qenë se sektori energjistik është shumë i ndërvarur, çdo ndryshim në sistem rezulton në mënyrë të menjëhershme në një efekt kaskadë nga një kompani në tjetrën. Duke marrë parasysh që OSHEE nuk është në gjendje të prodhojë të ardhura mjaftueshëm për të mbuluar kostot e veta, i gjithë sektori energjistik ndikohet negativisht.

KESH dhe OST, ndërkohë që kanë aftësi paguese, pjesërisht, mbeten jo likuide për shkak të mungesës së nivelit të qëndrueshëm të pershtatshëm të pagesave nga OSHEE. Situata nuk është më e qëndrueshme dhe përbën risk sidomos për KESH sepse kjo kompani nuk mund të paguajë këstet e kredive për energjinë e blerë nga prodhuesit privatë dhe importet e energjisë që nevojiten për të plotësuar kërkesat e tregu të rregulluar vendas.

Edhe me ndërtimin e termocentralit të Vlorës, ky aset nuk është akoma operativ për shkak të problemeve teknike ende të pazgjidhura. Aktualisht, KESH është në proces seleksionimi të konsulentëve, të cilët pritet t'i sigurojnë KESH një zgjidhje teknike të problemit. Kur të vihet në punë në 2018 (në rast se zgjidhja teknike e propozuar do të jetë ekonomikisht e shëndoshë dhe financiarisht e realizueshme), do të ketë kosto të larta për prodhimin e energjisë duke qenë se teknologjia e tij (CCGT) është projektuar për karburante të kushtueshme importi.

Për këtë arsye, ka një nevojë urgjente për realizimin e investimeve me synim uljen e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe shtimin dhe zgjerimin e rrjetit të transmetimit të OST për garantimin e sigurisë së furnizimit.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në këtë sektor ka qenë paqartësia rregullatore dhe niveli i ulët i kapacitetit institucional, si edhe qeverisja e dobët e mëparshme e korporatës, duke rezultuar në zbatim të dobët të rregullave të tregut, mungesë disipline paguese dhe zbatim kontratash tregtare, nivel të ulët arkëtimesh, nivele të papërshtatshme tarifash, nivel i ulët pavarësie i rregullatorit, bllokime periodike të vendimmarrjes për shkak të zgjedhjeve, mungesë të një operatori efikas tregu (funksion i OST), dhe një kompani private shpërndarjeje që ishte e paaftë ose e pavullnetshme për tu vënë në lëvizje dhe për të bërë investimet e nevojshme për uljen efektive të humbjeve teknike dhe jo teknike.

Në këto kushte, sektori nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë veten nga një gjendje manaxhimi krize për të mbështetur aktivitetin operacional.

Në këto kushte, BB ofroi një hua prej US\$ 150 milionë për tu disbursuar në 5 vitet e ardhshme, orientuar kryesisht tek sistemi i shpërndarjes. Duke patur parasysh nevojat e medha të sektorit

energjitik, projekti i financuar nga BB në vetvete nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar dhe zgjidhur të gjithë boshllëkun financiar të trashëguar e që vazhdon, i cili kërkon masa të tjera suplementare dhe një reformë të thellë për të kapërcyer problemet e sektorit të energjisë.

### 3. Historik i Kompanisë

Para vitit 2004 KESH ishte e vetmja kompani shtetërore e integruar vertikalisht, e cila ishte përgjegjëse për furnizimin me energji elektrike. Kompania KESH mbulonte të gjithë zinxhirin e gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike.

Me miratimin e “Deklaratës së Politikës për Sektorin e Energjisë”, u vendos zyrtarisht që kompania KESH, e integruar vertikalisht, duhet të ndante aktivitetet për sa i përket gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes. Me prezantimin e Modelit të Tranzicionit të Tregut nga Qeveria Shqiptare (vendimi no. 539, 12/08/2004), aktivitet e transmetimit të kompanisë u transferuan tek një operator i veçantë, i cili duhet të ishte financiarisht, funksionalisht dhe legalisht i pavarur nga KESH.

Ky ishte hapi i parë në krijimin e një tregu konkurrues të energjisë, në përputhje me Direktivën Europiane për Energjinë 96/92/EC dhe 2003/54/EC. Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST sh.a” u krijua si një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore.

Në 01/01/2008 Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vendosi ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes dhe krijimin e kompanisë OSSH sh.a.

Ndarja e aktiviteteve në tregun e energjisë kishte për qëllim heqjen e monopolit, rritjen e konkurrencës, me qëllim përfitimin e konsumatoreve dhe rritjen e efikasitetit të sektorit në tërësi.

### **3.1 Pronësia dhe lloji i drejtimit të kompanisë**

Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (“OSHEE”) e njohur më parë si CEZ Shpërndarje sh. a., është person juridik i së drejtës, i organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar. OSHEE është krijuar dhe ka fituar personalitet juridik me Vendimin Nr.38587, datë 19/06/2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe është pajisur me certifikatën e Regjistrimit të Personit të Tatueshem me NIPT K72410014 H. Objekti kryesor i OSHEE është shpërndarja dhe furnizimi me pakicë i energjisë elektrike për konsumatorët tariforë. OSHEE ka për objekt aktiviteti gjithashtu, operimin, mirëmbajtjen, manaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më datë 11 Mars 2009, ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë lidhi një marrëveshje për blerje aksionesh me CEZ. Me anë të kësaj Marrëveshjeje për Blerje Aksionesh, CEZ bleu 76% të kapitalit aksionar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a (“OSSH”) që më pas e ndryshoi emrin në “CEZ Shpërndarje” sh.a. Meqënëse, CEZ Shpërndarje sh.a. kishte për objekt aktiviteti furnizimin me pakicë dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, dispononte License për Furnizim me Pakicë të Energjisë Elektrike dhe License për Shpërndarje të Energjisë Elektrike, të dhëna nga Enti Rregullator i Energjisë.

Si rrjedhojë e përkeqësimit të marrëdhënies ndërmjet CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe organeve të ndryshme të Republikës së Shqipërisë me kalimin e kohës, Enti Rregullator i Energjisë vendosi në

bazë të Vendimit Nr.5 datë 21.01.2013 “Mbi vendosjen në Administrim të Përkohshëm të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.” kalimin e Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në administrim të përkohshëm dhe përcaktoi një Administrator të përzgjedhur konform kushteve të përcaktuara në Rregulloren e miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2013 “Për miratimin e Rregullores Mbi procedurat e emërimit të Administratorit dhe kompetencat e tij”.

Referuar kësaj Rregulloreje, kompetencat e Administratorit të mëparshëm, Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë, që kanë të bëjnë më ushtrimin e detyrimeve të licensave, janë të pezulluara dhe të gjitha këto kompetenca i kanë kaluar Administratorit të Përkohshëm të

përcaktuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë. Administratori i përkohshëm ka si detyrë kryesore operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të cilat janë në funksion të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit gjatë periudhës së Administrimit të Përkohshëm.

Me Ligjin Nr. 114/2014 “Për Miratimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ A,S u vendos me mirëkuptim që aksionet e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh. a., të cilat ishin në pronësi të shoqërisë CEZ, a. s., të lira nga çdo barrë kontraktore, të krijuara nga CEZ, a. s. deri në datën 21.3.2013, datë në të cilën OSHEE është vendosur në administrim të përkohshëm, i kalojnë në pronësi shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Që prej datës 27 Tetor 2014, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, nëpërmjet Vendimit Nr. 98, vendosi përfundimin e administrimit të përkohshëm të OSHEE. Më datën 01 Dhjetor 2014, Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE miratoi zgjedhjen e Z. Adrian Çela në funksionin e Administratorit të Përgjithshëm të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike deri më datën 01 Dhjetor 2017.

### **3.2 Struktura Aktuale e Sistemit të Shpërndarjes**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sha) është organizuar në 10 Zona Shpërndarjeje dhe 40 Agjenci. Më poshtë paraqiten peshat specifike të mesatarizuara që zënë treguesit kryesorë për çdo Zonë dhe Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes (OSHEE) gjatë vitit 2014 në raport me energjinë totale të konsumuar.



**PESHA SPECIFIKE E FURNIZIMIT, HUMBJES, ARKETIMIT DHE MOSARKETIMIT TE CDO ZONE TE OSHEE**

Zona	Zona Berat	Zona Burrel	Zona Durres	Zona Elbasan	Zona Fier	Zona Gjirokaster	Zona Korce	Zona Kukës	Zona Shkoder	Zona Tirane
Pesha Specifike ne furnizim (%)	5.5	5.7	13.2	6.4	11.4	4.3	4.8	2.7	11.4	34.6
Pesha Specifike ne Humbje (%)	1.60	2.68	5.33	2.13	4.07	1.15	1.55	1.33	6.12	10.99
Pesha Specifike ne arketim (%)	3.64	2.06	6.41	4.10	6.13	2.94	3.13	0.37	3.67	20.63
Pesha Specifike ne mosarketim (%)	0.27	0.95	1.48	0.13	1.15	0.22	0.11	1.03	1.63	2.97

**PESHA SPECIFIKE E FURNIZIMIT, HUMBJES, ARKETIMIT DHE MOSARKETIMIT TE CDO AXHENSIE NE ZONAT E OSHEE**

ZONA	Zona Berat	Zona Burrel	Zona Durres	Zona Elbasan	Zona Fier	Zona Gjirokaster	Zona Korce	Zona Kukës	Zona Shkoder	Zona Tirane
Axhensia	Berat Kuçove Lushnje Skrapar Bulqize Diber (Peshkopi) Lac Mat (Burrel) Mirdite Durrës Kavajë Krujë Shijak ELBASAN GRAMSH LIBRAZH PEQIN Ballsh Fier Patos Vlora Delvine Gjirokaster Permet Saranda Tepelene BILISHT ERSEKE KORCE POGRADEC HASI KUKESI TROPOJA Koplik Lezhe Puke Shkoder Tirane 1 Tirane 2 Tirane 3									
Pesha Specifike ne furnizim (%)	1.85	0.76	2.56	0.34	0.69	1.03	2.44	0.89	0.65	6.14
Pesha Specifike ne Humbje (%)	0.48	0.21	0.81	0.10	0.22	0.51	1.20	0.51	0.24	2.30
Pesha Specifike ne arketim (%)	1.32	0.52	1.60	0.20	0.49	0.39	0.47	0.35	0.36	3.51
Pesha Specifike ne mosarketim (%)	0.05	0.03	0.15	0.04	0.02	0.14	0.77	0.03	0.05	0.11

Burimi: OSHEE



Burimi OSHEE

## 4. Konsumi i Energjisë Elektrike

### 4.1 Struktura e konsumit të energjisë elektrike

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për konsumatorët tariforë për vitin 2014 përbën rreth 58 %, duke shfaqur të njëjtin trend sikurse edhe në vitet e tjera. Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë, tek këta të fundit bëjnë pjesë kryesisht ujësjellësit dhe hidrovorët.

### 4.2 Profili i konsumit të energjisë elektrike

Struktura e konsumit të energjisë elektrike ndikon drejtpërsëdrejti edhe në profilin e ngarkesës ose të konsumit të energjisë elektrike. Në dallim nga profili i ngarkesës në një ditë me konsum maksimal, në profilin e një dite me konsum minimal spikat një pik ngarkese në orët e mbrëmjes 19.00-22.00 i cili ka të bëjë kryesisht me intensifikimin e veprimtarisë familjare në këto orë, gjatë stinës së verës.

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë. Gjatë periudhës së ngrohtë prill – shtator ka një konsum mesatar pothuajse konstant kurse në tre muajt paraardhës dhe

pasardhës ka një rritje simetrike të ngarkesës, e cila shpjegohet me ftohjen/ngrohjen e motit dhe përdorimin gradual të energjisë elektrike për ngrohje/ftohje.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparëshme, edhe këtë vit vërehet e njëjtja problematikë, ajo e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht të efektit nga përdorimi ose mospërdorimi i ngrohjes elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht vërehet se tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese.

## **5. Tregu i Sektorit Energjetik**

### **5.1 Modeli ekzistues i tregut në sektorin e energjisë**

Sektori energjetik në Shqipëri operon si sektor i ndërlidhur midis aktiviteteve të gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit. Kërkesa për energji elektrike përmbushet kryesisht nga kompania publike KESH, transmetimi dhe operacionet e tregut realizohen nga kompania publike OST, ndërsa aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë realizohen nga kompania publike e Operatorit të Shpërndarjes (OSHEE).

Sektori monitorohet dhe rregullohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Në Tetor të vitit 2014 Qeveria Shqiptare mori mbrapsht 100 % të aksioneve zotëruar më parë nga CEZ AS, aksione të cilat i ishin alokuar kësaj kompanie nëpërmjet procesit të privatizimit nga kompania çeke CEZ AS.

Në kuadrin e fillimit të procesit të liberalizimit të tregut, në 2011 të gjithë konsumatorët që shërbeheshin apo furnizoheshin me voltazh shumë të lartë tensioni, 220-110kV u detyruan të shndërroheshin në konsumatorë të kualifikuar dhe të zgjidhnin furnizuesin e tyre, gjë e cila ka çuar në gjashtë numrin e konsumatorëve të kualifikuar të tensionit të lartë (TL), që përbëjnë një konsum vjetor prej 700 GWh/vit (14% e kërkesës së përdoruesve fundorë), duke i hqeur kështu KESH-it detyrimin për t'i furnizuar ata me një tarifë të rregulluar. Por nga ana tjetër, kapacitetet e prodhimit që disponon KESH u reduktuan me 81MË për shkak të privatizimit të Ulzes, Shkopetit, Bistrica 1, 2 HEC-ve dhe Lanabregas.

Në strukturën aktuale të modelit të tregut, deri para hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 43/2015 datë 30/04/2015, KESH ishte përgjegjës për sigurimin e kërkesës së përgjithshme të energjisë në Shqipëri për tregun e tarifave të rregulluara (përfshijtur fuqinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjet). KESH, si një kompani prodhuese e energjisë elektrike, funksiononte edhe si strukturë autonome e Furnizuesit Publik me Shumicë (FPSH) në tregjet jo të rregulluara, funksion i cili i hiqet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri.

## 5.2 Importi i energjisë elektrike

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, importet e energjisë elektrike për nevojat e konsumatorëve në vendin tonë kryhen nga furnizuesi publik me shumicë (FPSH) në përbërje të KESH sh.a. Ndërsa FPSH importon energji për të plotësuar nevojat e klientëve tariforë, OSHEE importon energji elektrike për mbulimin e plotë të humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes.

Nga analiza e treguesve të balancës së import-eksportit të energjisë elektrike për periudhën 1985 – 2014, vihet re se deri në vitin 1998, (me përjashtim vetëm të vitit 1990) vendi ynë ka qenë një vend eksportues neto i energjisë elektrike. Për periudhën 1998 – 2014, me përjashtim të vitit 2010, vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike.

## 5.3 Efiçenca e tregtimit të energjisë elektrike

Gjatë vitit 2014 efiçenca e tregtimit të energjisë elektrike ka vijuar të jetë e ulët krahasuar me periudhat e mëparshme, por ky vit gjithsesi shënon trend përmirësimi në raport me periudhën 2011 – 2013 në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efiçencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

- Niveli i lartë i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje
- Niveli i ulët i arkëtimeve të energjisë elektrike të faturuar

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Kompania për vitin 2014, arrijnë në 37.81%, duke shënuar një rënie të ndjeshme. Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSHEE sh.a është 91.9 % kundejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2014.

## 5.4 Modeli i tregut sipas ligjit të ri dhe sfidat e sektorit

### 5.4.1 Modeli i tregut

Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” përcakton modelin e ri të tregut të energjisë elektrike. Ky ligj rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhënien e autorizimeve dhe liçensave në sektorin e energjisë elektrike;
- d) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;

Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, e cila shfuqizon direktivën 2003/54/KE”, (numri CELEX: 32009L0072, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 211, datë 14.8. 2009, faqe 55 – 93).

Në zbatim të këtij Ligji, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili ushtron këtë funksion përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush detyrimin e ndarjes jo më vonë se data 31.12.2017.

## 6. Pjesëmarrësit e Tregut në Sektorin e Energjisë

## 6.1 Enti rregullator i energjisë (ERE)

Enti Regullator i Energjisë është person juridik publik, i pavarur, i cili përbëhet nga Bordi i Komisionerëve dhe personeli teknik dhe ka për qëllim rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit. Gjatë kryerjes së funksioneve të saj, ERE konsultohet dhe bashkëpunon me autoritetet shtetërore, autoritetet rregullatore të vendeve të tjera dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për promovimin e një tregu të brendshëm konkurrues dhe hapjen e tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke krijuar kushte të përshtatshme për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike. Gjithashtu, ERE lehtëson hyrjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe eliminon kufizimet në tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë, me qëllim plotësimin e kërkesës dhe forcimin e integritetit të tregjeve të brendshme. ERE ka një sërë detyrash, ndër të cilat:

- a) Të bashkëpunojë me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike për hartimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike;
- b) Të miratojë dhe publikojë metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe tarifave të tjera të aplikueshme;
- c) Të vendosë ndaj të licencuarve detyrimin e shërbimit publik, përfshirë shërbimin universal të furnizimit;
- d) Të sigurojë ndarjen e detyrimeve të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes;
- e) Të përmbushë udhëzimet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë;
- f) Të bashkëpunojë me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike;
- g) Të sigurojë shmangien e ndërsuvencionimit ndërmjet veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;
- h) Të respektojë lirinë kontraktore mbi kontratat e furnizimit me ndërprerje dhe ato afatgjata;
- i) Të sigurojë në bashkëpunim me autoritete të tjera, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj klientëve fundorë;
- j) Të sigurojë klientëve mundësinë e aksesit ndaj të dhënave të konsumit në një format të kuptueshëm, të përgatitur nga operatori i sistemit;
- k) Të publikojë metodologjitë e tarifave apo kushtet e shërbimeve të rregulluara;
- l) Të rishikojë dhe rregullojë tarifave të energjisë elektrike për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik;
- m) Me propozimin e të licencuarve, të miratojë rregullat për shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike për procedurat që zhvillohen nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut

## 6.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)

Operatori i Sistemit të Transmetimit është person juridik, i organizuar si një subjekt i pavarur përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit. OST ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstationet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstationet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të

transformatorëve 110/TM kV. Gjithashtu, OST ka në pronësi pajisjet komutuese të linjave 110 kV si dhe operon infrastruktura të tjera të ngjashme të këtij niveli tensioni të cilat nuk janë në pronësi të tij, që shërbejnë për lëvrimin e energjisë tek operatori i shpërndarjes dhe/ose klientët e lidhur direkt me sistemin e transmetimit. Konkretisht, OST është përgjegjëse për:

- a) Hartimin e rregullave specifike që përcaktojnë mënyrën e operimit të rrjeteve të tyre, përfshirë kushtet për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, duke u konsultuar me parë me grupet e interesit, vendase dhe të huaja;
- b) Siguron disponueshmërinë e një kapaciteti rezervë të përshtatshëm prodhimi, për qëllime balancimi në përputhje me kërkesat e operatorëve të rrjeteve europiane të transmetimit të energjisë elektrike;
- c) Shkëmbimin e informacionit për funksionimin e rrjeteve në mënyrë efektive
- d) Përgatitjen e një parashikim të përgjithshëm afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimeve të mundshme të furnizimit, duke marrë parasysh kriteret dhe kërkesat e sigurisë së furnizimit;
- e) Dhënien e informacionit të plotë kundrejt çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin;
- f) Sigurimin e furnizimit nëpërmjet sigurisë së sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit.
- g) Përdorimin e pajisjeve të rrjetit të transmetimit, në përputhje me rregullat dhe standardet teknike;
- h) Ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos dhe ndikimit mjedisor më të ulët;
- i) Manaxhimin e fluksit të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit;
- j) Shmangien e diskriminimit mes përdoruesve të sistemit të transmetimit etj.

### 6.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e energjisë tek klientët, ku kufiri me sistemin e transmetimit përcaktohet sipas ligjit. Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë:

- a) operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;
- b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- c) lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;
- d) siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi;
- e) u siguron përdoruesve të rrjetit informacionin për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes;
- f) mbledh dhe paraqet tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e nevojshme për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin, rregullat e tregut dhe rregullat për ndryshimin e furnizuesit;
- g) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- h) prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me procedura transparente jodiskriminuese. Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

- i) harton profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme;
- j) mban evidencën e shoqërive të licencuara që furnizojnë me energji elektrike, në të gjitha pikat e lidhjes dhe pikat e matjes së rrjetit respektiv shpërndarës;
- k) i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi.

#### **6.4 Prodhuesit**

Prodhimi i energjisë elektrike prej shoqërive prodhuese është realizuar si një aktivitet i licencuar nga ERE në bazë të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar. Ky Ligj u shfuqizua më 30/04/2015 dhe aktiviteti i prodhimit tashmë rregullohet nga Ligji i ri.

Prodhuesit janë persona të licencuar për prodhimin e energjisë. Prodhuesit përdorin në centralet e tyre elektrike burimet parësore të energjisë, që ata i konsiderojnë më të përshtatshme, në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes. Gjatë veprimtarisë së tyre, prodhuesit, shesin energjinë elektrike dhe sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit në tregun e energjisë elektrike. Gjithashtu, prodhuesit mbajnë sistemin e tyre të komunikimit në kohë reale për lidhjen me objektet e tyre prodhuese, me klientët ose me nivelet operative të kontrollit, duke transmetuar energjinë e tyre elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose sistemit të shpërndarjes.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese me kapital tërësisht shtetëror dhe shfrytëzon centrale ekzistuese.

Shoqëritë prodhuese me kapacitetin më të madh prodhues janë të lidhura në sistemin e transmetimit. Këto subjekte të licencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese, apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të konçesionit të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare dhe, një pjesë e vogël, shfrytëzojnë centrale deri në 2 MË, të privatizuara në kuadër të Ligjit nr.8527, datë 23.09.1999.

Një numër i konsiderueshëm i shoqërive prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

## 6.5 Klientët

### 6.5.1 Klientët fundorë

Klient fundor quhet personi i cili blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak. Furnizimi i klientëve fundor bëhet nga çdo person i licënsuar nga ERE. Energjia për furnizimin e klientëve fundor blihet nga tregjet e brendshme dhe çmimi i energjisë bazohet në kontratën e nënshkruar midis furnizuesit dhe klientit fundor.

### 6.5.2 Klientët në nevojë

Klient në nevojë quhet një klient familjar i cili për shkak të gjëndjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin e energjisë. Për të përfutur këtë shërbim klienti duhet të regjistrohet pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë.

### 6.5.3 Klientët familjarë/klientët e vegjël jo familjarë

- a) Klient i vogël jofamiljar quhet personi fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0.4 kV, i cili blen energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitjeje;
- b) Klient familjar quhet një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për aktivitete tregtare.

### 6.5.4 Klientët e shumicës

Klient shumice është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike me qëllim rishitje brenda ose jashtë sistemit të vendit ku është regjistruar

## 6.6 Furnizuesit

Furnizues është një shoqëri e licënsuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit. Për të kryer një veprimtari të tillë, furnizuesi është i detyruar të lidhë një kontratë për akses në sistem me Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo të Shpërndarjes, në rrejetin e të cilit është lidhur objekti i klientit që do të furnizohet me energji elektrike. Furnizuesit ndahen në:

- a) Furnizues universal, të cilët kanë për detyrim shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik;
- b) Furnizues të alternativës së fundit, të cilët furnizojnë klientët kur furnizuesi i mëparshëm ka falimentuar ose është likuiduar ose i është pezulluar përkohësisht licënsa.

## 6.7 Operatori i pavarur i matjes

Operatori i pavarur i matjes është një shoqëri me ekspertizë në matjen e energjisë elektrike që mund të kontraktohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Shpërndarjes për të drejtuar dhe manaxhuar sistemin e tyre respektiv të matjes.



## 7. Analiza SWOT dhe sfidat e sektorit

### 7.1 Analiza SWOT e sistemit/operatorit të shpërndarjes

#### 7.1.1 Pikat e dobëta

- Rjeti tejet i amortizuar, përfshirë moshën mesatare të nënstacioneve mbi 40 vjet;
- Në pjesën më të madhe të nënstacioneve nuk merret në konsideratë si standart i tensionit të mesëm rrjeti 20 kV në përputhje kjo dhe me standardet europiane;
- Mungesa e investimeve për një periudhë të gjatë kohore;
- Mungesa e bazës materiale;
- Mungesa e procedurave;
- Mungesa e komunikimit ndërinstitucional;
- Mungesa e sigurisë teknike në punë të punonjësve;
- Cilësia e burimeve njerëzore;
- Mungesa e trajnimeve;
- Moskezistenca e arkivës, mungojnë dokumenta të viteve të kaluara, në të gjithë kompaninë;
- Mungesa e stabilitetit në punë dhe demotivimi i stafit;
- Sistemet e informacionit në drejtori, departamente, divizione;
- Mungesa e inventarizimit të aseteve të kompanisë;
- Mungesa e një sistemi të matjes/transmetimit/regjistrimit online të prodhimit të HEC-eve lokale, konsumit të fiderave TM të nënstacioneve si dhe konsumit të konsumatorëve privatë të lidhur në rrjetin 35 kV;
- Situata aktuale në të cilën ndodhet gjendja e sistemit të matjes në të gjithë territorin që mbulon OSHEE;
- Situata financiare jo e qëndrueshme;

#### 7.1.2 Pikat e forta

- Vëmendje dhe mbështetje nga Qeveria duke qenë se Energjia është një nga 6 prioritetet e Qeverisë;
- Ndryshimet ligjore, sa përbëjnë risqe, aq përbëjnë dhe avantazh apo oportunitet pasi do të disiplinojnë dhe sistemojnë sektorin;
- Kuadri ligjor po krijon kushtet për marrdhënie optimale dhe të drejta me kompaninë KESH dhe institucione të tjera buxhetore, do të krijohet fleksibilitet në manaxhimin e kompanisë;
- Ka personel me aftësi e kualifikime teknike;
- Staf manaxherial i kualifikuar.

#### 7.1.3 Oportunitete

- Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike;
- Ndarja/shkëputja e funksionit të Furnizuesit Publik me Pakicë;
- Fokus në rritje operimin e mirëmbajtjen e rrjetit;
- Thithje e investimeve të mëtejshme në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes;

#### 7.1.4 Kërcënime



- Ndryshimet e reja për sa i përket kuadrit ligjor, do të sjellin si pasojë largimin e klientëve më të mirë dhe klientëve të mëdhenj nga kompania;
- Hyrja e konkurrentëve të rinj në shërbimet e furnizimit;
- Ndryshimet e çmimeve, si dhe të rregullave të lojës në treg;
- Mungesa e një kuadri ligjor për liberalizimin e tregut;
- Ndryshimi i pronësisë dy herë brenda tre viteve, ku realisht aksioneri aktual paguan pasojat e vendimarrjeve të kaluara;

### 7.1.5 Mundësi për tejkalimin e situatave kritike

- Analizë e mirëfilltë e rrjetit, rritja e efikasitetit dhe kryerja e investimeve të gjera kapitale;
- Ndjekja e studimeve të mëparshme të kryera në sistem, duke u përshtatur dhe zhvilluar me situatën ekzistuese të rrjetit të shpërndarjes, me qëllim zhvillimin e rrjetit;
- Zhvillimi i një Master Plani të plotë të sistemit të Shpërndarjes me qëllim që të identifikohen vlerat monetare, projektet dhe koha e ndërhyrjes respektivisht;
- Zhvillimi i investimeve të nevojshme sipas një programi të paracaktuar;
- Vazhdimi në mënyrë rigorozë të procesit të mirëmbajtjes, që të sigurojë performancën e duhur të aseteve;
- Tejkalimi i problematikës lidhur me mungesën e bazës materiale dhe përfundimi i procedurave për të gjithë proceset e punëve mbi bazë të sistemit të ngritur në fuqi që ka kompania;
- Analizë e situatës aktuale dhe vënja në efikasitet të një sistemi optimal të komunikimit duke përfshirë thellë teknologjinë e informacionit; Në veçanti të sigurohen “urat” e duhura të komunikimit të qendrës me rajonet;
- Respektimi rigoroz i rregulloreve deri në trajtimin me masa konkrete të sigurisë në punë të punonjësve, nëpërmjet një sistemi monitorimi që menaxhohet në qendër;
- Hartimi dhe implementimi i një politike të re për burimet njerëzore, me theks në implementimin e saj duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit si dhe në dixhitalizimin e arkivës; përmirësimi i rekrutimit mbi bazë të analizës së punës për çdo pozicion; Krijimi dhe implementimi i sistemit të menaxhimit të talentëve; përmirësimi i procesit të performancës dhe të shpërblimit në funksion të realizimit të objektivave të punës;
- Analiza e situatës aktuale në lidhje me arkivimin; hartimi i një programi të qartë në referencë të kuadrit ligjor në fuqi përkatës; kualifikimi i personelit të OSHEE në kuader të një programi që do të mundësojë stabilizimin dhe funksionimin të arkivimit; hartimi i procedurave të plota të arkivimit;
- Vazhdimi dhe avancimi i procesit të inventarizimit të aseteve të kompanisë;
- Përmirësimi i procesit të matjes në rrjetin e shpërndarjes duke nisur me analizën e nevojave dhe më tej me masat respektive me qëllim kryesor zvogëlimin e humbjeve, nëpërmjet investimeve në matësa;
- Zhvillimi i benchmarking në nivel rajonesh dhe agjensish me qëllim përmirësimin dhe rritjen operacionale;
- Zhvillimi sipas afateve të “action plan”;
- Optimizimi i plotë i sistemit të teknologjisë së informacionit në nivel Divizioni, Departamenti, dhe Drejtorie;

### 7.2 Sfidat e sektorit

- a) Krijimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm, që do të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të klientëve me energji elektrike;

- b) Krijimi i një tregu funksional dhe kompetitiv;
- c) Të përmirësohet siguria në fushën e energjisë, duke promovuar diversitetin, efikasitetin dhe fleksibilitetin nëpër gjithë sektorët e energjisë, në mënyrë që të ketë gadishmëri të plotë për çdo emergjencë lidhur me energjinë;
- d) Të sigurohet zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes në përputhje me strukturën dhe planin e zhvillimit;
- e) Hapja e tregut lejimi i klientëve të zgjedhin vet në liri të plotë, furnitorin e tyre;
- f) Garantimi i të gjitha shtëpive /ekonomive të vogla shtëpiake apo jo, akses në shërbimin Universal të Paisjes me energji;
- g) Nxitja e rolit të rregullatorit ndaj monitorimit ose veprimit në rastet kur kërcënohen principet e transparencës dhe jo-diskriminimit;
- h) Domosdoshmëria e një Rregullatori të fortë dhe të pavarur politikisht;
- i) Promovimi i konkurrencës, duke i dhënë Rregullatorit përgjegjësinë e rolit të përgatitjes së metodologjive dhe tarifave që mbulojnë kostot;
- j) Minimizimi i kostove të furnizimit;
- k) Mbrojtja e klientëve në nevojë;
- l) Mbrojtja dhe mbarëvajtja e mjedisit;
- m) Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme;
- n) Përmirësimi i situatës financiare me synim arritjen e qëndrueshmërisë financiare të operatorit;
- o) Orientimi i kompanisë drejt nevojave të konsumatorit;


## 8. Problemet e Vërejtura Kundrejt Konsumatorit

Një nga rolet më të rëndësishëm të ERE është dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, për të aplikuar tarifa të reflektojnë parimet e vendosjes së tarifave dhe kushteve të shërbimit. Roli i mbrojtjes së konsumatorëve përfshin edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe të liçensuarve, mbikqyrjes dhe zbatimit nga ana e kompanisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Sipas të dhënave statistikore të ERE, numri i ankesave të konsumatorëve për vitin 2014 është i konsiderueshëm dhe relativisht më i lartë se në vitin 2013. Kështu, në vitin 2013 është trajtuar një numër prej 1359 ankesash ndërsa në vitin 2014 janë trajtuar 2225 ankesa. Numri më i madh i ankesave lidhet kryesisht me shkeljen e kushteve të përgjithshme të kontratave të Furnizimit me Energji Elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë.

Ankesat me objekt “energjinë e pamatur” zënë peshën kryesore në totalin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt keq-faturimin dhe mbi-faturimin. ERE ka konstatuar se pjesa më e madhe e procesverbaleve të mbajtura nga operatori i shpërndarjes janë kryer jo në praninë e konsumatorit. Një procedurë e tillë bie ndesh me nenin 14.1 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jo-familjarë, si dhe me nenin III.7.7 të Kodit të Matjes.

Sipas ERE, pjesa më e madhe e kontrolleve të ushtruara nga kompania ka konsistuar në bokse kolektive, të cilat janë në administrim të kompanisë. Kështu, konstatohen rreth 667 ankesa për “energji të pamatur” dhe rreth 563 ankesa për mbi-faturim dhe keq-faturim të energjisë elektrike. Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë analitike objektet e ankesave të trajtuara sipas muajve.



Burimi: ERE

**Mbifaturimi dhe keqfaturimi i energjisë elektrike.** Në spektrin e ankesave një vend të konsiderueshëm zënë dhe ankesat në lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjisë elektrike që janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mos rakordimi i gjendjes së hedhur në sistem me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Këto problematika rrisin në mënyrë të konsiderueshme peshën financiare që iu ngarkohet abonentëve, duke ulur nivelin e arkëtimit. Te gjithë këta faktorë kanë sjellë që ankesat në lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjisë elektrike të jenë konsideruar si problematike edhe për vitin 2014.

**Faturimet aforfe.** Ky fenomen është ndeshur ndjeshëm në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, të cilët edhe pse kanë qenë me matës, përsëri janë faturuar aforfe në kundërshtim me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE –s Nr. 146, datë 24.12.2013 "Mbi kërkesën e kompanisë "Cez-Shpërndarje" sha, në administrim të përkohshëm, për vendosjen e faturimit aforfe". Sipas këtij vendimi "faturimi aforfe do të aplikohet për klientët familjare pa matës ose për konsumatorët me matës të demtuar dhe jashtë kushtit teknik. Faturimi do të aplikohet për një periudhë jo më shumë se 2 muaj".

Gjatë vitit 2014 janë vendosur faturime aforfe jashtë tabelës së përcaktuar nga ERE dhe gjithashtu në rastet e matësve të demtuar janë konstatuar raste ku faturimi aforfe është aplikuar nga kompania për një periudhë më të madhe se dy muaj. ERE ka trajtuar rreth 259 ankesa me objekt faturimin aforfe.

**Ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike.** Një shkelje tjetër është fakti që menjëherë pas vendosjes së "dëmit ekonomik", abonentëve iu është bërë ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike, duke i vënë përballë detyrimit të pagimit të vlerës së "dëmit ekonomik" pa e pasqyruar këtë vlerë në faturën përkatëse të energjisë elektrike, gjë e

cila bie në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, konkretisht me nenin 11.1 të kësaj kontrate ku citohet se "Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesi i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga Klienti". Në bazë të të dhënave që ERE disponon, janë trajtuar rreth 169 ankesa, për pjesën më të madhe të tyre nuk është kthyer përgjigje dhe nuk është bërë sistemimi përfundimtar i gjendjes reale të leximit të matësit.

**Aksesi për leximin e matësve nga ana e konsumatorëve.** Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, neni 7.3 i saj përcakton se furnizuesi është i detyruar të sigurojë aksesin e Klientit për leximin e aparatit matës në çdo kohë”. Lidhur me këtë fakt, ERE ka vërejtur se kompania “OSHEE”sha, nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e nenit 7.3 të Kontratës.

**Kolaudimi i matësve të energjisë elektrike.** Kërkesat nga konsumatorët për kolaudimin e matësve për vitin 2014 në ERE, kanë qenë më pak në krahasim me vitin 2013, (rreth 15 kërkesa). ERE i ka kërkuar kompanise së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike trajtimin e këtyre rasteve konform procedurave përkatëse.

**Cilësia e furnizimit me energji elektrike.** Problematike gjithashtu ka rezultuar edhe cilësia e tensionit të furnizimit me energji elektrike. Kjo problematikë është ndeshur më shumë në zonat rurale dhe tek subjekte të ndryshme private. Këto ankesa janë përcjellë në ERE në më të shumtën e rasteve nga MEI dhe Avokati i Popullit dhe institucione të tjera. Problemet me cilësinë e tensionit, janë të njohura dhe të pranuar nga “OSHEE”sha. Nga ana e ERE-s këto ankesa janë trajtuar, duke organizuar seancë dëgjimore, në të cilat i është kërkuar “OSHEE-se” të merret informacion i detajuar lidhur me shkaqet e ndërprerjeve dhe kohëzgjatjen e tyre.

**Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.** Problematike është paraqitur gjithashtu situata, e cila ka të bëjë me ndërrimin e matësve, të cilët janë jashtë kushtit teknik, brenda afateve të caktuara. Mosrespektimi i këtyre afateve ka sjellë ngarkimin e konsumatorëve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, faturim i cili nuk është bërë në bazë të legjislacionit në fuqi. Kjo pasi në Kontratën për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, në Nenin 8, pika 2, citohet se “nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero”. Ankimet për këtë problematikë kanë qenë të ndjeshme rreth 261 ankesa.

**Kontrata fiktive.** Theksojmë faktin se vazhdon të ndeshen probleme lidhur me kontrata fiktive të hapura në mënyrë të njëanshme nga ana e kompanisë. Këto kontrata janë kryesisht të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, ose janë kontrata të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve. Gjatë vitit 2014 janë trajtuar rreth 147 ankesa të kësaj natyre.

**Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për lidhjen e kontratave të reja.** Për këto raste konstatojmë vonesa në lidhjen e kontratave, mos transferim të kontratave për objektet që figurojnë debitorë. Nga ana jonë është udhëzuar të bëhet lidhja e kontratave për të gjithë ata

subjekte që nuk janë debitorë, udhezim i cili nuk është marrë parasysh nga ana e kompanisë.

**Fenomeni i moskreditimit të abonentëve.** Vazhdon të ndihet fenomeni i moskreditimit të abonentëve që megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e konsumit të energjisë, rezultojnë debitorë. Ky ka bërë që shumë konsumatorë të përballen me ndërprerjen e padrejtë të energjisë elektrike. Nga dokumentacioni që kemi shqyrtuar, kemi konstatuar se kemi të bëjmë me raste ku konsumatorët i kanë kryer pagesat kryesisht me bankë ose postë dhe në këto raste vërejmë mos rakordimin e faturave të paguara, por kemi edhe raste të kryerjes së pagesave në zyrat e shitjes dhe për të cilat mungon dokumentacioni i kryerjes së këtyre pagesave. Procedura e ndjekur për këta konsumatorë, ka qenë kryerja e verifikimit në vend

të Librezës origjinale apo pagesat e kryera ne Arkë apo Bankë, me Sistemin e Billingut të "OSHEE"sh.a, duke bërë me pas sistemimet e nevojshme.

### Treguesit e cilesise së shërbimit

TREGUESIT E CILESISE SE VAZHDUESHMERISE SE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE 2014																				
TL	SHKAKU I NDERPRERJES				NUMRI I Konsumatoreve te lidhur			Nderprerje te Planifikuara					Nderprerje te Pa Planifikuara					SAIFI	SAIDI	CAIDI
	Nderprerje e Planifikuuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e CEZ	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)			
Janar	39	5	13	116	1,163,467	589,633	573,834	61,776	11,969	49,806	141,011	90	801,060	235,697	565,363	2,314,704	502	0.74	2.11	2.85
Shkurt	59	3	17	88	1,163,467	589,633	573,834	141,564	30,737	110,827	587,453	126	636,043	202,990	433,053	1,613,356	327	0.67	1.89	2.83
Mars	80	10	16	72	1,163,467	589,633	573,834	288,282	76,264	212,018	791,304	192	504,109	136,931	367,178	1,401,990	353	0.68	1.89	2.77
Prill	116	3	18	84	1,163,467	589,633	573,834	451,095	165,110	285,985	1,419,399	349	679,107	199,318	479,790	1,725,262	414	0.97	2.70	2.78
Maj	103	11	42	73	1,163,467	589,633	573,834	425,281	140,467	284,814	1,158,097	279	938,640	186,559	752,091	4,234,321	631	1.17	4.63	3.95
Qershor	101	30	33	93	1,163,467	589,633	573,834	402,176	177,730	224,446	1,011,560	252	760,342	174,504	1,358,838	3,571,067	715	1.00	3.94	3.94
Korrik	73	25	1	112	1,163,467	589,633	573,834	258,909	80,081	178,828	776,947	178	713,870	172,833	541,037	2,596,291	602	0.84	2.90	3.47
Gusht	47	13	32	91	1,163,467	589,633	573,834	157,845	50,742	107,103	332,236	106	773,574	228,001	545,573	1,369,932	433	0.80	1.46	1.83
Shtator	78	25	45	124	1,163,467	589,633	573,834	352,285	72,420	279,865	996,183	216	993,324	303,042	690,282	2,952,936	869	1.16	3.39	2.93
Tetor	84	10	49	62	1,163,467	589,633	573,834	1,151,826	98,047	262,779	771,409	242	803,845	232,864	454,536	2,997,923	740	1.68	3.23	1.92
Nentor	65	29	52	99	1,163,467	589,633	573,834	345,421	111,384	233,837	907,295	164	1,062,436	334,624	727,812	2,559,633	466	1.21	2.97	2.46
Dhjetor	30	31	36	185	1,163,467	589,633	573,834	1,302,267	334,077	968,190	3,260,873	902	135,945	87,641	55,204	357,845	66	1.23	3.11	2.51

TM	SHKAKU I NDERPRERJES				NUMRI I Konsumatoreve te lidhur			Nderprerje te Planifikuara					Nderprerje te Pa Planifikuara					SAIFI	SAIDI	CAIDI
	Nderprerje e Planifikuuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e CEZ	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)			
Janar	104	58	10	2,343	1,163,467	589,633	573,834	143,513	22,821	120,692	368,322	271	3,316,105	758,561	2,557,540	5,988,797	6,564	2.97	5.46	1.84
Shkurt	110	39	3	1,957	1,163,467	589,633	573,834	141,019	41,886	99,133	322,300	254	2,613,064	445,689	2,167,375	4,024,048	4,733	2.37	3.74	1.58
Mars	145	145	3	2,387	1,163,467	589,633	573,834	1,359,824	265,379	1,094,445	419,938	384	3,335,276	600,876	2,733,573	5,171,098	14,109	4.04	4.81	1.19
Prill	239	66	1	2,613	1,163,467	589,633	573,834	278,940	71,624	207,506	835,351	722	3,413,139	633,937	2,780,042	6,452,729	9,443	3.17	6.26	1.97
Maj	262	79	4	2,387	1,163,467	589,633	573,834	309,540	42,475	267,065	881,522	761	3,203,884	731,290	2,472,594	5,422,073	5,632	3.02	5.42	1.79
Qershor	315	217	1	3,003	1,163,467	589,633	573,834	377,675	46,964	327,545	1,130,615	955	3,778,500	624,917	3,145,764	6,425,806	7,533	3.57	6.49	1.82
Korrik	197	242	14	2,682	1,163,467	589,633	573,834	209,234	41,646	166,911	572,421	585	3,589,222	541,218	5,176,515	6,192,075	7,743	3.26	5.81	1.78
Gusht	275	147	7	2,001	1,163,467	589,633	573,834	314,527	47,809	266,618	896,271	836	2,629,918	485,005	2,144,884	3,766,568	5,599	2.53	4.01	1.58
Shtator	214	188	2	3,502	1,163,467	589,633	573,834	215,909	39,863	169,816	496,580	541	4,445,444	752,906	3,697,853	10,896,814	11,985	4.01	9.79	2.44
Tetor	318	100	1	2,754	1,163,467	589,633	573,834	401,974	104,766	297,208	193,676	1,017	3,517,727	617,158	2,901,742	6,271,356	9,727	3.36	6.41	1.90
Nentor	133	110	13	2,746	1,163,467	589,633	573,834	124,064	11,336	112,728	377,225	447	3,602,732	786,392	2,816,340	7,632,432	8,347	3.20	6.88	2.14
Dhjetor	156	70	4	3,866	1,163,467	589,633	573,834	206,388	32,834	173,554	644,174	500	4,668,751	986,934	3,681,817	13,863,758	20,853	4.19	12.46	2.97

Burimi: ERE

## 9. Situata e Synuar

### 9.1 Vizioni

Krijimi dhe funksionimi i një tregu eficient, konkurrues dhe të integruar të energjisë elektrike për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e një sistemi shpërndarje që operon sipas praktikave më të mira në përmbushjen e funksionit të sigurimit të qëndrueshmërisë dhe cilësisë në shërbimin për konsumatorët, mbrojtjen e klientëve në nevojë, mbrojtjen e mjedisit.

### 9.2 Misioni

Garantimi i një furnizimi cilësor dhe të sigurt me energji elektrike për të gjithë klientët, nëpërmjet një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve, sigurimin e qëndrueshmërisë financiare, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet sociale, nëpërmjet operimit dhe shfrytëzimit me operacionalitet të lartë, si dhe zhvillimit të rritjes të shpërndarjes.

## 10. Objektivat

### 10.1 Objektivat strategjikë

Objektivat strategjikë të OSHEE-së do të synojnë në:

1. Sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm dhe pa ndërpreje me energji elektrike për të gjithë territorin e vendit;
2. Sigurimin dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimit ndaj të gjithë konsumatorëve;
3. Reduktimin e humbjeve dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet rritjes së arkëtimeve, duke siguruar kështu efikasitetin e sistemit;
4. Plotësimin me fleksibilitet të nevojave për energji elektrike, sipas kërkesës;
5. Sigurimin e një tranzicioni të kontrolluar të procesit të liberalizimit të tregut energjetik (Rimodelimi i kompanisë/aktivitetit bazuar në transformimet rregullative);
6. Përmirësimin e performancës së kompanisë si dhe monitorimin e vazhdueshëm të saj;
7. Synimin e një sistemi të qëndrueshëm financiarisht dhe me aftësi likuiduese;
8. Sigurimin e standarteve mjedisore;
9. Hartimin dhe zhvillimin e çështjeve sociale të kompanisë;
10. Sigurimin e kapaciteteve të duhura, duke siguruar eficienten operacionale, për t'u përgjigjur nevojave të konsumatorëve me synim arritjen e standarteve për shërbimet e ofruara;

### 10.2 Objektivat bazikë

Për realizimin e objektivave strategjikë, OSHEE duhet të detajojë e zbatojë objektivat bazikë. Këto objektiva bazikë janë:

#### 10.2.1 Sigurimi i cilësisë në shërbimin ndaj klientit

- Krijimi i kushteve për të matur në mënyrë periodike performancën në drejtim të cilësisë së shërbimit;



- Krijimi i një Call Center që do të përmirësojë kujdesin ndaj klientëve duke patur si qëllim regjistrimin dhe trajtimin me efikasitet të ankesave të klientëve;
- Kryerja e një studimi shoqëruar me Planin e Veprimit për saktësimin e bazës së të dhënave të elementeve të faturës në sistemin e billingut për të gjithë klientët duke krijuar mundësinë e monitorimit me bazë kabine fideri;
- Kryerja e një studimi me qëllim përcaktimin e detyrës së projektimit për një sistem të ri Billingut bashkëkohor dhe që plotëson kërkesat e OSHEE;
- Optimizimi i kanaleve të pagesave;
- Centralizimi i procesit të billingut;
- Centralizimi i funksioneve të back-office.

### 10.2.2 Reduktimi i humbjeve, rritja e efikasitetit të energjisë

- Përgatitja e një studimi dhe një plani për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura;
- Kryerja e një studimi tekniko-ekonomik shoqëruar me një plan veprimi të detajuar lidhur me plotësimin me matje të të gjithë klientëve, kabinave e fiderave;
- Kryerja e një studimi që i hap rrugë llogaritjes së humbjeve teknike në rrjetet e shpërndarjes;
- Përcaktimi i objektivave të humbjeve dhe arkëtimeve për çdo kabinë;
- Sigurimi i të dhënave të arkëtimit në kohë reale nga të gjithë aktorët e përfshirë (çdo ditë);
- Përgatitja e një plani të skeduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;
- Leximi i vazhdueshëm;
- Përgatitja e Planit të monitorimit periodik mujor të Bilancit energjistik me bazë kabine;
- Organizimi i ndërprerjes së lidhjeve abuzive dhe realizimit të lidhjeve të reja në afatet e përcaktuara;
- Plotësimi me lexues të kualifikuar në bazë të normave të paracaktuara dhe pajisja e tyre me mjetet e nevojshme;
- Ballafaqimi i të dhënave periodike mujore të shitjes dhe arkëtimit nëpërmjet sistemit të billingut;
- Investimi në procese dhe mjete të reja për arkëtimet;
- Organizimi në bazë prcesi i aktivitetit të shpërndarjes;
- Implementimi i sistemeve të informacionit teknologjik (TIS);
- Implementimi i projektit SKADA në nënstacionet e OSHEE, duke bërë të mundur monitorimin online të paisjeve dhe shpërndarjen e flukseve të energjisë;
- Optimizimi i humbjeve jo teknike (NTL Optimization);
- Prezantimi i teknologjisë së leximit 3M.

### 10.2.3 Plotësimi me fleksibilitet i nevojave për energji

- Inventarizimi i plotë i aseteve të kompanisë;
- Përgatitja e një plani investimesh 2015 – 2020 të priorizuar sipas nevojës dhe efekteve përmirësuese;
- Sigurimi i mjeteve për mirëmbajtjen e investimeve prioritare në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimit;
- Thithja e financimeve për investimet e parashikuara;
- Implementimi i projektit GIS, duke krijuar të dhëna të sakta online për të gjitha paisjet e nënstacioneve dhe rrjetin shpërndarës TM/TU;
- Optimizimi i rrjetit, mirëmbajtjes, operimit dhe matjes;

#### 10.2.4 Tranzicioni i kontrolluar i procesit të liberalizimit të tregut energjetik

- Hartimi i një plani për tranzicionin;
- Krijimi i një strukture organizative të OSHEE në kushtet e një shoqërie me 100% aksione Shtetërore dhe e manaxhuar në disa pjesë territoriale me ndarje të qartë Shpërndarje-Furnizim;
- Krijimi i qendrave të kostos bazuar në linjat e biznesit;
- Delegimi të të tretët i disa proceseve kryesore si dhe disa aktiviteteve jo kryesore (mbështetëse), mbi bazë të një vlerësimi të duhur kosto-përfitim;

#### 10.2.5 Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së kompanisë

- Organizimi i ri i shitjeve;
- Sistemi i ri i Burimeve ;
- Standartizimi në Shpërndarje ;
- Optimizimi i funksioneve mbështetëse;
- Rebranding;

### 11. Standartet e Performancës në Sistemin e Shpërndarjes

#### 11.1 Fusha e aplikimit

Për zbatimin e standarteve të performancës së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, janë përcaktuar treguesit dhe nivelet e performancës lidhur me:

- a. Lidhjen e Përdoruesve në Sistemin e Shpërndarjes;
- b. Sigurimin, si të vazhdimësisë së furnizimit, ashtu dhe të cilësisë së Energjisë Elektrike të shpërndarë;
- c. Ndërprerjet e programuara, si pasojë e punimeve të programuara të mirëmbajtjes dhe riparimit;
- d. Ndërprerjet e pa-programuara si pasojë e avarive dhe defekteve të ndryshme;
- e. Zgjidhjen e ankesave të Përdoruesve në lidhje me cilësinë e Energjisë Elektrike;
- f. Zgjidhjen e ankesave të Përdoruesve për probleme të tjera në përgjithësi.

Këto standarte do të aplikohen për marëdhëniet ndërmjet OSHEE dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes kur ato:

1. Kanë instalime në tensionin nominal alternativ, në kufijtë 0.4 kV deri 110 kV dhe frekuencë 50 Hz;
2. Nuk shkaktojnë çrregullime në furnizimin e Përdoruesve të tjerë të Sistemit të Shpërndarjes nëpërmjet regjimit të tyre të punës;
3. Janë brenda fuqisë maksimale dhe kushteve të tjera teknike të parashikuara në kontratën e miratuar.

Këto standarte nuk do të aplikohen në rastet e:

1. Forcave madhore;
2. Operimit (punës) jo-normal të Sistemit të Shpërndarjes, të përcaktuar nga OSHEE;
3. Ndodhive aksidentale të shkaktuara nga palët e treta.

#### 11.2 Atributet dhe kompetencat

Për respektimin e standarteve të performancës, OSHEE duhet të sigurojë:

1. Strukturë të aftë për zgjidhje të ankesave dhe peticioneve të Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes sipas Kodit të Shpërndarjes dhe Legjislacionit në fuqi;
2. Evidenca të aplikimeve për lidhjet në rrjet dhe njoftimet e lëshuara për pranimin teknik të lidhjes;
3. Evidencë të rezultateve të aktivitetit që ka të bëjë me cilësinë e Energjisë Elektrike të shpërndarë tek klientët dhe Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes;
4. Planifikim të punimeve të programuara për mirëmbajtje dhe riparime;
5. Vazhdimësi të shërbimeve të shpërndarjes, të kryera për Përdoruesit.

### 11.3 Treguesit kryesorë të performancës

Përgjegjësia e OSHEE në lidhje me furnizimin e Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes me Energji Elektrike përfundon në pikën ndarëse kufitare të instalimeve ndërmjet palëve, siç specifikohet në kontratën për shërbimin e shpërndarjes. Vendi dhe numri i pikave ndarëse propozohet nga OSHEE dhe vendoset me marrëveshje të ndërsjelltë me Përdoruesin e Sistemit të Shpërndarjes.

#### 11.3.1 Ndërprerjet e furnizimit me energji Elektrike – ndërprerjet aksidentale

OSHEE ka për detyrë të rivendosë furnizimin sa më shpejt që të jetë e mundur për Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes, të dëmtuar nga ndodhite aksidentale, të cilat kanë patur si rezultat ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike. OSHEE regjistron të gjitha ankesat, ndërsa ankuesi duhet të informohet për numrin e regjistrimit dhe të informohet për zgjidhjen e ankesës brenda afateve ligjore.

Gjithashtu, OSHEE ka për detyrë të informojë ankuesit për kohëzgjatjen e përafërt deri në rifillimin e furnizimit. OSHEE duhet të sigurojë mbërritjen e ekipit të ndërhyrjes, në minimumin e mundshëm të kohës, që nga momenti i njoftimit të ndërprerjes, dhe ta eliminonjë atë sa më shpejt që të jetë e mundur.

#### 11.3.2 Siguria e furnizimit

OSHEE ndërmerr veprime të arsyeshme për të ruajtur sigurinë e furnizimit nga Sistemi i Shpërndarjes për Përdoruesit e vet. Furnizimi nuk mund të jetë i siguar përderisa ka defekte, ndërprerje të planifikuara për mirëmbajtje dhe ndërprerje për realizimin e punimeve të reja, si dhe rrethana të tjera që janë jashtë kontrollit të OSHEE dhe mund të shkaktojnë ndërprerje. Në raste të tilla, OSHEE ka për detyrë të ndërmarrë veprimet e duhura për të rinisur furnizimin sa më shpejt që të jetë e mundur.

#### 11.3.3 Llojet e ndërprerjeve

Llojet e ndërprerjeve janë:

1. **Ndërprerjet si rezultat i defekteve:** OSHEE ndërmerr veprimet e duhura për të rifilluar sa më shpejtë furnizimin me energji elektrike të klientëve të vet sipas paragrafeve të Kodit të Shpërndarjes. Në rrethana të veçanta, kohëzgjatja e ndërprerjeve mund të jetë e madhe dhe në këto raste OSHEE informon Përdoruesit për progresin e bërë;
2. **Ndërprerjet e planifikuara:** OSHEE ka për detyrë të njoftojë ndërprerje të energjisë elektrike për mirëmbajtjet dhe riparimet e programuara. OSHEE e bën njoftimin me mjetet e informimit publik, dhe deklaron madhësinë e zonës së prekur.

3. **Kufizimet e Furnizimit:** Në disa rrethana specifike, mund të jetë e nevojshme tu kërkohet përdoruesve nga ana e OSHEE të reduktojnë ngarkesën e tyre ose të përdorin burimet rezervë të furnizimit atje ku është e mundur. Në këto situata, OSHEE ka për detyrë të bëjë të gjitha përpjekjet për të ruajtur furnizimin me energji elektrike.

#### **11.4 Treguesit vjetorë**

Treguesit e rezultateve vjetore të performancës së Sistemit të Shpërndarjes konsistojnë në:

- a) Numrin e ndërprerjeve të programuara sipas niveleve të tensioneve;
- b) Kohëzgjatjen e ndërprerjeve të programuara sipas niveleve të tensionit;
- c) Numrin e Përdorueseve të prekur nga ndërprerje të tilla në afate kohore sipas niveleve të tensionit dhe sipas kategorisë së konsumatorëve;
- d) Numrin e defekteve e avarive;
- e) Kohëzgjatja e ndërprerjeve nga defektet dhe avaritë sipas niveleve të tensionit;

##### **11.4.1 Treguesit vjetorë të performancës sipas niveleve të tensionit**

Treguesit Vjetorë të Performancës sipas Niveleve të Tensionit në Sistemin e Shpërndarjes konsistojnë në:

- a) Numrin e ankimeve për nivelet e tensionit
- b) Numrin e ankimeve të cilave i është dhënë përgjigje;
- c) Numrin e ankimeve për të cilat është normalizuar gjendja;
- d) Numrin e ankimeve të cilave nuk i është dhënë përgjigje.

##### **11.4.2 Treguesit vjetorë lidhur me ankimet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes**

Treguesit Vjetorë të Performancës në Sistemin e Shpërndarjes sipas ankesave të Përdoruesve:

- a) Numrin e ankimeve me shkrim;
- b) Numrin e ankimeve të specifikuar, të cilave i është dhënë një përgjigje;
- c) Numrin e ankimeve të specifikuar, të cilave nuk i është dhënë një përgjigje;
- d) Numrin e ankimeve të i është dhënë zgjidhje.

##### **11.4.3 Treguesit e Vazhdimësisë së Shërbimit**

Treguesit e vazhdimësisë së shërbimit konsistojnë në:

- a) Koeficienti i ndërprerjes së energjisë për klient (SAIFI);

Ky tregues llogaritet si raport: Numri i konsumatorëve të prekur nga ndërprerjet/Numrin e konsumatorëve gjithsej (SAIFI)

- b) Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjeve për klient (SAIDI). Ky tregues llogaritet si raport: Numri i orëve të ndërprerjeve gjithsej/Numrin e klientëve gjithsej
- c) Numri i përdoruesve të prekur nga ndërprerje të tilla në afate kohore sipas niveleve të tensionit dhe sipas kategorisë së konsumatorëve

##### **11.4.4 Treguesit vjetorë tregtarë të performancës**

Treguesit vjetorë tregtarë të performancës

- a) Reduktimin e ankesave

## 12. Plani i Përmirësimit të Performancës

Bazuar në Objektivat Strategjike është shumë e nevojshme që të bëhen ndryshime në aspekt të arritjes së rezultateve më të mira dhe afatgjata. Konvertimi i këtyre Objektivave në një numër veprimesh konkrete dhe rezultate të matshme, e gjitha e përfshirë nën strukturën e një Programi të Përmirësimit të Performancës do të mundesojë realizimin e këtij qëllimi. “Hendeku i Performancës” ndërmjet situatës ekzistuese dhe situatës së ardhshme do të mund të ngushtohet vetëm si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së kompanisë. Përcaktimi i Standarteve të Performancës, me qëllim vlerësimin e potencialit të mundshëm për përmirësim të saj, nevojat e analizuar të burimeve, mënyrat dhe rrugët për arritjen e standarteve, matja e standarteve, vlerësimi i performancës aktuale me atë të pritshme, shoqëruar më tej me ndërhyrjet e nevojshme për korrigjim do të sigurojnë hapat kryesorë të domosdoshme drejt arritjes së realizimit të përmirësimit të performancës së kompanisë.

### 12.1 Objektivat për periudhën 2016-2020

	Objektivat	Matjet	Targeti						Njësia
			Vlera						
			Kufiri Baze 2015	2016	2017	2018	2019	2020	
1	Të sigurojë një furnizim të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje me energji elektrike për të gjithë territorin e vendit	▪ SAIFI;	44	37	30	24	18	12	(nr.)
		▪ SAIDI	6000	4900	3700	2600	1800	1100	(min.)
2	Te sigurojë rritje të kapaciteteve, për të përmirësuar efikasitetin e operacioneve, që të përgjigjet nevojave të konsumatorit për standarde të shërbimit dhe ofruar	▪ Planifikimi Trajnimeve	73	75	75	65	60	-	(nr.)
		▪ Ulja e Qarkullimit të Personelit	15.3	15	10	8	7	-	(%)
		▪ Përmirësimi i Menaxhimit të Performancës	25	25	25	25	25		(nr.)
3	Te sigurojë dhe ruajë cilësinë e shërbimit ndaj të gjithë konsumatorëve;	▪ Reduktimi i Ankesave	10	15	25	30	35	40	(%)
4	Te reduktojë humbjet dhe të rrisë të ardhurat nëpërmjet rritjes së arketimit, duke siguruar kështu efikasitetin e sistemit	▪ Arketimi	87.5	91.5	93.5	96.5	-	95	(%)
		▪ Humbjet	31.8	26,9	23,7	19,8	-	-	(%)
		▪ Teknike	21	19	17.7	16.8	-	-	(%)
		▪ Jo-Teknike	10.8	7.9	5	3	2	2	(%)
5	Te përmirësojë performancën dhe monitorimin e kompanisë.	▪ Ndërtimi dhe ndjekja e Benchmarking	100	100	100	100	100	100	%

6	Te siguroje standarte Mjedisore dhe te fokusohet ne ceshtjet sociale te kompanise	▪ Projekte te shoqeruara me vleresimin mjedisor	100	100	100	100			%
		▪ Ceshtje sociale te realizuara	100	100	100	100	-	-	%

### 13. Burimet Njerëzore

Punonjësit e kompanisë OSHEE konsiderohen padyshim burimi njerëzor më i çmuar që i siguron kompanisë zhvillim dhe mbarëvajtje. Janë ata që bëjnë të mundur ofrimin e një shërbimi të lart dhe profesional në të gjitha pikëpamjet kundrejt konsumatorëve. Kompania duhet të synojë në krijimin dhe inkurajimin e një mjedisi konkurrues midis punonjësve.

- Kompania duhet të synojë në krijimin e një sistemi të ri incentivues të zbatueshëm për të gjithë stafin bazuar në një performancë që kërkon shumë punë si dhe bazohet në sjelljet, ai duhet të marrë parasysh matësit ekonomiko-financiar dhe ato cilësor-sasiore. Sistemi duhet të ofrojë mundësinë për të zgjedhur nxitësa strategjik për çdo rol dhe vendodhje dhe mundësinë për të përcaktuar pagesa të ndryshme të planifikuara në përputhje me natyrën e treguesve kryesorë të performances. Ky sistem dhe procesi i aplikimit të tij synojnë të rrisin garën profesionale, si dhe të shërbejnë si instrument për identifikimin dhe administrimin e karrierës të punonjësve potencialë
- Rritja arsimore dhe profesionale është një element shumë i rëndësishëm për kompaninë, duke synuar kështu balancimin e arsimit dhe të përvojës së punës së tyre me rolet dhe pozicionet që ato mbajnë.
- Kompania duhet të synojë të kthehet në një punëdhënës i cili ofron mundësi të barabarta punësimi. Politika e burimeve njerëzore të kompanisë duhet të orientohet në ofrimin e mundësive të barabarta të punësimit për të gjithë personat e kualifikuar pa dallim race, seksi, feje, moshe, kombësie, origjine dhe paaftësie fizike. Politikat e burimeve njerëzore duhet të orientohet në dhënien e mundësive të barabarta në lidhje me punësimin, promovimin, pagat, përfitimet si dhe privilegje të tjera, afatet dhe kushtet e punësimit.
- Strategjia dhe politikat e burimeve njerëzore duhet të jenë të orientuara në drejtim të rritjes profesionale të stafit dhe të nivelit të ekspertizës, forcimit dhe ruajtjes së një mjedisi pune motivues dhe llogaridhënës për punonjësit, arritjes së qëndrueshmërisë dhe vazhdueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve administrative, si dhe përmirësimit të bazës rregullative dhe strukturës organizative të kompanisë.
- Përmirësimet në strukturën organizative kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore, me qëllim rritjen e efikasitetit të kompanisë, duke forcuar bashkërendimin dhe komunikimin ndër departamental, përshtatjen e këtyre strukturave me detyrat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të kompanisë, si dhe arritjen e standarteve të vendosura nga praktikatat më të mira në këtë lloj industrie.

### 14. Analiza e Riskut

Performanca nën optimalen, mungesa e investimeve dhe manaxhimi i dobët nga ana e sektorit të shpërndarjes, kanë rezultuar në humbje të larta të energjisë, arkëtime të ulta dhe në erozion të kapitalit të kompanisë në një masë më të madhe se ajo që parashikohej në kohën e privatizimit.

Zbatimi i Planit strategjik mbart edhe disa risqe si më poshtë:



1. **Risku financiar.** Shumat dhe qëllimet e financimit shtesë që nevojitet varet nga shumë faktorë duke marrë në konsideratë modelin aktual të tregut si dhe ndryshimet e pritshme. Për më tepër, faktorë të tjerë si kurset e këmbimit, nivelet e interesave, etj. të cilat janë përtej kontrollit të Qeverisë dhe të OSHEE;
2. **Aspektet Ligjore e Rregullative.** Pavarësisht miratimit të Ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike, përgatitja e të gjitha akteve nën-ligjore të domosdoshme për ecurinë e mbarëvajtjen e sektorit do të kërkohet kohë;
3. **Sistemi Gjygjësor.** Sistemi gjygjësor duhet të jetë i predispozuar e i gatshëm të zbatohet për abuzuesit e energjisë elektrike;
4. **Niveli i Lartë i Korrupsionit.** OSHEE duhet të jetë e vendosur për të luftuar korrupsionin në radhët e punonjësve të saj e nuk duhet të pranojë ndërhyrje politike për të rimarrë në punë punonjësit e pandershëm.
5. **Aftësitë Drejtuese të OSHEE.** Mbetet për tu parë nëse stafi drejtues i OSHEE do të vazhdojë me sukses punën për pakësimin e humbjeve dhe rritjen e nivelit të arkëtimit. Gjithashtu, mbetet për tu parë aftësia e stafit drejtues të OSHEE për t'i rezistuar presionit të jashtëm;
6. **Reduktimi i Numrit të Konsumatorëve pa Matësa.** Kjo është një çështje kritike pasi duhet të instalohen në mënyrë të sigurtë që të reduktohen humbjet jo-teknike;
7. **Rritja e Tarifave.** Plani për shpërbajtjen e konsumatorëve nga linjat 35KV dhe 10KV parashikon që ata të paguajnë energjinë jo më me tarifa të rregulluara por bazuar në çmimet e importit.
8. **Administrata Tatimore.** Kjo administratë luan një rol të rëndësishëm në rritjen e nivelit të arkëtimit e detyrimeve të prapambetura nga konsumatorët privatë pasi ajo kontrollon nëse janë paguar faturat e energjisë që përfshihen në pasqyrat financiare të subjekteve duke kontribuar kështu në nxitjen e pagesës së këtyre faturave

## 15. Parashikimet Financiare 2015 – 2020

### 15.1 Nevoja dhe mundësitë për investime dhe kostot e mirëmbajtjes

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, për periudhën 2010 – 2014 vihet re një realizim mjaft i ulët i investimeve të planifikuara. Gjithashtu, edhe kostot e mirëmbajtjes për periudhën 2010 – 2014 rezultojnë të ulta. Janë pikërisht këta tregues që kanë çuar në përkeqësimin teknik dhe të cilësisë së rrjetit të shpërndarjes.

Viti	Investimet			Mirëmbajtja		
	Plan	Fakt	Realiz	milione leke	Versus invest plan	Versus invest realiz
	milione leke		%		%	
2010	4,339	-		358	8%	-
2011	4,896	1,947	40%	821	17%	42%
2012	6,500	766	12%	464	7%	61%
2013	6,693	449	7%	334	5%	74%
2014	7,003	607	9%	417	6%	69%
2015	5,861			2,855	49%	-
2016	6,283			1,574	25%	-
2017	7,924			1,824	23%	-
2018	8,880			2,097	24%	-
2019	9,534			2,387	25%	-
2020	5,200			2,513	48%	-

Burimi: OSHEE

## 14.2 Supozimet bazë

Në vlerësimet e OSHEE për vitet 2015 – 2020, janë parashikuar kosto për mirëmbajtjen duke konsideruar një normë 3% të vlerës së aseteve ekzistuese + 0.7% të vlerës së aseteve të reja. Duke konsideruar tregues të tjerë, këto kosto zënë rreth 6% të të ardhurave të konsoliduara ose 6% të vlerës së aseteve egzistuese për vitin 2015; dhe rreth 3%-4% për vitet 2016 – 2020. Një tregues i tillë në disa kompani të ngjashme të rajonit varion nga 3% - 7% të të ardhurave ose nga 2% - 7% të vlerës së aseteve të tyre.

Nisur nga realizimi në periudhat e mëparshme, vlerat e parashikuara të kostove të mirëmbajtjes nga ana e OSHEE janë në nivele të larta dhe “të dyshimta” në realizimin e tyre.

Është i këshillueshëm vlerësimi i këtyre kostove në mënyrë sa më racionale me qëllim alokimin e fondeve optimale për këtë zë, duke mos cënuar fondet e alokuara për zëra të tjerë të kostove operative, investimeve të reja dhe/ose uljes së nivelit të detyrimeve ndaj palëve të treta. Në përcaktimin e tyre të drejtë, nga ana e OSHEE duhet të bëhet një analizë e detajuar mbi asetet dhe kostot e zëvendësimit të tyre.

Gjatë viteve 2015 – 2020, nga ana e OSHEE është parashikuar të realizohet një nivel i investimeve në një vlerë mesatar prej ALL 43.7 miliard në vit.

Është e rëndësishme që nevojat emergjente për investime të reja, me qëllim realizimin e objektivave dhe rritjen e performancës në sektorin e shpërndarjes, të mund të kryhen dhe/ose të përqëndrohen më tepër gjatë viteve të rimëkëmbjes së sektorit energjitik.

Pavarësisht nevojës për investime të reja, nga ana e OSHEE duhet të merren parasysh mundësitë reale të mbulimit me fonde si dhe çfarë është më e rëndësishme, hartimin dhe finalizimin e një plani strategjik të ecurisë në sistemin e shpërndarjes për vitet në vijim.

### 14.3 Parashikimet e shitjeve

Në vlerësimet për vitet 2015 – 2020, për sa i takon treguesit të sasisë së shitur të energjisë elektrike konsumatorëve tariforë, duhet të gjykohet në një mënyrë sa më racionale mbi elementë të tillë si trendi historik, rritja ekonomike, elasticiteti i kërkesës, etj.

Duke qenë se sasia e shitjes së energjisë elektrike përbën elementin thelbësor në përcaktimin e të ardhurave të kompanisë, mbetet mjaft sensitive për të gjithë treguesit e tjerë të parashikuar në planin e biznesit, përcaktimi sa më realist i këtij treguesi.

### Bilanci energjetik për vitet 2015 – 2020

	Njesia	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energjia në Rrjetin e Shperndarjes	GWh	6,936	6,615	6,480	6,373	6,327	6,148	5,851
Humbjet në Rrjetin e Shperndarjes	GWh	2,636	2,103	1,743	1,447	1,253	922	468
	%	38.0%	31.8%	26.9%	22.7%	19.8%	15.0%	8.0%
Teknike		17.0%	21.0%	19.0%	17.7%	16.8%	13.0%	6.0%
Jo Teknike		21.0%	10.8%	7.9%	5.0%	3.0%	2.0%	2.0%
Shitjet për konsumatorët fundorë/tariforë	GWh	4,300	4,511	4,737	4,926	5,074	5,226	5,383

Burimi: OSHEE

### Vlerësimet e Strukturës së Shitjes së Energjisë për vitet 2015 – 2020

Viti 2015	Numri i klienteve	Shitjet e energjise (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (mln/Lek)	Faturimi (mln/Lek)	Arketimi (mln/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore në 35 kV		45	9.50	429	515	515	100.00%
Konsumatore në 20/10/6 kV		807	11.00	8,872	10,647	9,050	85.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		9	7.10	66	80	68	85.00%
Konsumatore në 0.4 kV		989	14.00	13,841	16,610	14,024	84.43%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		45	7.60	341	409	348	85.00%
Familjare		2,617	9.50	24,857	29,829	25,951	87.00%
	0	4,511	10.73	48,407	58,089	49,954	86.00%

Burimi: OSHEE

Viti 2016	Numri i klienteve	Shitjet e energjise (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (000/Lek)	Faturimi (000/Lek)	Arketimi (000/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore në 35 kV		47	9.50	451	541	541	100.00%
Konsumatore në 20/10/6 kV		847	11.00	9,316	11,179	10,659	95.35%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		10	7.10	70	84	74	89.00%
Konsumatore në 0.4 kV		1,038	14.00	14,533	17,440	15,522	89.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		47	7.60	358	429	378	88.00%
Familjare		2,747	9.50	26,100	31,320	27,718	88.50%
	0	4,737	10.73	50,827	60,993	54,892	90.00%

Burimi: OSHEE

Viti 2017	Numri i klienteve	Shitjet e energjise (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (000/Lek)	Faturimi (000/Lek)	Arketimi (000/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore në 35 kV		49	9.50	469	562	562	100.00%
Konsumatore në 20/10/6 kV		881	11.00	9,689	11,626	11,161	96.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		10	7.10	72	87	79	91.00%
Konsumatore në 0.4 kV		1,080	14.00	15,115	18,138	16,505	91.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		49	7.60	372	447	406	91.00%
Familjare		2,857	9.50	27,144	32,573	29,641	91.00%
	0	4,926	10.73	52,861	63,433	58,356	92.00%

Viti 2018	Numri i klienteve	Shitjet e energjië (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (000/Lek)	Faturimi (000/Lek)	Arketimi (000/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore ne 35 kV		51	9.50	483	579	579	100.00%
Konsumatore ne 20/10/6 kV		907	11.00	9,979	11,975	11,975	100.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		11	7.10	75	89	86	96.00%
Konsumatore ne 0.4 kV		1,112	14.00	15,568	18,682	17,793	95.24%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		50	7.60	383	460	437	95.00%
Familjare		2,943	9.50	27,958	33,550	31,201	93.00%
	0	5,074	10.73	54,446	65,336	62,071	95.00%

Burimi: OSHEE

Viti 2019	Numri i klienteve	Shitjet e energjië (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (000/Lek)	Faturimi (000/Lek)	Arketimi (000/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore ne 35 kV		52	9.50	497	597	597	100.00%
Konsumatore ne 20/10/6 kV		934	11.00	10,279	12,334	12,334	100.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		11	7.10	77	92	88	96.00%
Konsumatore ne 0.4 kV		1,145	14.00	16,035	19,242	18,326	95.24%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		52	7.60	395	474	450	95.00%
Familjare		3,031	9.50	28,797	34,556	32,138	93.00%
	0	5,226	10.73	56,080	67,296	63,933	95.00%

Burimi: OSHEE

Viti 2020	Numri i klienteve	Shitjet e energjië (GWh)	Çmimi (Lek/kWh)	Te ardhurat (000/Lek)	Faturimi (000/Lek)	Arketimi (000/Lek)	Arketimi %
		1	2	3=1*2	4=3*20%	5	6
Konsumatore ne 35 kV		54	9.50	512	615	615	100.00%
Konsumatore ne 20/10/6 kV		962	11.00	10,587	12,704	12,704	100.00%
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV		11	7.10	79	95	91	96.00%
Konsumatore ne 0.4 kV		1,180	14.00	16,516	19,820	18,876	95.24%
Furra buke dhe prodhim mielli 0.4 kV		54	7.60	407	488	464	95.00%
Familjare		3,122	9.50	29,661	35,593	33,102	93.00%
	0	5,383	10.73	57,762	69,315	65,851	95.00%

Burimi: OSHEE

## Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2015 – 2020 (milion lekë)

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid
Totali i te Ardhurave Operative	47,252	49,231	51,652	53,717	55,334	56,999	58,686
Totali i Shpenzimeve Operative	-48,177	-45,865	-43,098	-41,961	-41,786	-41,056	-39,207
Rezultati Operativ	-925	3,367	8,553	11,756	13,548	15,943	19,479
Te Ardhurat Financiare							
Totali i te Ardhurave Financiare	73	50	50	50	50	50	50
Totali i Shpenzimeve Financiare	-1,217	-982	-880	-960	-915	-596	-408
Rezultati Financiar	-1,144	-932	-830	-910	-865	-546	-358
Fitimi para taksave dhe te jashtezak	-2,069	2,435	7,723	10,846	12,683	15,397	19,121
Te Ardhura/(Shpenzime) te jashtezak	0	0	0	0	0	0	0
Fitimi para taksave	-2,069	2,435	7,723	10,846	12,683	15,397	19,121
Tatim Fitimi	0	-1,519	-1,296	-1,741	-1,976	-2,385	-2,946
Fitimi i Vitit	-2,069	915	6,427	9,105	10,707	13,012	16,175
EBIT	-1,656	3,417	8,603	11,806	13,598	15,993	19,529
EBITDA	1,290	6,594	11,990	15,457	17,545	20,258	23,968
Tatim Fitimi	15.0%	15.0%	15.0%	15.0%	15.0%	15.0%	15.0%

Tabela tregon në mënyrë të përbledhur vlerësimet e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2015-2020.

### Pasqyra e Fluksit të Parasë 2015 – 2020 (milion lekë)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid	OSHEE Konsolid
<b>Aktivitet Operativ:</b>						
Fitim/(humbja) e vitit	915	6,427	9,105	10,707	13,012	16,175
Amortizimi	3,178	3,387	3,651	3,947	4,265	4,438
Amortizimi i granteve	0	0	0	0	0	0
Povizioni	1,220	915	762	490	504	519
Fluksi i Parase i gjeneruar nga aktiviteti operativ	5,313	10,729	13,517	15,144	17,781	21,133
(Zmadhim)/Pakesim i magazines	-21	0	0	0	0	0
(Zmadhim)/Pakesim i debitorëve per energjine	1,376	-5,029	-3,930	-2,058	-2,125	-2,194
(Rritje)/Pakesim i debitorëve te tjere	182	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakesim) ne detyrimet afatshkurtra	0	0	0	0	0	0
Fluksi i Parase i gjeneruar nga aktiviteti operativ	6,849	5,700	9,587	13,085	15,656	18,939
<b>Investimet:</b>						
Blerje e asetëve fikse	-5,861	-6,283	-7,924	-8,880	-9,534	-5,200
Fluksi i parase nga investimet	-5,861	-6,283	-7,924	-8,880	-9,534	-5,200
<b>Aktiviteti financiar:</b>						
Rritje ne kredite	3,303	3,096	2,781	0	0	0
Pagesa Principali	-4,583	-3,436	-3,466	-3,208	-366	-366
Fluksi i parase nga aktiviteti financiar	-1,280	-340	-685	-3,208	-366	-366
Bilanci i fluksit te parase te ushtrimit	-292	-923	978	997	5,756	13,373
Gjendja parase ne fillim te periudhes	1,830	1,538	615	1,593	2,590	8,346
Gjendja parase ne fund te periudhes	1,538	615	1,593	2,590	8,346	21,718

Vlerësimet në fluksin e parasë për vitet 2015 – 2020 janë bërë duke konsideruar mbulimin e plotë të aktivitetit të vitit korrent.

Siç mund të vërehet, gjatë viteve 2015 – 2018, fondet e nevojshme për realizimin e treguesve të parashikuar, janë në nivelet e reacionalizuara dhe të limituara, ndërkohë që gjatë viteve 2019 – 2020 ka fonde të cilat mund të shfrytëzohen në favor të shlyerjes së detyrimeve të akumuluar dhe/ose investimeve të reja të tjera.

Një pjesë e investimeve të parashikuara për vitet 2015 – 2018, për efekt të mungesës së fondeve mund të shtyhen për në vitet 2019 – 2020.

Parashikimet financiare paraqiten në mënyrë më të detajuar në Aneksin 1, “Anekset e Planit të Masave të OSHEE 2015 – 2020”.

#### 14.4 Faktorë të rëndësishëm për t’u konsideruar

Është thelbësore që në vlerësimet dhe ecurinë e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndikojnë një sërë faktorësh të cilët kanë një ndikim të konsiderueshëm në aktivitetin e OSHEE. Ndër faktorët më të rëndësishëm renditen:

**1. Efektet e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike.** Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike, për sa i përket sektorit të shpërndarjes, mbeten të rëndësishme vlerësimet mbi skenarët e pritshëm të trajtimit të konsumatorëve të energjisë elektrike si dhe duke konsideruar sistemin e shpërndarjes në dy komponentë kryesorë sipas aktiviteteve të ndara dhe të pavarura nga njera tjetra:

- Rrjeti i shpërndarjes
- Furnizuesi

Në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, për sa përcaktohet në Ligj për konsumatorët e energjisë elektrike dhe liberalizimin e tregut, duhet të merret në konsideratë mundësia e “largimit” të konsumatorëve privatë nga detyrimi i furnizimit me energji elektrike nga ana e OSHEE. Një “largim” i tillë pritet të ketë një efekt i cili sjell një mungesë në të ardhurat e kompanisë në nivelin rreth ALL 3.5 miliard ose rreth EUR 25 milion.

**2. Transferimi i të drejta/detyrime.** Në Ligjin e ri për Sektorin e Energjisë Elektrike, nuk ekziston Furnizuesi Publik me Shumicë. Transferimi i aktivitetit dhe të drejta/detyrime të ketij operatori tek OSHEE paraqet një efekt të konsiderueshëm financiar. Kështu:

- Transferimi i borxhit që KESH ka ndaj bankave tregtare. Në fund të vitit 2014 rezulton se detyrimi që KESH ka ndaj bankave tregtare për huatë e marra në formën e overdraft, është rreth EUR 253 milion. Një transferim i tillë, krahas procesit të ndërlikuar të transferimit, rinegociimit dhe mundësisë së ristrukturimit, mbart me vete një efekt të jashtëzakonshëm financiar. Duke vlerësuar një normë interesi të nivelit 6% në vit, një kosto rreth EUR 15 milion në vit do të rëndojë dhe duhet konsideruar në pasqyrat financiare të OSHEE. Mbajtja e këtij detyrimi në formën aktuale (overdraft një-vjeçar me të drejtë rinovimi) do të përbënte një risk të lartë për aktivitetin e OSHEE. Gjithashtu, edhe ristrukturimi i këtij detyrimi në formën e një huaje afatgjatë do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të OSHEE. Duke konsideruar ristrukturimin në një hua me afat shlyerje 10-vjeçar, një vlerë rreth EUR 34.4 milion në vit principal dhe interesa, do të rëndonte në pasqyrat financiare të OSHEE.
- Transferimi i detyrimeve ndaj PPE. Detyrimi aktual që KESH ka ndaj PPE është rreth EUR 38.7 milion. Një vlerë e transferuar si detyrim tek OSHEE do të kishte një ndikim në pasqyrat financiare.

Çdo njësi do të kenë një Zotërues të Riskut të identifikuar, i cili është përgjegjës për të siguruar administrimin e riskut, ndërmarrjen e kontrolleve dhe veprimeve të vazhdueshme për të zbutur riskun, monitorimin e vazhdueshëm të riskut, si dhe raportimin në lidhje me statusin e përgjithshëm të riskut brenda njësisë së tij. Është përgjegjësi e Zotëruesit të Riskut që të përcjellë më lart në hierarki risqet atëherë kur duhet, në përputhje me procedurat e riskut. Për risqet e identifikuar nga një Njësi, që kanë ndikim në fusha apo Njësi të tjera të OSHEE SH.A., Zotëruesi i Riskut raporton menjëherë tek SAR.


### 5.1.3 Zotëruesi i Proçesit

Çdo njësi ka një ose më shumë Zotërues të Proçesit, tek i cili Zotëruesi i riskut ka deleguar përgjegjësinë, për të siguruar përmbushjen e një detyre apo aktiviteti që do të ndihmojë për të zbutur riskun, si dhe ofruar raportim të rregullt në lidhje me progresin e bërë.



## 6. PROCEDURA

### 6.1 Kategorizimi i riskut në OSHEE SH.A..



#### 6.1.1 Risku Financiar

Risku financiar lidhet me humbjet që mund të vijnë nga aktivitetet financiare. Llojet e riskut financiar janë:

##### a. Risku i Tregut

Risku i tregut është rreziku i humbjes së vlerës së aksionerëve, që buron nga ndryshimet e kushteve të tregut, veçanërisht nga ndryshimet e çmimeve të tregut dhe volumit të kërkesës së mallrave, produkteve ose shërbimeve. Risqet e tregut janë:

Risku i Monedhës (monetar)/Valutës

Risku i monedhës specifikon riskun që mund t'i kanoset shoqërisë nga pikëpamja financiare, si edhe kapitalit të saj, të shkaktuara këto nga ndryshimet e kursit të këmbimit, (ndryshimet në asetet ose detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj). Ekzistojnë dy lloje të Riskut të Monedhës: Risku nga transaksionet (i transaksionit) dhe risku nga kursi i këmbimit:

- 1) Risku i transaksionit ka të bëjë me riskun e kalimit të cash - floë-t aktual nga valuta të ndryshme, dhe se sa këto ndryshime nga kursi i këmbimit, do të ndikojnë në cash floë-n e shoqërisë. Risku i kursit të këmbimit buron nga fakti që të ardhurat e shoqërisë, shumica e kredive të saj dhe llogarive të arkëtueshme janë në monedhën Lekë/ALL, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të saj, janë në monedhë të huaj. Risku kryesor është se vlera e monedhës të fluksit të parasë që vjen nga shlyerjet e detyrimeve dhe interesat përkatëse varion, si rezultat i luhatjeve në kursin e këmbimit, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm në fitimet e shoqërisë.
- 2) Risku nga kursi i këmbimit lidhet më së shumti me kontabilitetin. Ai përfshin ndikimin e kursit të këmbimit mbi fitimet dhe zërat e bilancit, gjatë prezantimit të pasqyrave financiare.

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit çon drejt ndryshimit të vlerës reale të aseteve ose detyrimeve monetare të rëndësisë të veçantë, ose drejt ndryshimeve të interesit

lidhur me kostot dhe të ardhurat, ose në kostot dhe të ardhurat që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit të tregut.

Gjatë aktivitetit të përditshëm të biznesit, shoqëria merr hua që të financojë aktivitetin e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit, sepse vlera fikse e kursit të huamarrjes dhe fluksi i mjeteve monetare lidhur me luhatjet e kursit të huasë, do të reflektojë diferencat në normën e interesit.

#### Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë

Çmimi i energjisë elektrike është shumë më i paqëndrueshëm, se çmimi i mallrave të tjerë. Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike është rreziku që i kanoset shoqërisë nga pikëpamja financiare, si dhe kapitalit të saj, të shkaktuara këto nga ndryshimet e çmimit të energjisë. Ndryshimet afatshkrutër apo afatgjatë të çmimit të energjisë ndikojnë drejtpërdrejtë tek të ardhurat e kompanisë. Jo vetëm kompania preket negativisht nga luhatjet e ndryshimit të çmimit të energjisë, por gjithashtu dhe ekonomia, duke patur luhatje të GDP-së. Mundësia e lëvizjeve ekstreme të çmimeve të energjisë rrit Riskun Tregtar në tregjet e energjisë elektrike. Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë sjell pasiguri në menaxhimin e kostove të shoqërisë, pamundësinë për të përmbushur detyrimet, ndikime negative në stabilitetin e shoqërisë, dhe ndikime negative në reputacionin e shoqërisë.

#### **b. Risku i Kreditimit**

Risku i kreditimit është risku nga efektet negative financiare që mund të vijnë si rezultat i mospagesave nga një biznes, partner kontraktual apo financiar; kjo nga mungesa e dëshirës, ose pamundësia që të përmbushë detyrimet.

Llojet e riskut të kreditimit janë:

#### Risku i palës tjetër (kundërpatisë)

Risku i palës tjetër është çdo institucion financiar ose publik, që konsiderohet si partner kontraktual i shoqërisë.

**Risku nga mospagimi i debitorit**

Ky risk është risku i një humbjeje, që rezulton nga dështimi për të shlyer një detyrim financiar kundrejt shoqërisë, të gjithin dhe në kohë, kjo si prej mungesës së dëshirës, ashtu edhe prej paaftësisë paguese të debitorit.

**Risku nga mospagimi i furnitorit**

Risku nga mospagimi i furnitorit është risku nga një humbje që rezulton nga dështimi për të shlyer një detyrim, nga ana e furnitorit, kundrejt shoqërisë. Detyrimi i furnitorit zakonisht nuk është i natyrës financiare (psh përfundimi i një investimi), ku kompania ndodhet në pozitën e debitorit (që ka urdhëruar kryerjen e investimit).

**Risku i marrëveshjes**

Risku i një humbje që rezulton nga mospërbushja e një transaksioni nga një palë tjetër, bazuar në një marrëveshje, në momentin kur vlera për t'u paguar nga shoqëria është kredituar në llogarinë e palës kontraktuese, ndërkohë që detyrimi nga pala tjetër nuk është përmbushur ende. Lloji i marrëveshjes dhe kredibiliteti i palës tjetër janë faktorët kyç përcaktues të riskut në këtë rast.

**c. Risku i Likuiditeteve**

Risku i likuiditeteve mund të përcaktohet si risku me të cilin mund të përballet shoqëria për të përmbushur detyrimet e saj financiare. Ekzistojnë dy lloje të riskut të likuiditeteve:

- Mungesa e menjëhershme e likuiditeteve, që shkakton një rritje të kostos së financimit për volumnin, monedhën dhe kohën e kërkuar. Rreziku konsiston në faktin se shoqëria nuk do të mund të përmbushë plotësisht detyrimet e tashme dhe të ardhme të pagesave që ka për të kryer; dhe

- Rreziku i pamundësisë për të siguruar fonde shtesë, ose kur këto fonde mund të merren me norma të larta interesi në treg.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj një nevoje ditore për likuiditete të disponueshme, në mënyrë që të shlyejë detyrimet që rrjedhin nga shpenzimet operacionale të aktivitetit të saj të përditshëm. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në mbledhjen e detyrimeve ndaj abonentëve të saj. Kjo situatë shpesh çon në mospërputhje likuiditeteve në dalje me ato në hyrje, dhe për rrjedhojë, shfaqet risku i likuiditetit.

#### **d. Risku Operacional**

Risku operacional është risku i një humbjeje, si rezultat i proceseve të papërshtatshme ose të dështuara, të punonjësve apo sistemeve, ose nga ngjarje (faktorë) të jashtëm.

- Risku i procesit - është dështimi i proceseve ose sistemeve për shkak të konceptimit të gabuar të tyre, kompleksitetit ose mos-performimit, që çojnë në humbje operacionale.
- Risku i sjelljes - është impakti nga sjellja e punonjësve në kompani (efiçenca, shëndeti dhe siguria, ose besnikëria)
- Risku i jashtëm - janë ngjarje që ndodhin jashtë spektrit të aktiviteteve të shoqërisë, të cilat mund të kenë një ndikim në pasqyrat financiare, ose vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë, si psh fatkeqësitë natyrore, dëmtimet e qëllimshme, pirateria informatike, ose mashtrimi nga jashtë, si dhe nga vjedhjet.

### 6.1.2 Risku i biznesit

Risqet e biznesit janë ato risqe, të cilat shoqëria i merr përsipër me vullnet të plotë, në mënyrë që të krijojë një avantazh konkurrues dhe t'i shtojë vlerë aksionerëve. Risku i biznesit përfshin vendimet (e biznesit) që merr shoqëria, dhe ambientin e biznesit në të cilin operon. Llojet risqeve të biznesit janë:

#### a. Risku Strategjik

Risku strategjik është risku që shfaqet si rrjedhojë e vendimeve kyçe për zhvillimin e biznesit të shoqërisë, psh nga vendimet për format (strukturën) e financimit, investimet dhe blerjet, nga prioritizimi i investimeve, nga çmimi dhe struktura (natyra) e produktit të shoqërisë.

#### b. Risku politik

Ky risk vjen nga niveli i zhvillimit të një rajoni, të sistemit ligjor, ekonomik dhe politik në të cilin shoqëria operon, duke përfshirë dhe nivelin e përgjithshëm të mjedisit të biznesit (tregut). Risku politik gjithashtu përfshin ndryshimet legislative (në të ardhmen), që mund të kenë ndikim në fitimet e shoqërisë.

#### c. Risku rregullator

Është risku i një humbje si rezultat i mospërputhshmërisë me një politikë të përcaktuar nga një autoritet rregullator, që rregullon tregun në një fushë të caktuar, bazuar në ligjet aktuale ose marrëveshjet ndërkombëtare. Ky risk buron nga pamundësia për t'u përshtatur me detyrat për dhënien e informacionit, raportimin dhe shkeljen e rregullores së detyrueshme, ose ligjeve.

**d. Risku i reputacionit**


Ky risk del si rezultat i një ngjarjeje ose serie ngjarjesh, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e shoqërisë, duke reduktuar aftësinë për drejtimin (vazhdimin) e biznesit (aktivitetit) dhe që çon në:

- Dobësimin e fuqisë negociuese të shoqërisë për lidhjen e kontratave;
- Uljen e imazhit të shoqërisë;
- Rënie të interesit të investitorëve.

**e. Risku ligjor**

Risku ligjor për biznesin mund të përkufizohet si dështimi që të: operojë brenda kufijve ligjorë, të jetë i ndërgjegjshëm për detyrimet ligjore, të respektojë angazhimet kontraktuale, të kompensojë furnitorët në rastet e mospagimit të detyrimeve në kohë, të dëshmojë që ka operuar brenda kufirit ligjor, ose të njohë dhe të menaxhojë në mënyrë efektive rreziqet ligjore.

## 6.2 Administrimi i Riskut



### 6.2.1 Objektivat e Manaxhimit të Riskut

- ❖ Të kuptojë udhëzimet e riskut financiar dhe të biznesit të shoqërisë OSHE SH.A..
- ❖ Të zhvillojë aftësinë për të identifikuar në kohë çështjet kritike.
- ❖ Të orientojë drejtuesit e lartë, që të fokusohen tek aktivitetet që gjenerojnë të ardhura.
- ❖ Të minimizojë në bazë ditore, humbjet që shkaktohen nga risku operacional.
- ❖ Të kontrollojë dhe menaxhojë rritjen e shoqërisë.



- ❖ Të përmirësojë aftësitë për arritjen e objektivave të biznesit.
- ❖ Të hartojë metodologjitë dhe të ndihmojë strukturat e shoqërisë, në mënyrë që administrimin e riskut ta shikojnë si pjesë integrale të të gjitha proceseve të tjera.
- ❖ Vetëm pasi risqet janë analizuar, ato mund të trajtohen, kontrollohen dhe menaxhohen më mirë.

### 6.2.2 Përcaktimi i kontekstit

Përcaktimi i kontekstit ka të bëjë me përcaktimin e parametrave të jashtëm dhe të brendshëm, që shoqëria duhet të marrë në konsideratë kur administron Riskun. Konteksti i jashtëm i shoqërisë përfshin palët e jashtme të interesuara, mjedisin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe çdo faktor të jashtëm që ndikon në objektivat e saj. Konteksti i brendshëm i shoqërisë përfshin palët e brendshme të interesuara, qasjen e saj ndaj qeverisjes, marrëdhëniet kontraktuale, si dhe kapacitetet e saj, kulturën dhe standartet. Duhet të merret në konsideratë konteksti i shoqërisë, kur përcaktohet shtrirja e programit të menaxhimit të riskut, kur formulohet politika e administrimit të riskut, dhe kur përcaktohen kriteret e riskut.

### 6.2.3 Procesi i vlerësimit të Riskut

Vlerësimi i Riskut është një proces, i cili nga ana e tij përbëhet nga tre nën-procese: Identifikimi i Riskut, Analiza e Riskut, dhe Vlerësimi i Riskut.

Identifikimi i Riskut është procesi që përdoret për të gjetur, njohur, dhe përshkruar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të një njësie organizative, apo të gjithë shoqërisë në tërësi.

Analiza e Riskut është një proces që përdoret për të kuptuar natyrën, burimet dhe shkaqet e risqeve që janë identifikuar, si dhe përcaktuar nivelin e riskut. Përdoret gjithashtu për të studiuar impaktet dhe pasojat, si dhe për të ekzaminuar kontrollet që ekzistojnë aktualisht. Vlerësimi i Riskut është një proces që përdoret për të krahasuar rezultatet e Analizës së Riskut me Kriteret e Riskut, me qëllim që të vendoset nëse një nivel i caktuar risku, është i pranueshëm, apo i tolerueshëm.

#### 6.2.4 Trajtimi i Riskut

Trajtimi i Riskut është Proçesi i Modifikimit të Riskut. Ai përfshin përzgjedhjen dhe implementimin e një apo më shumë mënyrave të trajtimit të Riskut. Pasi një trajtim është implementuar, ai shndërrohet në kontroll, ose modifikon kontrollet ekzistues. Mund të ketë shumë mënyra trajtimi të riskut. Risku mund shmanget, mund të reduktohet, mund të eliminohet burimin i tij, mund të modifikohen pasojat që e krijuan, mund të ndryshohet probabiliteti si dhe mund të ndahet me të tjerët.

#### 6.2.5 Komunikimi dhe konsultimi

Komunikimi dhe Konsultimi është dialogu mes shoqërisë dhe palëve të interesuara. Ky dialog është i vazhdueshëm dhe i përsëritshëm. Është një proces dydrejtimësh, që përfshin edhe ndarjen, edhe marrjen e informacionit në lidhje me menaxhimin e riskut. Megjithatë, kjo nuk është vendim-marrje e përbashkët. Pasi konsultimi dhe komunikimi përfundon, vendimet merren dhe drejtimet përcaktohen nga shoqëria, dhe jo nga palët. Diskutimet mund të jenë për ekzistencën e risqeve, natyrën e tyre, formën, probabilitetin, dhe rëndësinë, si edhe nëse risqet janë apo jo të pranueshëm, ose duhet të trajtohen, dhe çfarë opsionesh trajtimi duhet të merren në konsideratë.

#### 6.2.6 Monitorimi dhe rishikimi

Monitorimi ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe vazhdimisht kontrollin dhe vëzhgimin. Kjo do të thotë të përcaktohet statusi aktual dhe të vlerësohet nëse nivelet e kërkuar apo të pritshëm të performancës, janë duke u arritur.

Rishikimi kryhet me qëllim që të vendoset nëse veprimi i ndërmarrë është i përshtatshëm, i duhuri dhe i efektshëm për të arritur objektivat e vendosur të njësisë organizative apo shoqërisë.

Në përgjithësi, duhet rishikuar më specifikisht dhe në vazhdueshmëri planet e Menaxhimit të Riskut si dhe Risqet, Kriteret e Riskut, Trajtimet e Riskut, Kontrollet, Risqet e Mbetur, dhe Proçesin e Vlerësimit të Riskut.

## 7. ANEKSET

### ANEKS 1

#### Rregjistri i Riskut

Identifikim unik (Nr.)	Ky mund të jetë thjeshtë një titull, por edhe një emërtim përmes numrave mund të jetë i nevojshëm kur ke të bësh me një listë të gjatë risqesh
Risku (përshkrimi)	Paraqitur në format të strukturuar: <b>Situata</b> (Ekziston një risk që...) – <b>Shkaku</b> (I shkaktuar nga...) – <b>Pasoja</b> (Që rezulton në...)
Probabiliteti	Cilat janë gjasat që Risku të ndodhë? Do të ishte e dobishme të regjistrohej edhe justifikimi që qëndron prapa analizës
Impakti	Cili do të jetë impakti, nëse Risku ndodh? Do të ishte e dobishme të regjistrohej edhe justifikimi që qëndron prapa analizës
Statusi <b>KVGJ</b> (I Kuq, I Verdhë, I Gjelbër)	Bazuar në produktin e probabilitetit dhe impaktit, që nxirret sipas tabelës së miratuar të Analizës së Riskut
Shkalla kohore	Kur mund të ndodhë Risku? Cila është hapësira e manovrimit? Kur fillon të humbasësh opsione mbi mënyrën si do të reagosh?
Kostoja	Cila do të jetë kostoja që do të shkaktojë Risku, nëse ndodh? Këtë gjë nuk mund ta dish, nëse nuk di se cili do të jetë plani i veprimit për t’iu përgjigjur Riskut
Zotëruesi i Riskut	Drejtuesi i Njesisë, i cili ka për detyrë të “zotërojë” Riskun, domethënë që do të menaxhojë situatën, dhe do të garantojë kryerjen e veprimeve të nevojshëm nga ana e Zotëruesve të Proçeseve brenda njësisë së tij.
Qasja për menaxhimin e Riskut / Veprimet për zbutjen e Riskut	Cilët janë veprimet e miratuar për të vepruar ndaj Riskut? <ul style="list-style-type: none"> <li>• Veprime parandalues për të zbutur riskun</li> <li>• Veprime reagues, nëse Risku ndodh. Ky është “Plani i Impaktit”</li> </ul>
Risku i mbetur	Ky është niveli i pritshëm i Riskut, pasi janë vënë në veprim të gjithë veprimet zbutës.

Shenjat e hershme  
paralajmëruese

Cili është “alarmi” që do të paralajmërojë se Risku është duke ndodhur. Në disa raste, mund të vendoset që të ndërmerren veprime (psh shtohet financimi) vetëm pasi ka “rënë alarmi”

## SHEMBULL RREGJISTRI I RISKUT

Nr. Id	Kategorizim i i Riskut	Risku	Probabilitet i / Shkalla	Impakti	Statusi KVGJ	Shkalla kohore	Kostoja	Zotërues i i Riskut
Ky mund të jetë thjeshtë një titull, por edhe një emërtim përmes numrave mund të jetë i nevojshëm kur ke të bësh me një listë të gjatë risqesh	Përcaktimi i kategorisë në të cilën përfshihet risiku i evidentuar	<b>Paraqitur në format të strukturuar:</b> <b>Situata</b> (Ekziston një risk që...) – <b>Shkaku (I shkaktuar nga...) –</b> <b>Pasoja (Që rezulton në...)</b>	Cilat janë gjasat / probabiliteti që Riskut të ndodhë?	Cili do të jetë impakti, nëse Risku ndodh?	Bazuar në produktin e probabiliteti t dhe impaktit, që del nga tabela e miratuar e Analizës së Riskut	Kur mund të ndodhë Risku? Cila është hapësira e manovrimit ? Kur fillon të humbasësh opsione mbi mënyrën si do të jetë reagosh?	Cila do të jetë kostoja që do të shkaktojë Risku, nëse ndodh? Këtë gjë nuk mund ta dish, nëse nuk di se cili do të jetë plani i veprimit për t'iu përgjigjur Riskut	Drejtuesi i Njësisë, i cili ka për detyrë të “zotërojë ” Riskun.
SHEMBUL L 1	Aftësitë	Aftësi të papërshtatsh e, shkaktuar nga paaftësia për të rekrutuar stafin e duhur	I ulët	I konsiderueshë m	Verdhë	Gjatë gjithë kohës	Vonesa në realizimin e punës (mund të kostohet duke	Personi përgjegjë s në Njësi

Shembull 2	Menaxhim	që rezulton në probleme në punë	I ulët	I konsiderueshëm	Verdhë	Gjatë gjithë kohës	marrë parasysh kontekstin e Njesisë) Voensa në projekt (mund të kostohet duke marrë parasysh kontekstin )	Personi përgjegjës në Njësi
Shembull 3	Menaxhim	Mjedis jo i mirë, i shkaktuar nga mungesa e pajisjeve të duhura, që rezulton në atmosferë jo të mirë pune	Mesatar	I konsiderueshëm			Voensa në projekt (mund të kostohet duke marrë parasysh kontekstin )	Personi përgjegjës në Njësi

**Aneksi 2 – Kategoritë dhe klasifikimet e riskut**

*Klasifikimi Sasior i Riskut*

IMPAKTI	SHKALLA/PROBABILITETI I RISKUT					
		Shumë i ulët	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
	I papranueshëm	V	K	K	K	K
	I konsiderueshëm		V	K	K	K
	I pranueshëm		V	V	K	K
	Minimal			V	V	K
	I papërfillshëm					V

K	<u>Nivel shumë i lartë i Riskut</u>	Shpjegimi
V	<b>Risk i Konsiderueshëm</b> Risque me mundësi të larta ndodhjeje	Ndikim në kosto, plan, dhe probleme teknike. Nevojë për një aksion real për të lehtësuar problemet. Kërkohet kujdes nga ana e drejtuesve
	<b>Risk i ulët</b> Risk minimal dhe i padëshirueshëm që të ndodhë	Ndikim minimal në kosto, plan, dhe probleme teknike. Një kujdes në nivel normal nga ana e drejtuesve është i mjaftueshëm

Impakti	Vlera
I papranueshëm	Mbi ____ Eur
I konsiderueshëm	Nga ____ në ____ Eur
I pranueshëm	Nga ____ në ____ Eur
Minimal	Nga ____ në ____ Eur
I papërfillshëm	Deri ____ Eur

Shkalla Probabiliteti	Frekuenca
Shumë i lartë	Më shpesh se një herë në muaj
I lartë	Një herë në dy muaj
Mesatar	Dy herë në vit
I ulët	Një herë në vit
Shumë i ulët	Më pak se një herë në vit

*Klasifikimi Cilësor i Riskut*

IMPAKTI	SHKALLA/PROBABILITETI I RISKUT				
	Shumë i ulët	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
	1	2	3	4	5
I papranueshëm (5)	5	10	15	20	25
I konsiderueshëm (4)		8	12	16	20
I pranueshëm (3)		6	9	12	15
Minimal (2)			6	8	10
I papërfillshëm (1)					5

K	Nivel shumë i lartë i Riskut	Shpjegimi
V	<b>Risk i Konsiderueshëm</b> Risque me mundësi të larta ndodhjeje	Ndikim në kosto, plan, dhe probleme teknike. Nevojë për një aksion real për të lehtësuar problemet. Kërkohet kujdes nga ana e drejtuesve
	<b>Risk i ulët</b> Risk minimal dhe i padëshirueshëm që të ndodhë	Ndikim minimal në kosto, plan, dhe probleme teknike. Një kujdes në nivel normal nga ana e drejtuesve është i mjaftueshëm

Impakti	Vlera
I papranueshëm	5
I konsiderueshëm	4
I pranueshëm	3
Minimal	2
I papërfillshëm	1

Shkalla Probabiliteti	Frekuenca
Shumë i lartë 5	Më shpesh se një herë në muaj
I lartë 4	Një herë në dy muaj
Mesatar 3	Dy herë në vit
I ulët 2	Një herë në vit
Shumë i ulët 1	Më pak se një herë në vit



**Aneksi 3 – Risku Operacional – Saktësime dhe shembuj konkret.**

<b>Mashtrim i Jashtëm</b>	<b>Mashtrim i Jashtëm dhe Vjedhje (për qëllime fitimi)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vjedhje / grabitje / zhvatje / përvetësim• Forgery</li> <li>• Shpërdorim asetesh</li> <li>• Shtirje</li> </ul>
	<b>Mashtrim me bazë IT, &amp; vjedhje, nga faktorë të jashtëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëm nga Hacker-imi</li> <li>• Vjedhje informacioni (me humbje monetare për njësinë)</li> <li>• Dëm I shkaktuar nga "Phishing" (përdorim emailsh të rremë)</li> </ul>
<b>Mashtrim i Brendshëm</b>	<b>Mashtrim i brendshëm dhe vjedhje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mashtrim / mashtrim krediti</li> <li>• Vjedhje / zhvatje / përvetësim / grabitje</li> <li>• Shpërdorim i asetëve</li> <li>• Falsifikim</li> <li>• Kontrabandë</li> <li>• Ndryshim identiteti</li> <li>• Mospagim taksash / evazion (i qëllimshëm)</li> <li>• Rryshfete / haraçe</li> <li>• Tregti të brendshme (jo për llogari të kompanisë)</li> </ul>
	<b>Aktivitetet i paautorizuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transaksione të paraportuara (qëllimisht)</li> <li>• Lloji i transaksionit i paautorizuar (me humbje monetare për njësinë), si transaksionet e pamiratuara</li> <li>• Autorizim i pavlefshëm i ekspozimit</li> </ul>
	<b>Mashtrim i brendshëm dhe vjedhje përmes IT</b>	Përfitimi monetar është parakusht
<b>Dëmtim i qëllimshëm dashakeq</b>	<b>Dëm i qëllimshëm</b>	Dëmtim I qëllimshëm kryer prej vandalizmit, duke përjashtuar ngjarje që lidhen me sistemin e sigurisë
	<b>Terrorizëm</b>	Akte spiunazhi industrial dhe terrorizmi
	<b>Dëmtim i jashtëm, i qëllimshëm i sistemeve të sigurisë</b>	Përfshin ngjarje të sigurisë të sistemeve të jashtëm të një natyre të qëllimshme, jo për fitim (psh përhapje virusesh, programesh kompjuterikë etj), që bëhen nga një palë e tretë, pa ndihmën e një palë të brendshme
	<b>Dëmtim i brendshëm, i qëllimshëm i sistemeve të sigurisë</b>	Përfshin ngjarje të sigurisë të sistemeve të jashtëm të një natyre të qëllimshme, jo për fitim (psh përhapje virusesh, programesh kompjuterikë etj), që përfshijnë të paktën një palë të brendshme

<b>Praktika punësimi dhe siguria në vendin e punës</b>	<b>Marrëdhëniet me punonjësit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompensime, përfitime, çështje përfundimi të punësimit</li> <li>• Aktivitete të organizuar (greva)</li> </ul>
	<b>Mjedis i sigurtë në vendin e punës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullat e shëndetit dhe sigurisë për punonjësit;</li> <li>• Kompensime për punonjësit</li> </ul>
	<b>Diversiteti dhe diskriminimi</b>	Ne dallojmë ngjarjet e diskriminimit në vendin e punës nga ngjarjet publike të diversitetit apo diskriminimit, që përfshijnë klientët apo qytetarët në përgjithësi;
<b>Klientë, produkte dhe praktika biznesi</b>	<b>Përshtatshmëria, Hapja dhe Mirëbesimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkelje të mirëbesimit</li> <li>• Çështje të përshtatshmëris/hapjes (mbledhje informacionesh papërshtatshmërie gjatë procesit, etj.)</li> <li>• shkelje të sekretit të info të klientit</li> <li>• Shkelje e privatësisë</li> <li>• Shitje agresive</li> <li>• Keqpërdorim i informacionit konfidencial</li> <li>• Detyrimet e huadhënësit</li> <li>• Mbifaturim i klientëve</li> </ul>
	<b>Praktika të gabuara biznesi, apo tregu</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Antitrust/kartel</li> <li>• Tregti e gabuar / praktika tregu;</li> <li>• Manipulim tregu;</li> <li>• Tregti e brendshme (në llogarinë e kompanisë);</li> <li>• Vepripmtari e palicencuar;</li> <li>• Pastrim parash;</li> <li>• Ngjarje diskriminimi / diversiteti në treg apo publik;</li> <li>• Shkelje e kushteve themelore të biznesit</li> </ul>
<b>Fatkeqësitë dhe Siguria Publike</b>	<b>Fatkeqësi dhe ngjarje të tjera</b>	Humbje nga fatkeqësi natyrore
	<b>Aksidente dhe siguria publike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aksidente (si me makinat e kompanisë), që mund të përfshijnë lëndime të jo-punonjësve</li> <li>• Rrëshkitje apo rrëzime të jo-punonjësve</li> <li>• Humbje për shkak të shkeljeve të sigurisë publike (asbest në mure, moskontrollim i ndotjes etj.).</li> </ul>
<b>Teknologjia dhe dështimet e infrastrukturës</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komputera;</li> <li>• Programe kompjuterike;</li> <li>• Telekomunikacion;</li> <li>• Ndërperje të energjisë</li> </ul>
<b>Ekzekutim, Shpërndarje dhe Menaxhim Procesesh</b>	<b>Gabime njerëzore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë komunikimi</li> <li>• Gabim në futje të dhënash, mirëmbajtje</li> <li>• Gabim në llogari</li> <li>• Gabime të tjera në kryerje detyrash</li> <li>• Mospërbushje e detyrave</li> </ul>
	<b>Menaxhim të dhënash</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Migrim i pasaktë i të dhënave të mëparshme</li> <li>• Ndarje e papërshtatshme e sistemeve të testimit dhe sistemeve "live"</li> <li>• Zëvendësim i pasaktë i dokumentave</li> </ul>
	<b>Monitorim dhe raportim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mospërbushje e detyrimit të raportimit</li> <li>• Raporte të jashtëm të pasaktë (me shkaktim humbjesh)</li> </ul>

<p><b>I. Risku i procesit</b></p> <p><b>Menaxhim Operacionesh</b> Ky përfshin gabimet në transaksione, gabime dhe eliminime (fshirje) që ndodhin kudo në ciklin e jetës së transaksionit. Krijimi i proceseve, të gjithë procedurat e nevojshme, Workflow-t, ndërveprimi me departamentet e tjerë. Ai përjashton të dhënat e gabuara theme-lore (gabime njerëzore). Këto humbje mund të ndodhin vetëm gjatë një transaksioni.</p> <p><b>Menaxhim të dhënash</b> Merret specifikisht me krijimin dhe ruajtjen e të dhënave, si dhe sigurimin në kohën e duhur të të dhënave cilësore, në mjedisin e procesit. Ky ka një impakt specifik në përdorimin e të dhënave të pasakta apo të papërshtatshme, brenda ciklit të procesit</p> <p><b>Zbulimi i Raportimit</b> Ky përmban ndodhinë e raportimeve falsë, të papërshtatshëm ose të parakohshëm, të një natyre rregulatore, ose që ka të bëjë me përputhshmërinë, tek një autoritet i jashtëm apo supervizor. Kjo kategori rrishte përjashton të dhënat theme-lore të pasakta.</p> <p><b>Infrastruktura dhe sistemet</b> Ky përshkruan dëshim në kryerjen, ose mohimin e shërbimit në sistemet e brendshëm dhe infrastrukturë (nga/brenda), duke përfshirë ndërveprimet dhe hyrjet brenda dhe jashtë një institucioni. Impakti matet në lidhje me natyrën e procesit, sa i përket varësisë së tij ndaj kohës, duke përfshirë një mekanizëm rikthimi në normalitet në rast fatkeqësish/katastrofash.</p>	<p><b>II Risku i Sjellies</b></p> <p><b>I mirëbesimit</b> Mospërbushja nga një punonjës apo agent, i të gjithë përgjegjësitë të këna në mirëbesim dhe detyrat më të larta. Ky përfshin nxjerrjen e informacioneve të rëndësishëm jashtë kompanisë.</p> <p><b>Praktika të papërshtatshme</b> Kur punonjësi, agjent apo vetë kompania nuk arrijnë të kryejnë detyrimet, sipas kontratës apo statutit. Ky përfshin neglizhencën apo veprimtari të tjera, por që nuk janë mashtrime. Specifikisht, mosndjekja e procedurave, procedura me të meta, apo procedura që nuk përmbushin standartet e industrisë, apo gabime të pastër njerëzore.</p> <p><b>Veprimtari Tregu e Paautorizuar</b> Përmes llojeve të paautorizuar të transaksioneve ose produkteve, dhe fshirjeje e qëllimshme e transaksioneve të përmblytura. Specifikisht bën fjalë për "regullat mashtruese" dhe fshirjen e qëllimshme, por përjashtonë hiletë.</p> <p><b>Mashtrim dhe Vjedhje e Brendshme</b> Të gjithë format e vjedhjeve të kryera së brendshmi, ose shpërdorim përmes mashtrimit të aseteve. Përfshin ngjarje ku ka marrëveshje të fshihja me palë të jashtme. Këto ngjarje duhet të përfundojnë me përfitime monetare për palën e brendshme që kryen mashtrimin ose vjedhjen.</p> <p><b>Diversiteti dhe Diskriminimi</b> Mos përputhje me rregullat dhe udhëzimet që ikthen me diversitetin dhe/ose indiskriminimin e punonjësve ose agjentëve.</p> <p><b>Marrëdhëniet e punonjësve</b> Grevat dhe të gjithë format e aksionit industrial nga punonjësit ose agjentët, apo çdo lloj veprimi nga punonjësit ose agjentët që çon në ndërprerje të punës, apo irrije të pakënaqësisë së konsumatorit (sabotazh i brendshëm). Përfshin mungesën e stafit për periudha të caktuara kohe, që çon në ndërprerje të punës, për shkak se nuk ka staf të mjaftueshëm për t'i zëvendësuar.</p> <p><b>Mjedisi i sigurtë</b> Mospërputhje me rregulloret dhe udhëzimet që ikthen me shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, agjentëve dhe palëve të treta brenda vendit të punës. Përfshin rreziqe dhe lëndime nga palë të jashtme.</p>	<p><b>III. Risku i Jashtëm</b></p> <p><b>Fatkeqësi Natyrore dhe Aksident</b> Dëmtim ndaj ose humbje e aseteve, shaktuar nga një ngjarje natyrore ose aksident.</p> <p><b>Dëmtim me qëllim</b> Dëmtim ndaj, ose humbje e aseteve, shaktuar nga një akt i qëllimshëm nga një palë e jashtme. Kjo kategori rrishte përjashton akte të spuanazhit industrial dhe terrorizmit. Përfshin gjithashtu staf të larguar nga puna, që mund të përdorë informacione kundër kompanisë.</p> <p><b>Hacker-im dhe ndërprerje</b> Akses i jashtëm i paautorizuar ose manipulim, apo ndërprerje e sistemeve, infrastrukturës ose të dhënave, duke përfshirë mohim të sulmeve ndaj shërbimit. Merr në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës thelbësore të IT në organizatë.</p> <p><b>Mashtrim dhe vjedhje e jashtme</b> Të gjithë format e shpërdorimit nga jashtë të aseteve, përmes vjedhjes apo mashtrimit.</p>
--	---	--

## **8. BAZA LIGJORE**

- Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji Nr 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- Statuti i shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a.
- Ligji Nr.10 296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”.
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Standartet ISO 31000 per administrimin e riskut.

## 9. HISTORIKU I RISHIKIMEVE TË DOKUMENTIT

<b>Data efektive</b>	<b>Nr. Rishikimeve</b>	<b>Autori</b>	<b>Pëshkrim i ndryshimeve të bëra në dokument</b>
__/__/201_*	0		Dokument i ri

\* Data efektive në rreshtin e parë të tabelës është data e aprovimit të parë të dokumentit. Datat në rreshtat në vijim do t'i referohen datës së aprovimit të rishikimeve të dokumentit për modifikime të ndryshme.

**RAPORT REZULTATI FINANCIAR JANAR-SHTATOR 2016**

**1 – PASQYRA E BILANCIT**

OSHEE BILANCI (000/Leke)	31 Dhjetor 2015	30 Shtator 2016
<b>AKTIVE</b>	<b>38,126,479</b>	<b>44,112,353</b>
<b>Aktive Afatgjata</b>	<b>21,456,385</b>	<b>26,037,083</b>
Aktive Afatgjata Materiale	21,081,221	25,552,899
Aktive Afatgjata Jo - Materiale	372,928	482,111
Aktive Financiare	2,236	2,073
<b>Aktive Afatshkurtra</b>	<b>16,670,094</b>	<b>18,075,270</b>
Inventaret	2,463,770	3,115,669
Llogari te Arketueshme neto	7,230,546	7,908,594
Llogari te Arketueshme te tjera neto	357,110	274,793
Parapagimet per tatim fitimin		
Mjete monetare dhe ekuivalente	6,618,667	6,776,214
Te ardhura te perlllogaritura	-	-
<b>KAPITALI</b>	<b>(55,755,156)</b>	<b>(48,455,419)</b>
Kapitali aksionar	30,099,102	30,099,102
Rezerva te tjera	2,916,011	2,916,011
Humbje te akumuluar	(104,263,468)	(88,770,269)
Te ardhura neto vjetore	15,493,200	7,299,737
<b>DETYRIMET</b>	<b>93,881,635</b>	<b>92,567,772</b>
<b>Detyrimet Afatgjata</b>	<b>13,297,514</b>	<b>14,231,967</b>
Huate afatgjata neto	13,297,514	14,231,967
Hua Te tjera	-	-
Provizione	-	-
<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>	<b>80,584,121</b>	<b>78,335,805</b>
Llogarite e Pagueshme Tregtare	42,586,976	44,782,808
Detyrimet per taksa dhe sigurime shoqerore	6,543,924	6,628,665
Tatimi mbi te ardhurat	4,110,983	4,469,172
Pjesa afatshkurter e huave afatgjata	6,204,528	3,512,621
Provizione	6,478,306	6,478,306
Huate afatshkurtra	-	-
Detyrime te tjera afatshkurtra	14,659,404	12,464,234
<b>Total Kapitali dhe Detyrimet</b>	<b>38,126,479</b>	<b>44,112,353</b>

**Departamenti Ekonomik**

**2-PASQYRA TE ARDHURA & SHPENZIME**

000/Leke	Pershkrimi	Realizimi	Realizimi	Diferenca	%
		Shtator 2015	Shtator 2016		
<b>Te ardhurat</b>	Nga aktiviteti kryesor (shitja e Energiise)	37,276,234	37,828,494	552,260	101%
	Te tjera	3,878,320	1,847,137	(2,031,184)	48%
	<b>Gjithsej</b>	<b>41,154,554</b>	<b>39,675,631</b>	<b>(1,478,924)</b>	<b>96%</b>
<b>Shpenzimet</b>	Shpenzime Energji dhe Transmetim	22,680,421	18,994,849	(3,685,572)	84%
	Shpenzime Operative	6,037,536	7,263,554	1,226,018	120%
	Provizione	394,999	2,152,096	1,757,098	545%
	<b>EBITDA</b>	<b>12,041,599</b>	<b>11,265,131</b>	<b>(776,468)</b>	
	Amortizimi	1,556,092	1,679,263	123,171	108%
	Shpenzime Financiare	1,210,939	997,942	(212,997)	82%
	Tatim Fitimi	-	1,288,189	1,288,189	0%
	<b>Gjithsej</b>	<b>31,879,987</b>	<b>32,375,894</b>	<b>495,907</b>	<b>102%</b>
<b>REZULTATI I AKTIVITETIT</b>		<b>9,274,567</b>	<b>7,299,737</b>	<b>(1,974,831)</b>	
	Te ardhura te Jashtezakoneshme	3,869,477			
<b>REZULTATI I PERIUDHES</b>		<b>13,144,044</b>	<b>7,299,737</b>	<b>(5,844,308)</b>	
<b>ENERGJI (MWH)</b>					
	Energji e Blere	4,390,577	4,239,544	(151,034)	
	Energji e Shitur	2,997,979	3,046,748	48,770	
<b>Humbje %</b>		<b>31.72%</b>	<b>28.13%</b>	<b>-3.58%</b>	

11397/2  
28.06.2016

**RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR**

**SHOQËRIA "OPERATORI SHPËRNDARJES ENERGJISË  
ELEKTRIKE" S.H.A.**

(Për vitin ushtrimor të mbyllur më datë 31 dhjetor 2015)  
NIPT: K72410014H

Tiranë më, 28 /06/2016



## RAPORTI AUDITUESVE TË PAVARUR

Drejtuar: Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë,

Administratorit të Shoqërisë, Zotit Adrian ÇELA.

Të nderuar zotërinj,

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të Shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes Energjisë Elektrike" sh.a., të cilat përmbajnë; Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datë 31 Dhjetor 2015, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (gjithëpërfshirëse), Pasqyrën e Fluksit të Parasë dhe të Ndryshimeve në Kapital për këtë vit ushtrimor, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese (bashkëlidhur).

**Përgjegjësitë e Drejtimit të Shoqërisë "OSHEE" sh.a.**

Drejtimi i shoqërisë "OSHEE" sh.a është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë dhe të sinqertë të këtyre Pasqyrave Financiare, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjit për Kontabilitetin. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim të standardeve që duhen sipas ligjit dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare, drejtimi është i detyruar që t'i përgatisë ato dhe të jenë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit.

Drejtimi është përgjegjës për të zgjedhur dhe zbatuar metodat e përshtatshme kontabël si dhe për të bërë vlerësimet kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat e dhëna.

**Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Nëpërmjet testeve përkatëse ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet e Auditimit. Këto standarde kërkojnë që në të zbatojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë për auditimin rreth vlerave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjyqimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe llogjikën e emuarjeve kontabël të bërë nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Megjithatë, për arsye të çështjeve që përshkruhen tek paragrafi për "Bazat e Refuzimit të Dhënies së Opinionit", ne

nuk ishim në gjëndje të siguronim të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të krijuar një bazë për dhënien e opinionit.

#### **Bazat për Refuzimin e Dhënies së Opinionit**

1. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke supozuar se shoqëria do të vazhdojë në vijimësi. Siç është përshkruar në shënimin 4.2 të pasqyrave financiare, humbjet e mëdha që ka pësuar shoqëria në vite dhe defiqiti i ndjeshëm në kapitalin neto konfirmojnë situatën e vështirë financiare të saj, akoma të brishtë, megjithëse shoqëria është vendosur nën administrim 100% nga Qeveria. Pasqyrat Financiare të shoqërisë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015 raportojnë një fitim neto prej 15,493,200 mijë Lekë dhe një kapital negativ prej 55,755,156 mijë Lekë. Viti 2015 paraqet një përmirësim të rezultatit pozitiv prej 15,493,200 mijë Lekë [2014: *humbje prej 4,510,485 Lekë*]. Referuar shënimin të pikës 4.2 për përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë për vitin 2015 dhe në vazhdimësi, shoqëria duhet të sigurojë një qendrueshmeri të këtij rezultati për të paktën 2 deri në 3 vjet radhazi që ajo të mund të dalë nga kjo gjëndje financiare dhe të sigurojë vijimësi normale dhe bindëse për palët e interesuara, dhe përfundimisht të bëhet materializimi i këtij plani rimëkëmbje energjitiqë për OSHEE sh.a.

Rrjedhimisht, ekzistenca e pasigurisë në lidhje me vijimësinë mund të çojë në ndryshime të vlerësimeve financiare që mund të impaktonin materialisht pasqyrat financiare.

2. Shoqëria "OSHEE" sh.a është në proces të inventarizimit fizik të aktiveve afatgjata materiale dhe të rivlerësimit tyre, si rrjedhim rezultatet inventarizimit fizik të aktiveve afatgjata materiale dhe të rivlerësimit nuk janë përcaktuar ende deri në datën e lëshimit të këtij opinionit auditimi. Gjithashtu megjithëse aktivet afatgjata materiale përbëjnë 55% të totalit të aktiveve dhe rezultatet e këtij procesi janë të paparashikueshme mund të kenë efekte materiale në Pasqyrat Financiare. Grupi i auditoreve të pavarur nuk ishte në gjëndje të bindej të siguronte evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të verifikuar plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015.

3. Në Pasqyrat Financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit (billing-ut) dhe të pozicionit financiar "Të arkëtueshme" (kontabiliteti) për gjëndjen e klientëve më 31 Dhjetor 2015. Referuar shënimin nr.10 manaxhimi është në dijeni të këtyre mospërputhjeve pasi diferencat kanë rezultuar në periudhat e mëparshme por edhe gjatë vitit 2015. Mospërputhje midis sistemit "billing-ut" (faturim& arketim) dhe kontabilitetit arrijnë në vlerën 1,641,669 mijë leke në dt.31.12.2015[2014:1,318,805 mijë lekë]. Në fund të vitit 2015, rezulton një diferencë, vlera 138,771 mijë lekë, ndërmjet llogarive të Arkëtueshme në Pasqyrat Financiare dhe gjëndjes së Klientëve. Kjo vlerë përfaqëson fondet e arkëtuara pa adresë të saktë të klientit, trashëguar ndër vite. Për më tepër, ne nuk mundëm të siguronim informacion për verifikimin e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit financiar 2015.

Grupi i auditoreve të pavarur nuk ishte në gjëndje të gjykojë sipas informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria edhe me metoda alternative për të verifikuar plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin për këtë pozicion financiar në Pasqyrave Financiar të vitit 2015.

4. Shoqëria ka zbatuar një metodologji për përlllogaritjen e provizioneve bazuar në riskun e mos –pagesës, kjo metodologji është që nga koha e operimit të kompanisë CEZ Shpërndarje. Duke qenë se kushtet e veprimtarisë kanë ndryshuar dhe kompania OSHEE ka ndryshuar politikat dhe procedurat e saj në lidhje me arketimin, kjo ka sjelle një reagim të menjëhershëm pozitiv në lidhje me arketimet dhe mbylljen e debive të vjetra, në një masë të konsiderueshme. Nën këto kushte të reja, kriteret dhe aplikimi i përqindjeve të larta të provizionimit në fashat e mesme të vonesave (duke filluar për vonesa nga 31-60 ditë provizion me norme 30%, 61-90 ditë me 70%, 91-180 ditë po me 70%, dhe duke lënë fashat e fundit të vonesave nga 180-365 ditë dhe deri në 2 vite, me 100% norme) mbi- ngarkon shpenzimet e provizionimit dhe fondin e provizionit duke mos reflektuar riskun real të mos-arketimit dhe duke nënvlerësuar zerin e llogarive të arketueshme në pasqyrat financiare. Gjithashtu kjo metode është mituar nga Keshilli Mbikqyres i OSHEE, por nuk është miratuar nga IRE. Mënyra e llogaritjes së provizioneve sipas kësaj metodologjie e ka ndikuar edhe në vendosjen eshoqërisë në pozicionin e kapitali Neto negative. Grupi i auditoreve të pavarur nuk ishte në gjendje të gjykojë sipas informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria për të verifikuar plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin për këtë pozicion financiar në Pasqyrave Financiare.
5. Referuar pozicionit "Të Ardhura nga shitja e energjisë elektrike " shoqëria regjistron të dhënat në sistemin "billing" (*faturimit & arketimit*) mbi bazë të dhënave analitike (në nivel kontrate) ndërsa në sistemin e kontabilitetit (SAP) të dhënat regjistrohen në mënyrë të përmbledhur manualisht nga sistemi i billing (Dep.Shitje&Arketim). Nga të dhënat e kontabilitetit u konstatua se ndërmjet sistemit "Billing" dhe sistemit të kontabilitetit "SAP" ka mosperputhje e cila hën të pasigurtë të ardhurat e vitit 2015. Në programuan që nëpërmjet metodave të tjera alternative të siguronim shkaqet e mosperputhjes së shifrave midis dy sistemeve duke kërkuar informacione më të detajuara të raporteve financiare të gjeneruara nga sistemi "Billing" si edhe llogaritë analitike të klientëve në bazë kontrate të regjistruara në këtë sistem, por me informacion e vënë në dispozicion nga shoqëria "OSHEE" sh.a ne nuk mundëm të arrijmë të konkludojmë për mosperputhjet. Të ardhura për shitje energjie elektrike sipas kontabilitetit për vitin 2015 janë në shumën prej 50,402,481 mijë Lek, kjo shumë është kontabilizuar vetëm me përmbledhse mujore të konfirmuara nga departamenti i shitjes në bazë të të cilës përpilohen faturat e shitjes mujore. Shoqëria nuk ka një set rregullash dhe procedurash të mirëfillta për funksionimin, manaxhimin dhe raportimin e agjensive, qendrave operative nën varësinë e këtyre agjensive si dhe për marrjen e masave për të operuar në mënyrë konsistente, sistematike për kundrejt objektivave të shoqërisë, sigurimit dhe kontrollit të të Ardhurave të saj. Grupi i auditoreve të pavarur nuk ishte në gjendje të gjykojë sipas informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria për të verifikuar plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin për këtë pozicion financiar në Pasqyrave Financiare.
6. Shoqëria "OSHEE" sh.a në periudhën kur është shkëputur nga KESH sh.a. ka marrë prej tij edhe detyrimet për shlyerjen e disa kredive të investuara në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Nga krahasimi i borxhit të pashlyer deri më 31 Dhjetor 2015 midis konfirmimeve të KESH sh.a dhe kontabilitetit të Shoqërisë ka një mosperputhje prej 118,690 mijë lek (*Pasqyrat Financiare të Shoqërisë tregojnë një borxh më të madh lidhur*

*me principalin*). Kjo diferencë është si rezultat i përdorimit nga ana e KESH sh.a të një kursi konvertimi ndryshe nga ato që ka përdorë OSHEE sh.a me pretendimin se ata (KESH-i) përdorin një kurs të pa-ndryshuar gjatë gjithë periudhës së kredisë. Po kështu nga krahasimi i borxhit për mospagim të interesave deri më 31 Dhjetor 2015 midis konfirmimeve të KESH sh.a dhe kontabilitetit të Shoqërisë ka mospërputhje prej 9,547 mijë Leke. KESH sh.a ka përdorur monedhën EURO dhe jomonedhën origjinale në të cilën është kredia në monedhën KRW. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të verifikuar vlerësimin dhe paraqitjen e këtyre kredive dhe shumës së interesave të lidhura me to.

7. Shoqëria ka paraqitur pozicionin financiar "Huatë" në Pasqyrat Financiare të saj më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 me norma interesi jo sipas normave të tregut. Shoqëria nuk i ka njohur huatë me vlerë të drejtë në momentin e njohjes fillestare kur është shkëputur nga KESH sh.a dhe me kosto të amortizuar në vijim, sipas SNK 39: "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja". Gjithashtu shoqëria nuk ka dhënë informacione shpjeguese për analizën e sensitivitetit dhe vlerës së drejtë (fair value), të cilat kërkohen nga IFRS 7 "Instrumentat Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese". Si pasojë e natyrës së regjistrimeve kontabël dhe mungesës së dokumentacionit mbështetës të përshtatshëm për gjykim, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme në Pasqyrat Financiare të shoqërisë.
8. Shoqëria nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e llogarive tregtare të pagueshme ndaj KESH sh.a. Nga krahasimi i të pagueshmeve tregtare të pashlyera deri më 31 Dhjetor 2015 midis konfirmimeve të KESH sh.a dhe kontabilitetit të Shoqërisë "OSHEE" sh.a ka një mospërputhje prej 20,555,922 mijë Lek (Prodhimi energjise+Mbulim Humbje). Shoqëria ka regjistruar në kontabilitet shumën prej 13,903,833 mijë leke dhe të parregjistruar 6,652,089 mijë leke. Këto mospërputhje lidhen me mospranimin e faturave tatimore për vitin 2012 dhe llogaritjen e penaliteteve (interesa për pagesa të vonuara, parregullsitë në fatura për periudhën e detyrimeve që i përkasin para vitit 2013). Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tregtare ndaj KESH sh.a më 31 Dhjetor 2015 janë raportuar saktë.
9. Shoqëria nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e llogarive tregtare të pagueshme ndaj OST sh.a. Nga krahasimi i të pagueshmeve tregtare të pashlyera deri më 31 Dhjetor 2015 midis konfirmimeve të OST sh.a dhe kontabilitetit të Shoqërisë ka një mospërputhje prej 2,835,963 mijë lekësh. Këto mospërputhje lidhen me mospranimin e faturave tatimore për vitin 2012 prej 482,187 mijë lekësh dhe llogaritjen e penaliteteve prej 2,353,776 mijë leke (interesa për pagesa të vonuara, parregullsitë në fatura për periudhën e detyrimeve që i përkasin para vitit 2013) dhe tvsh-n e këtyre faturave në vlerën 100,449 mijë leke. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tregtare ndaj OST sh.a më 31 Dhjetor 2015 janë raportuar saktë.

10. Shoqëria nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e llogarive tregtare të pagueshme ndaj shoqërisë GEN-1 (*furniture për blerje energji elektrike*). Nga krahasimi i të pagueshmeve tregtare me 31 Dhjetor 2015, konfirmimit të GEN-1 dhe kontabilitetit të Shoqërisë ka mospërputhje prej 29,825 mijë Lek. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tregtare ndaj GEN-1 sh.a më 31 Dhjetor 2015 janë raportuar saktë.
11. Shoqëria nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e llogarive tregtare të pagueshme ndaj shoqërisë ndaj shoqërisë "EFT Energy Financing Team" Sëitserland (*furniture për blerje energji elektrike*)(*furniture për blerje energji elektrike*). Nga krahasimi i të pagueshmeve tregtare më 31 Dhjetor 2015, konfirmimit të "EFT Energy Financing Team" Switzerland dhe kontabilitetit të Shoqërisë ka mospërputhje prej 815,028 mijë Lek për fatura penaliteti për vitet e kaluar (prej € 5,936,978). Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tregtare ndaj "EFT Energy Financing Team" Switzerland më 31 Dhjetor 2015 janë raportuar saktë.
12. Gjatë procedurave të auditimit grupi i audituesëve të pavarur ka konstatuar se Shoqëria OSHEE sh.a dhe Posta Shqiptare sh.a nuk kanë arritur të finalizojnë rakordimin e llogarive tregtare të pagueshme, për periudhen 01.01.2010-31.12.2014. Ne konstatojmë se referuar kontabilitetit të shoqërisë detyrimi për Posta Shqiptare është prej 723,069 mijë leke në llogarinë furnitore dhe prej 319,992 mijë leke në llogarinë shpezime të përlllogaritur. Shoqëritë janë duke saktësuar llogaritë e tyre (në proces zgjedhje). Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tregtare ndaj Postës Shqiptare sh.a më 31 dhjetor 2015 janë raportuar saktë.
13. Shoqëria edhe për vitin 2015 nuk ka mundur të bëjë një rakordim të situatës tatimore lidhur me detyrimet që ka ndaj degës së tatim taksave. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjëndje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të arritur në konkluzionin nëse detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2015 janë raportuar saktë.

#### **Refuzim i Dhënies së Opinioneve**

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin për "Bazat e refuzimit të dhënies së opinionit", ne nuk kemi qënë në gjëndje të sigurojmë evidencë të nevojshme auditimi për të bazuar opinionin tonë. Rrjedhimisht, ne nuk shprehim një opinion mbi Pasqyra Financiare të vitit 2015.

#### **Theksim i çështjeve**

Pa dashur të shtonin problemet në opinion, tërheqim vëmendjen:

- a. Në Shënimin 5 i cili përcakton se çertifikatat e pronësisë së tokave dhe ndërtesave të Shoqërisë, të cilat duhet të transferoheshin nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., gjatë momentit të shpërndarjes së Shoqërisë ende nuk janë finalizuar. Rrjedhimisht,

këto toka dhe ndërtesa nuk janë regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin e Hipotekës.

- b. Ref.shënimit Nr.7 "Të tjera të arkëtueshme (Neto)" për shumën prej 216.857 mijë lek dhe Ref.shënimit Nr.21 "Të tjera pagueshme" për shumën prej 559,787 mije lek rezultojnë të pa-analizuara, këto rrjedhin nga sistemimet e llogarive prej vitesh.
- c. Shoqëria nuk ka kritere për të përcaktuar qartë në se shpenzimet janë për riparime apo për t'u kapitalizuar në asete, për pasojë është e vështirë të evidentohet qartë destinacioni si riparim i madh apo si kosto operative, si rrjedhim kostoja operative nënvlerësohet për efekt të mirëmbajtje si dhe kontrolli mbi eficienten e shpenzimeve respektive.
- d. Shoqëria nuk ka llogaritur tatim të shtyrë më 31.12.2015.
- e. Referuar SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" shoqëria duhet të paraqesë sakte paraqitjen e pozicioneve financiare të zerave të ndryshem dhe analizat e tyre, duke netuar vetem ato zera që lejohen nga Standartet e tjera të raportimit financiar.
- f. Paravërsisht se shoqëria ka llogaritur një zhvlerësim në Pasqyrat Financiare në lidhje me Inventarët (107,670 mije Lek), magazinat e shoqërisë depozitojnë inventar (material dhe aktive) të cilat nuk kanë asnjë vlerë përdorimi në vetvete (tërësisht jashtë funksioni) duke mbingarkuar/ shpërdoruar kapacitetet depozituese dhe duke humbur mundësinë e realizimit të ndonje të ardhure në rast shitje si skrap.
- g. Në lidhje me çështjet TIK, shoqëria ka dobësi në manaxhimin e proceseve të sistemeve të informacionit nga pikëpamja e sistemit të ruajtjes së të dhënave, organizimi dhe alokimi përgjegjësive, politika e sigurisë së Informacionit, kontrolli i qasjes në sisteme dhe manaxhimin e incidenteve. Gjithashtu theksohet mungesa e një Business Continuity Plan që parashikon se çfarë do bëhet në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme (fatkeqesi natyrore, zjarr, lufta etj.), dhe mungesa e një plani rikuperimi për dislokimin e të dhënave të biznesit dhe burimeve njerëzore, vë në veshitësi serioze vazhdimësinë e veprimtarisë së shoqërisë.

Ju falënderit për bashkëpunimin,

**Ekspertë Kontabël të Regjistruar (EKR/CPA)**

Saniçe Tafa Vullnetare Cela Fatime Aliu Kristaq Ndini Anita Pulaj

Mimoza Ferzaj Erjon Saraçi



Tiranë, më 28/ 06/2016.



## **OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.**

---

Rruga "Andon Zako Çajupi", Pll. Conad, Kati 3, Tiranë – ALBANIA

### **PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

Tirane me 01.06.2016

## PËRMBAJTJA

Faqe

---

### Pasqyrat financiare

- |  |      |
|--|------|
| - Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2015                          | 3    |
| - Pasqyra e të Ardhurave Përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 | 4    |
| - Pasqyra e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015         | 5    |
| - Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015    | 6    |
| - Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare                                 | 7-52 |



**OSHEE SH.A**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
 Per vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
 (Shumat janë shprehur në LEK'000, përveç kur përmendet ndryshe)

	Shënime	2015	2014
<b>AKTIVET</b>			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	21,081,221	20,388,410
Aktive afatgjata jomateriale	6	372,928	160,656
Aktive financiare	7	2,236	2,584
		<u>21,456,385</u>	<u>20,551,650</u>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarët	9	2,463,770	960,504
Llogari të Arkëtueshme tregtare, neto	10	7,230,546	9,664,801
Të tjera të arkëtueshme, neto	11	357,110	181,663
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	2,718,584	1,800,232
Mjete monetare të ngurtësuara	12	3,900,083	30,021
Parapagimet për tatim fitimin		0	0
		<u>16,670,093</u>	<u>12,637,221</u>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<u><b>38,126,479</b></u>	<u><b>33,188,871</b></u>
<b>PASIVET DHE KAPITALI</b>			
<b>Kapitali dhe rezerva të disponueshme për Aksionerët</b>			
Kapital aksionar	13	30,099,102	30,099,102
Rezerva të tjera	13	2,916,011	2,916,011
Humbje të akumuluar	13	(104,263,468)	(99,752,983)
Të ardhura neto vjetore	13	15,493,200	(4,510,485)
<b>Kapitali total</b>		<u><b>(55,755,156)</b></u>	<u><b>(71,248,355)</b></u>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë afatgjata neto	14	13,297,514	16,842,594
Provizjione		0	12,123
		<u>13,297,514</u>	<u>16,854,717</u>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme	15	42,586,976	50,830,661
Detyrimet për taksa dhe sigurimet shoqërore	16	6,543,924	6,046,339
Detyrim për tatim fitimin	19	4,110,983	2,835,034
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjatë	14	6,204,528	5,722,228
Huatë afatshkurtra		0	0
Detyrime të tjera afatshkurtra	17	14,659,404	15,578,622
Provizjione	18	6,478,306	6,569,625
		<u>80,584,121</u>	<u>87,582,509</u>
<b>Detyrimet totale</b>		<u><b>93,881,635</b></u>	<u><b>104,437,226</b></u>
<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT</b>		<u><b>38,126,479</b></u>	<u><b>33,188,871</b></u>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 51 deri 52.

ADMINISTRATORI  
Adrian ÇELA



DREJTORI EKONOMIK  
Ceno KLOSI

**OSHEE SH.A**  
**PASQYRA E TE ARDHURAVE PERMBLEDHESE**  
**Per vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**

*(Shumat janë shprehur në LEK'000, përveç kur përmendet ndryshe*

	Shënime	2015	2014
Të ardhurat	19	50,402,481	43,445,265
Të ardhura të tjera	20	8,182,581	3,840,267
<b>Të ardhurat operative</b>		<b>58,585,062</b>	<b>47,285,532</b>
Energjia e blerë	21	(26,413,938)	(29,946,136)
Tarifa e transmetimit	21	(3,968,787)	(4,252,544)
Lëndë e parë dhe materiale konsumi të përdorura	9	(822,994)	(700,529)
Shpenzime për personelin	22	(4,170,057)	(3,342,191)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5	(2,079,534)	(2,946,673)
Shpenzime të tjera	23	(1,529,037)	(7,028,621)
<b>Shpenzimet operative</b>		<b>(38,984,348)</b>	<b>(48,216,694)</b>
<b>Fitimi/ (humbja) operative</b>		<b>19,600,714</b>	<b>(931,162)</b>
Të ardhura financiare	24	507,388	72,501
Shpenzime financiare	24	(1,844,735)	(1,216,790)
<b>Shpenzime financiare neto</b>		<b>(1,337,347)</b>	<b>(1,144,289)</b>
<b>Humbja përpara taksave</b>		<b>18,263,367</b>	<b>(2,075,451)</b>
Shpenzim Tatim fitimi		(2,770,167)	(2,435,034)
<b>Humbja e vitit ushtrimor</b>		<b>15,493,200</b>	<b>(4,510,485)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		<b>15,493,200</b>	<b>(4,510,485)</b>
Fitimi (humbja) neto për aksion (LEK për aksion)			
(Humbja)/Fitimi bazë për aksion		(515)	(150)
(Humbja)/Fitimi i pakësuar për aksion		(515)	(150)
Numri mesatar i aksioneve			
Bazë		30,099,102	30,099,102
Pakësuar		30,099,102	30,099,102

Pasqyra e te ardhurave permbledhese duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 52 .

ADMINISTRATORI

Adrian CELA



DREJTORI EKONOMIK

Ceno KLOSI

**OSHEE SH.A**  
**PASQYRA E FLUSEVE MONETARE**  
 Per vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
 (Shumat janë shprehur në LEK'000, përveç kur përmendet ndryshe)

	2015	2014
<b>Aktivitetet operative</b>		
Humbje për periudhën para tatimit mbi fitimin	18,263,367	(2,075,451)
<i>Korrigjuar për:</i>		
Kamate me kompesim	(4,048,302)	(941,884)
Zhvlerësim, amortizim, nxjerrjen jashtë përdorimit (Fitimet)/Humbjet nga kursi i këmbimit valutor neto	2,047,713	2,946,672
Shpenzime Interesi dhe të ardhura nga Interesi	378,757	295,168
Vlerësimi i rezervave, Provigjioneve dhe korrigjimeve të tjera	482,996	408,601
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:	(801,207)	342,656
Llogari të arkëtueshme	3,483,555	(2,856,750)
Materiale dhe furnizime	(1,324,146)	(644,491)
Aktive të tjera afatshkurtra	(175,448)	2,097,693
Mjete monetare të ngurtësuar	(3,900,083)	(30,021)
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	(5,066,985)	4,400,538
<b>Aktive monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>	<b>9,340,217</b>	<b>3,942,730</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar	(1,494,218)	(156,976)
Interesi i paguar	(464,684)	(2,278)
Interesi i arkëtuar	49,280	3,947
Pagesa tarifa garancie	(475,595)	(440,521)
<b>Aktive monetare neto gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>6,955,000</b>	<b>3,346,902</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Shtesat në AAGJM dhe në aktive të tjera	(2,713,435)	(697,507)
Pakësim i AQT	0	0
Shtesat te aktive afatgjata jo materiale	(239,361)	(1,323)
Arketim nga pagesat e huave	347	346
<b>Aktive monetare neto përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(2,952,449)</b>	<b>(698,484)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Flukese monetare hyrëse nga huatë	-	-
Pagesat e huave	(2,670,589)	(1,551,547)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>(2,670,589)</b>	<b>(1,551,547)</b>
<b>Efkti neto nga diferenca e kurseve të këmbimit</b>	<b>(413,610)</b>	<b>(27,660)</b>
<b>Ulja neto në mjete monetare dhe ekuivalente</b>	<b>918,352</b>	<b>1,069,211</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të periudhës</b>	<b>1,800,232</b>	<b>731,021</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të periudhës</b>	<b>2,718,584</b>	<b>1,800,232</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 52 .

ADMINISTRATORI

Adrian ÇELA



DREJTORI EKONOMIK

Ceno KLOSI

**OSHEE SH.A**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**  
**Per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat jane shprehur ne LEK'000, pervec kur përmendet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Kontributi aksionar i paregjistruar	Rezerva të tjera	Humbje të akumuluar	Totali i kapitalit aksionar
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>30,099,102</b>	-	<b>2,916,011</b>	<b>(99,752,983)</b>	<b>(66,737,870)</b>
Të ardhura të tjera 2014	-	-	-	(4,510,485)	(4,510,485)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>30,099,102</b>	-	<b>2,916,011</b>	<b>(104,263,468)</b>	<b>(71,248,355)</b>
Të ardhura të tjera 2015	-	-	-	15,493,200	15,493,200
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>30,099,102</b>	-	<b>2,916,011</b>	<b>(88,770,268)</b>	<b>(55,755,156)</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 7 deri 52.

ADMINISTRATORI

Agjantëria CELA

**OSHEE,sh.a.**

Prerokohi

18-03-15

DREJTORI EKONOMIK

CENO KLOSI



OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)*

## SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

### 1. Informacion i Përgjithshëm

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (ose "Shoqëria") është përgjegjësjë e vetme për shpërndarjen e energjisë elektrike në Shqipëri.

Shoqëria gjatë vitit 2015 ka ndryshuar strukturën organizative dhe në pjesën më të madhe të periudhës së mbyllur, ka qenë e organizuar në Departamentet si vijon:

Divizioni Tregtar (DT), Divizioni i Shpërndarjes (DSH) dhe Divizioni i Administrimit të Përgjithshëm (DAP). Departamenti Ekonomik është pjesë e strukturës së DAP.

Gjithashtu Shoqëria përbëhet nga 11 Drejtori Rajonale që administrojnë shpërndarjen në TM e TU, shitjen dhe arkëtimin e energjisë elektrike, si dhe nga Drejtoia e Tensionit Lartë me 4 Drejtori Rajonale të Tensionit të Lartë (DTL).

Shoqëria u krijua si shoqëri Aksionere më 19 Qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin nr. 862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 Dhjetor 2006. Kjo Shoqëri u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Shoqëria Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.

Më 29 Maj 2009, CEZ a.s, selia e së cilës është e vendosur në Duhova 2 / 1444, 14074, 4 Pragë, Republika Çeke u bë pronar i 76% të aksioneve të Shoqërisë. Pjesa e mbetur prej 24% të aksioneve mbetën në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në 21 Janar 2013, Shoqëria u vendos në administrim të përkohshëm nga shteti, me vendim të ERE Nr.4 datë 21.01.2013 " Mbi heqjen e licencës së shpërndarjes së energjisë Shoqërisë".

Administratori i ri operonte dhe mirëmbante pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare e llogaritë bankare të Shoqërisë. Administratori nuk mund të transferonte asnjë aset ose pasuri materiale të Shoqërisë, nëpërmjet shitjes, pengut, qerasë, shkëmbimit apo formave të tjera.

Me Vendimin e ERE nr.118 dt.18.10.2013, Administrator i Shoqërisë u emërua z. Arben Seferaj, me të gjitha funksionet e kopetencat për administrimin e Shoqërisë.

Me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, nr.63 dt.17.07.2014 dhe rregjistrimin e tij në QKR, Shoqërisë ju ndryshua emri i rregjistruar duke filluar nga data 23.07.2014, nga Cez Shpërndarje sha në Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha me adresë: Rr. Andon Zako Çajupi, Pallati Conad, Kati 3, Tiranë.

Me Ligjin nr.114/2014 dt.31.07.2014, është miratuar marrëveshja për zgjidhjen me mirkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë CEZ AS. Është vendosur transferimi i aksioneve nga CEZ AS shtetit shqiptar, anulimi i të ardhurave të arkëtueshme (detyrimeve) dhe shuma e zgjidhjes me pajtim (detyrimi i ri ndaj CEZ AS).

Bordi i Komisionerëve të ERE, me vendim nr.98 dt.27.10.2014, ka vendosur përfundimin i administrimit të përkohshëm i Shoqërisë.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)

---

Më datën 23.10.2014, Ministri i MZHETS, me cilësinë e Aksionarit të vetëm, me Urdhërin nr.454, ka urdhëruar rregjistrimin e 100 % të aksioneve të Shoqërisë në pronësi të shtetit.

Shoqëria ka Statusin e saj, ku është përcaktuar vendimmarrja dhe drejtimi sipas sitemit me dy nivele. Organet drejtuese janë : Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori.

Këshilli Mbikqyrës me Vendimin nr.1 dt.28.10.2014, ka vendosur Z. Ilir Bejtja Kryetar të këtij këshilli dhe me vendimin nr. 2 dt.28.10.2014, ka emëruar z.Arben Seferaj Administrator të shoqërisë detyrrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 30.11.2014.

Me vendimin nr.9 datë 01.12.2014, Këshilli Mbikqyrës ka emëruar z.Adrian Çela Administrator të shoqërisë OSHEE sha.

Duke filluar nga data 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjistruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.

Shoqëria e ka vendndodhjen në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është në: Tiranë, Rruga Andon Zako Çajupi, Pallati Conad, Kati 3, Tirane (adresa e regjistruar në QKR).

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të aplikueshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë.

### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit ("BSNK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matjeje, sic janë përmendur në politikat kontabël më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Kjo përgatitje kërkon gjithashtu që menaxhimi të ushtrojë gjykim në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Shoqërisë. Fushat të cilat përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë paraqitur në shënimin 4.

Të dhënat krahasuese janë riklasifikuar në bazë të prezantimit të këtij viti.

## 2.2 Ndryshimet në politikat kontabël

Aplikimi i standarteve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2015.

Përmirësimet vjetore ndaj IFRS-ve për cilket vjetore 2010-2012 dhe 2011-2013:

- SNRF 2 “Pagesat bazuar ne aksione” qartëson përcaktimin e “Konditës së kushtëzimit” dhe bën dallimin ndërmjet ‘kushtit të performancës’ dhe ‘kushtit të shërbimit’.
- SNRF 3 “Kombinimet e Bizneseve - Kontabiliteti për detyrimet e mundshme në një kombinim biznesi”- qartëson se një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar klasifikohet si detyrim financiar ose si kapital bazuar në parimet e SNK 32 (Instrumentet Financiare: Paraqitja) dhe se e gjithë shumta e kushtëzuar (detyrim financiar ose jo) matet me vlerën e drejtë në cdo datë raportimi.
- SNRF 3 qartëson se SNRF 3 nuk gjen zbatim në kontabilizimin e lidhjeve të marrëveshjeve të përbashkëta.
- SNRF 8 “Segmentet e shfrytëzimit” kërkon shënime shpjeguese sa i përket gjykimeve të Manaxhimit në lidhje me konsolidimin e segmenteve të aktivitetit të kompanisë dhe qartëson se për një rakordim të segmenteve të aktiveve mund të jepen shpjegime vetëm nëse segmentet e aktiveve bëhen të njohura.
- SNRF 13 “Vlera e drejtë e matjes” konfirmon se llogaritë e arkëtueshme apo të pagueshme afatshkurtra mund të vazhdojnë të maten me vlerën e faturuar nëse impakti nga skontimi është jomaterial.
- SNRF 13 - sqaron se përjashtimet në SNRF 13 (matja e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh dhe detyrimeve financiare mbi bazë neto) zbatohet për të gjitha kontratat brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9
- SNK 16 “Aktivet Afatgjata Materiale” dhe SNK 38 “Aktivet jo-materiale” - sqarojnë se si trajtohen vlera e mbetur dhe amortizimi i akumuluar në rastin kur një entitet kryen rivlerësim të aktiveve.
- IAS 24 - sqaron se kur një entitet merr shërbime menaxhimi nga personeli i një palë të tretë (një entitet menaxhimi), tarifat e paguara për ato shërbime duhet të pasqyrohen në shënimet shpjeguese nga entiteti raportues, por jo pagesa që entiteti i menaxhimit i bën punonjësve apo drejtorëve të tij.).
- IAS 40 - sqaron se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht ekskluzive në bërjen e dallimit midis pronës së investimit dhe pronës që shfrytëzohet nga pronari dhe përcaktimin nëse blerja e një prone investimi mund të cilësohet si një kombinim biznesi.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)*

Amendimi ndaj SNK 19 - "Përftimet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014.) Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përftimet e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përftimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përftimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.

Deri më datë 30 prill 2015, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2015:

- Amendimi ndaj SNRF 9 - "Instrumentat Financiare" (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare që fillojnë më 1 shkurt 2015.)
- Amendimi ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 - "Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në një sipërmarrje të përbashkët" (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektive të shtyrë deri në një deklaram të dytë).
- Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 - "Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNRF 11 - "Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).
- SNRF 14 - "Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregulatore" (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016.)
- SNRF 15 - "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht)
- Amendimi ndaj SNK 1 - "Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016.)
- Amendimi ndaj SNK 16 dhe SNK 38 - "Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit" (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016.)
- Amendimi ndaj SNK 27 - "Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale" (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016.)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të këtë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.



OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përvecur përmentet ndryshe)

### 2.3 Vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, kërkon nga menaxhimi vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe ështëpërfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përshkruar vlerësimet domethënëse.

### 2.4 Këmbimi i valutës së huaj

#### (a) Monedha funksionale dhe ajo e raportimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. I gjithë informacioni financiar i pasqyruar në LEK është i përafëruar në të miltën më të afërt (nëse nuk është shprehur ndryshe).

#### (b) Kursi i këmbimit valutor në fund të periudhës raportuese:

Monedha	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
LEKË për 1 EUR	137.28	140.14
LEKË për 1 USD	125.79	115.23
LEKË për 1 CHF	126.74	116.52
LEKË për 100 YEN	104.50	96.49
LEKË për 1 KRË	0.1072	0.1059
LEKË për 1 XDR	174.46	166.9
LEKË për 1 GBP	186.59	-

### 2.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Toka dhe ndërtesat përfshijnë përgjithësisht nënstacione, kabinat elektrike dhe ndërtesa administrative për zyra. Të gjitha Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) janë shfaqur me kosto historike (ashtu siç parashikohet në paragrafin e mëposhtëm) minus zhvlerësimet dhe rëniet në vlerë, përveç tokës, e cila shfaqet me kosto minus rënien në vlerë. Kostot përfshijnë shpenzime që lidhen direkt me blerjen e aktivit.

Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me transformimin e aktivit në kushte pune për qëllimin e tij të caktuar si dhe kostot e çmontimit dhe largimit të aktivit dhe kthimin e zonës ku ka qenë vendosur aktivi në gjëndjen e mëparshme. Çdo blerje programesh kompjuterike që është pjesë e pandashme e veprimtarisë së pajisjes është kapitalizuar si pjesë e kësaj pajisjeje.

Në 1 Janar 2007, AAM të Shoqërisë u ndanë nga aktivet e KESH sh.a. Këto AAM që u ndanë, u regjistruan me një vlerë të bazuar mbi vlerën e mbartur të aktiveve në pasqyrat financiare të KESH më 31 Dhjetor 2006. Shoqëria mëmë ka zgjedhur të vlerësojë një pjesë të konsiderueshme të AAM-ve të veta përgjatë kalimit të saj.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)

Në SNRF më 1 Janar 2006 me vlerën e drejtë bazuar në vlerësimin e bërë nga njëvlerësues i pavarur që prej 31 Dhjetor 2003, dhe ka përdorur këto shuma si bazë për kosto të konsideruara për qëllime raportimi në bazëtë SNRF në datën e rivlerësimit.

Kostoja e zëvendësimit të njëpjesë të AAM, njihet nëvlerën e mbetur të AAM, vetëm nëse është e mundshme që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me këtë pjesë të zëvendësuar do të rrjedhin nëShoqëri si dhe nëq kostoja e saj mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Kostot ditore të mirëmbajtjes dhe të tjera të lidhura me AAM, do të njihen në shpenzimet e periudhës përkatëse që ato ndodhin.

Kostoja e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të njësisve jo të rëndësishme të AAM regjistrohet si shpenzim mirëmbajtjeje nëperiudhën kur ndodh. Rinovimet dhe përmirësimet kapitalizohen. Kur kryhet shitja, nxjerrja jashtë përdorimit ose zëvendësimi i njëpjesë të AAM, kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar përkatës i zërit të nxjerrë jashtë përdorimit ose pjesës së zëvendësuar eliminohen nga llogaritë. Fitimi ose humbja që mund të rezultojë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave.

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë indikacion që ndonjë aktiv mund të ketë pësuar rënie në vlerë (të jetë zhvlerësuar). Kur një indikator i tillë ekziston, Shoqëria rishikon shumat e rikuperueshme të aktiveve të saj afatgjata materiale, për të përcaktuar nëse këto shuma vazhdojnë tëtejkalojnë vlerat e mbartura të aktiveve. Zhvlerësimi i identifikuar i aktiveve afatgjata materiale njihet direkt nëpasqyrën e të ardhurave, në zërin e shpenzimeve të tjera operative.

#### Zhvlerësimi

Shoqëria zhvlerëson koston fillestare të AAM, minus vlerën e rikuperueshme, duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit përgjatë jetës ekonomike tëvlerësuar. Çdo pjesë e njësisë së AAM me një kosto që është domethënëse, në lidhje me koston totale të njësisë, zhvlerësohet veçmas. Tabela e mëposhtme shfaq kohën e përdorimit të vlerësuar të aktiveve:

	<u>Jetëgjatësia (në vite)</u>
Ndërtesa dhe struktura	20 - 50
Makineri dhe pajisje	4 - 20
Mjete transporti	3 - 8
Pajisje zyre	3 - 8

Vlera e mbetur e aktiveve, jetëgjatësia dhe metodat e zhvlerësimit janë rishikuar, rregulluar aty ku është e nevojshme, në fund të çdo viti financiar.

## 2.6 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlerat e mbartura e aktiveve jo-financiare të Shoqërise, përveç inventarëve dhe aktivitetit të shtyrë tatimor, do të rishikohen në cdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, vlera e përfitueshme e aktivitetit duhet të vlerësohet. Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit njihet kur vlera e mbartur është më e lartë se vlera e tij e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë e aktiveve njihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)*

---

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e lartë e vlerës në përdorim të tij ose vlerës së drejtë të aktivit minus kostot e shitjes. Kur bëhet vlerësimi i vlerës në përdorim të aktivit, flukset e ardhshme të vlerësuara monetare, skontohe në vlerën e tyre të tanishme, duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin e tanishëm të tregut të vlerës së parasë dhe të riskut specifik të aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë, të njohura nëperiudhat e mëparshme, vlerësohen në cdo datë raportimi për cdo indikacion të mundshëm nëse humbja është rritur apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë, rikthehet nëse ka ndryshime në vlerësimet e bëra për përcaktimin e vlerës së përfitueshme. Një humbje nga rënia në vlerë kthehet deri në vlerën që vlera e mbartur e aktivit nuk kalon vlerën e mbetur që do përcaktohej, neto nga zhvlerësimet dhe amortizimet, nëse humbja nga rënia në vlerë e aktivit nuk do të njihej.

## 2.7 Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar do të konsiderohet i zhvlerësuar në rastin kur ekzistojnë fakte të dukshme që një ose disa ngjarje kanë patur efekt negativ mbi fluksin pritshëm monëtar të vlerësuar.

Një humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, i matur me koston e amortizimit, përlllogaritet si diferencë midis vlerës ekzistuese dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parave të aktualizuara me normën fillestare efektive tëInteresit.

Aktivet financiare të rendësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet në grup, për grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme risku.

Një zhvlerësim i aktivit mund të jetë i kthyeshëm në rast se ky kthim mund të lidhet me një ngjarje objektive e cila ndodh pas njohjes së zhvlerësimit të aktivit. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, kthimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## 2.8 Inventarët

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përfshin shpenzimet e njohura gjatë blerjes së inventarit, prodhimit ose koston së tjetërsimit dhe kostove të tjera shtesë të njohura për ruajtjen dhe sjelljen në pozicionin ekzistues të inventarit. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në process koston përfshijnë një marzh të kostove shtesë prodhuese, bazuar në operimin me kapacitet normal.Vlera neto e realizueshme është ekuivalente me diferencën e cmimit të shitjes së parashikuar, në rastin e një veprimtarie normale të biznesit me koston totale të parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

## 2.9 Instrumentat financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiare jo derivativë duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme nga shitjet dhe llogari të tjera të Arkëtueshme, para dhe ekuivalentet e saj, kredi dhe hua, si edhe llogari të pagueshme e detyrime të tjera.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)

---

Instrumentat financiarë jo-derivativë vlerësohen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë plus, për instrumentë jo të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e tjera të transaksionit. Pas njohjes fillestare këto instrumenta jo-derivativë maten si më poshtë:

Një instrument financiar njihet në momentin kur shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëq të drejtat kontraktuale tëshoqërisë mbarojnë ose ndërpriten ose nëse shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa patur kontroll ose të gjitha risqet dhe shpërblimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, dmth datën që shoqëria merr përsipër të blejë apo të shesë aktivin.

Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë mbarojnë ose anulohen.

#### *Aktivët monetare dhe ekuivalentë të tjerë*

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë para në dorë, depozitat e lira në banka dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet fillestar prej tre muajsh ose më pak.

#### *Llogaritë e Arkëtueshme*

Të drejtat ndaj të tretëve njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me diferencën e kostos së amortizuar me humbjet nga zhvlerësimi.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme fillimisht regjistrohen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

#### *Kreditë dhe Huamarrjet*

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huatë njihen me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë midis kostos dhe vlerës së shlyerjes duke u njohur në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes.

#### *Të tjera*

Instrumentet e tjera financiare jo-derivativë maten si diferencë e kostos së amortizuar, duke përdorur metodën efektive të interesit, me humbjet nga rënia në vlerë (zhvlerësimi).

Vlera e drejtë e të drejtave ndaj të tretëve, duke përfshirë punën e prodhimit në proces, është vlerësuar si vlerë aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë aktualizuar me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

Instrumentet financiare janë të klasifikuara si detyrime aktuale vetëm nëse shoqëria ka të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë zgjidhjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)

---

## 2.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga Interesi mbi gjëndjen e fondeve në bankë dhe fitimet nga kursi i këmbimit i njohur në Pasqyrën e të Ardhurave. Të ardhurat nga Interesi njihen në vazhdimësi.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimi i interesit të huave si dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

## 2.11 Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë itë ardhurave

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë. Shpenzimet tatimore njihen në Pasqyrën e të Ardhurave, përveçse kur lidhen me zëra të njohur drejtpërdrejtë në kapital dhe në një rast të tillë ato njihen si pjesë kapitali.

Manaxhimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e marra në deklaratimet e tatimit mbi fitimin, duke marrë parasysh situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt i interpretimeve dhe aty ku është e përshtatshme, krijon Provigjionet përkatëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë parasysh diferenca të përkohshme ndërmjet vlerësneto kontabël në bilanc të një aktivi ose pasivi për qëllime të raportimit financiar dhe bazës së tij tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme, kur ato të kthehen mbrapsht, në bazë të ligjeve që janë nxjerrë ose miratuar në datën e raportimit.

## 2.12 Përfitimet e punonjësve

### *(a) Fondet për pension, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni aktual shqiptar për të derdhur kontribute fikse në emër të të punësuarve në një fond për sigurim shoqëror tëpërcaktuar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa / detyrime njihen si shpenzime në periudhën me të cilën ato lidhen.

### *(b) Përfitimet pas ndërprerjes së punës*

Në përputhje me Kontratën e punës kolektive, në rast të përfundimit të një kontrate pune pasi punonjësi ka arritur moshën e nevojshme në bazë të ligjit për dalje në pension, pavarësisht nga arsyeja për ndërprerjen e punës, punonjësi ka të drejtë për një kompensim prej dy pagash mujore bruto.

Përfitimet e ndërprerjes së punës njihen si shpenzime kur shoqëria i është nënshtruar, pa mundësi reale për t'u tërhequr, një plani të detajuar zyrtar për ndërprerjen e punësimit para datës së daljes në pension ose për të siguruar përfitime për ndërprerje të marrëdhënies së punës si rezultat i një oferteqë mund të bëhet punonjësit për largim vullnetar. Përfitimet pas ndërprerjes së punës për largime vullnetare njihen si një shpenzim në qoftë se shoqëria bën një ofertë inkurajuese për largim vullnetar, është e mundur që kjo ofertë të pranohet dhe numri i pranimeve mund të vlerësohet lehtësisht.

### 2.13 Provigjionimi

Provigjionimi njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të kaluar, shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose të ardhshëm që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një pjesë e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjionet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të ardhshme të parave me normën e interesit para - tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parësë dhe risqet specifike që lidhen me atë detyrim.

### 2.14 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fluksi bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës aktuale dhe normale të aktivitetit të një njësie ekonomike kur ato flukse rezultojnë në rritje në kapital, përveç rritjeve të kontributeve nga pjesëmarrësit e kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të konsideruar dhe pranuar si të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së kompanisë. Të ardhurat janë të njohura neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet, rimbursimet dhe zbritjet.

Shoqëria i njeh të ardhurat në bazë të faturave të lëshuara për energjinë e furnizuar, kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që njësia do të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike. Shuma e të ardhurave nuk mund të konsiderohet e matshme me besueshmëri, derisa të gjithë detyrimet e kushtëzuara që kanë të bëjnë me shitjen të jenë zgjidhur. Shoqëria bazon vlerësimet e saj mbi rezultatet historike, duke marrë parasysh llojin e konsumatorit, llojin e transaksionit dhe specifikat e çdo marrëveshjeje.

#### *(a) Shitjet e energjisë elektrike*

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike përbëjnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike të furnizuar. Faturimet e energjisë elektrike bëhen në baza mujore.

#### *(b) Të ardhura të tjera*

Të ardhurat mbi shërbimet e ofruara klientëve si psh. ndryshimi i emrit në kontratë, verifikimi i matësit, janë të njohura kur shërbimi ofrohet. Këto të ardhura, sëbashku me të ardhurat nga kamatëvonesat për pagesat me vonësë, janë të përfshira në të ardhura të tjera.

### 2.15 Qiratë

Kontratat e qirave në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia janë të mbajtura nga qiradhënësi, janë klasifikuar si qira operative. Pagesat e bëra nën zërin e qirave operative (neto duke i zbritur të gjithë stimujt e marrë nga qeramarrësi), futen në pasqyrën e të ardhurave me bazë lineare gjatë gjithë periudhës së qirasë.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)*

---

## 2.16 Grantet qeveritare dhe grante të tjera

Grantet e tjera (dhurime asetesh) janë njohur si të ardhura në Pasqyrën e të Ardhurave në mënyrë sistematike në të njëjtën periudhë në të cilën shpenzimet janë njohur.

## 3. Menaxhimi i riskut financiar

Funksioni i Menaxhimit të riskut në kompani është kryer në lidhje me rreziqet financiare (rreziku i kredisë, i tregut, i kursit të këmbimit, i likuiditetit dhe i normave të interesit), rreziqet operacionale (të tilla si rrezik për mjedisin) dhe rreziqe ligjore. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit financiar të rrezikut janë vendosur për të përcaktuar kufijtë e rrezikut e më pas të sigurojnë qëndrimin brenda këtyre kufijve të ekspozimit ndaj rreziqeve. Menaxhimi operacional dhe ligjor ka për qëllim të sigurojë funksionimin e duhur të politikave dhe proceduravetë brendshme për të minimizuar risqet operacionale dhe ligjore.

### 3.1 Risku i kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë në instrumentin financiar, do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër, duke mos arritur që të shlyhet detyrimi. Ekspozimi kryesor i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë lind për shkak të drejtave ndaj të tretëve. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj riskut të kredisë korrespondon me shumat e mbartura të aktiveve financiare në bilanc. Impakti i kompensimit të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të reduktuar ekspozimin ndaj riskut të kreditit, nuk është domethënës.

#### 3.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit në veprimtarinë e saj të përditshme, sepse është e mundur që klientët e saj si dhe huamarrësit do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Strukturat e Kompanisë, nivelet e rrezikut të kredisë që merr përsipër, duke vendosur kufizime në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me palë të treta dhe nëpërmjet diversifikimit të portofolit të kredisë, janë metoda në menaxhimin e riskut. Rreziqet e tilla janë të monitoruara në një bazë të ndryshueshme dhe i nënshtrohen një analizë vjetore ose dhe më të shpeshtë.

#### 3.1.2 Përqëndrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj përqëndrimeve të rrezikut të kredisë. Menaxhimi monitoron përqëndrimin e rrezikut të kredive, por has vështirësi në zbatimin e politikave më të mira të menaxhimit të ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut të tillë, duke diversifikuar portofolin e kredisë. Kjo ndodh për shkak se shoqëria është e detyruar të furnizojë me energji konsumatorin final. Në kushte të tilla, diversifikimi është i vështirë për t'u aplikuar. Në rastin e shitjes së energjisë, rreziqet e kompanisë ekzistojnë në mospërmbushjen e objektivave të saj, për një ose më shumë nga arsytet e mëposhtme: a) konsumatorët refuzojnë të paguanjë faturat e tyre, b) konsumatorët ndërhyjnë apo shkëpusin matësat. Depozitat bankare të kompanisë mbahen në banka të ndryshme.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)*

### 3.2 Risku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmimet e tregut vendas (tarifave të transmisionit të energjisë), normat e këmbimit valutor si dhe normat e interesit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment në kohë ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritjet e çmimeve në të ardhmen apo lëvizjet e kursit të tregut dhe përbërjen e aktiveve të kompanisë dhe të portofolit të kontratës.

Menaxhimi përcakton kufijtë për vlerën e rrezikut që mund të pranohet, të cilët monitorohen në baza mujore.

#### 3.2.1 Risku nga këmbimi valutor

Risku nga kursi i këmbimit vjen nga fakti se pjesa më e madhe e kredive të saj e një pjesë e të pagueshmeve si dhe një pjesë e të arkëtueshmeve të shoqërisë janë në valutë. Risku shkaktohet nga fakti se vlera e monedhës funksionale do të ndryshojë duke qenë se flukset e parave që dalin nga shlyerja e huave e Interesave të lidhura me to dhe të pagueshmeve të tjera, do të ndryshojnë si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në fitimin e kompanisë. Po kështu ndikim do të ketë edhe nga gjendjet e valutave në banka dhe të arkëtueshmet në valutë.

Të dhëna për Të Arkëtueshme dhe Të Pagueshme në valutë, më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014, janë si më poshtë, të shprehura në mijë lekë sipas valutave :

Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 :

Te Arkëtueshme/ Te pagueshme	Euro	USD	SDR	KRË	YEN	GBP	Totali
Llogari treg. te arket. dhe te tjera	1,519						1,519
Mjete monetare ne arke dhe banke	2,565,264	554				15	2,565,833
<b>Shuma</b>	<b>2,566,783</b>	<b>554</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15</b>	<b>2,567,352</b>
Llogari treg. te paguesh. e te tjera	2,933,138	4,116					2,937,254
Huate	13,930,680	1,474,499	932,007	861,136	2,303,720	0	19,502,042
<b>Shuma</b>	<b>16,863,818</b>	<b>1,478,615</b>	<b>932,007</b>	<b>861,136</b>	<b>2,303,720</b>	<b>0</b>	<b>22,439,296</b>
<b>Rrishti i kursit Këmbimit me 31 Dhjetor 2015</b>	<b>19,430,601</b>	<b>1,479,169</b>	<b>932,007</b>	<b>861,136</b>	<b>2,303,720</b>	<b>15</b>	<b>25,006,648</b>

Ekspozimi total është i barabartë me ekspozimin neto për zërat e bilancit në valutë, i shprehur në lekë më 31 Dhjetor 2015, është 25,006,648 mijë lekë.



OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)

Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 :

	Euro	USD	SDR	KRË	YEN	Totali
Llogari tregëtare të arketueshme dhe të tjera	1,643					1,643
Mjete monetare në arke dhe banke	2,998	375				3,373
<b>Shuma</b>	<b>4,641</b>	<b>375</b>				<b>5,016</b>
Llogari tregëtare të pagueshme dhe të tjera	6,842,876	319				6,843,195
Huate	17,091,277	1,408,952	908,339	873,707	2,181,011	22,463,286
<b>Shuma</b>	<b>23,934,153</b>	<b>1,409,271</b>	<b>908,339</b>	<b>873,707</b>	<b>2,181,011</b>	<b>29,306,481</b>
<b>Rrisku i kursit Këmbimit me 31 Dhjetor 2014</b>	<b>23,938,794</b>	<b>1,409,646</b>	<b>908,339</b>	<b>873,707</b>	<b>2,181,011</b>	<b>29,311,497</b>

Ekspozimi total është i barabartë me ekspozimin neto për zërat e bilancit në valutë, i shprehur në lekë më 31 Dhjetor 2014, është 29,311,497 mijë lekë.

### 3.2.2 Risku nga norma e interesit

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria merr hua për të financuar operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës të interesit për shkak se, vlera e drejtë e huasë me normë fikse dhe flukset e lidhura me hua me normë të ndryshueshme, do të sjellin ndryshime në normat e interesit.

Shoqëria nuk ka politika formale dhe procedura në fuqi për menaxhimin e rreziqeve të normës së interesit për at kohë sa menaxhimi e konsideron këtë rrezik si të parëndësishëm duke qenë se Shoqëria aktualisht zotëron hua pa interes ose me norma Interesi nën normat e tregut.

### 3.2.3 Risqe të tjera të çmimeve

#### 3.2.3.1 Çmimet e kapitalit

Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj riskut të çmimit të kapitalit, për at kohë sa ajo nuk zotëron aktive financiare të përbërë nga instrumente të kapitalit. Nuk është në politikën e kompanisë blerja e instrumenteve të tilla dhe në të tilla rrethana, ajo nuk është e ekspozuar nga lëvizjet e çmimeve në tregun e kapitalit.

#### 3.2.3.2 Çmimet e energjisë

Sipas modelit të tregut aktual të energjisë, shoqëria përllogarit një tarifë fikse për njësi të energjisë siç është miratuar nga Enti Shqiptar Rregullator i Energjisë. Sipas kuadrit legjislativ, parashikohet që shoqëria të përballojë shpenzimet që vijnë në formën e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancuar, e cila është sasia e energjisë së nevojshme për të mbushur hendekun midis konsumit dhe furnizimit të energjisë në një periudhë të caktuar të ditës. Çmimi i energjisë elektrike në tregjet vendase dhe ndërkombëtare është veçanërisht i rëndësishëm për kompaninë në rrethana të tilla të reja.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)*

Çmimet e energjisë që Shoqëria do të mund të aplikojë në lidhje me energjinë e blerë dhe të shitur duke filluar nga 2008, janë subjekt i miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, gjë që do të sjellë një risk të çmimeve. Në fund të vitit 2014 ka përfunduar periudha e tretë rregullore dhe Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar çmimet e energjisë për vitin 2015.

### 3.3 Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si risku që një njësi ekonomike do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me shlyerjen e detyrimeve financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme për likuiditet, kryesisht në mënyrë që të mbulojë shpenzimet e saj operative gjatë veprimtarisë normale si dhe për të shlyer borxhet e saj. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në grumbullimin e të ardhurave për energjinë e sidomos nga konsumatorët individualë. Menaxhimi monitoron me kujdes parashikimet për arkëtimet/pagesat mujore (lëvizjet e flukseve të parave).

Procesi i menaxhimit të likuiditetit të miratuar nga ana e menaxhimit përfshin edhe vendosjen e afateve për shpenzimet e zonave që lidhen me aktivitetet e përditshme si për shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave të kreditorëve të caktuar, apo shtyrjen e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve, duke parashikuar pagesat e borxhit dhe siguruar se ato janë të mbuluara, etj.

Të dhënat dhe llogaritja e rrishtit korrekt të likuiditetit, më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014, janë si më poshtë :

Aktivet/detyrimet Afat Shkurter	Me 31.12.2015	Me 31.12.2014
Inventarët	2,463,770	960,504
Llogari tregetare të arketueshme dhe të tjera	7,587,656	9,846,464
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6,618,667	1,830,253
	<b>16,670,094</b>	<b>12,637,221</b>
Llogari tregetare të pagueshme dhe të tjera	42,586,976	50,830,661
Taksa, Tatime, Sigurime Shoq. & Shend.	7,884,739	8,881,373
Hua	6,204,528	5,722,228
Të tjera të pagueshme	21,138,010	22,148,247
	<b>77,814,254</b>	<b>87,582,509</b>
<b>Rrisku i Likuiditetit në fund të periudhës</b>	<b>0.21</b>	<b>0.14</b>

### 3.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion në mes dy palëve të gatshme, përveç se në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm, dhe është përcaktuar më së miri nga një çmim tregu.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)

**Vlerat e drejta të instrumentëve financiare**

Vlera e drejtë përcaktohet si shuma me të cilën instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion aktual ndërmjet palëve të gatshme ,në një transaksion ku palët veprojnë në mënyrë të pavarur (parimi arm's length), përveçse në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm.

Vlerat e drejta merren nga cmimet e kuotuar në treg, modelet e skontimit të fluksit të parasë dhe modelet e cmimeve të tregut për produktet, sipas rastit. Metodot dhe supozimet e mëposhtme përdoren për të vlerësuar çmimin e tregut në cdo kategori të instrumenteve financiare:

*Aktive monetare dhe ekuivalente tjetërë, investimet afatshkurtra*

Vlera e mbartur e parave dhe aktiveve financiare afatshkurtra përafrohet me vlerën e drejtë në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

*Llogari të arkëtueshme dhe për t'u paguar*

Vlera e mbartur e llogarive të arkëtueshme dhe për t'u paguar përafrohet me vlerën e drejtë në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

*Kredi afatshkurtra*

Vlera e mbartur përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të periudhës së shkurtër të maturitetit të këtyre instrumenteve.

*Borxhi afatgjatë*

Vlera e drejtë e borxhit afatgjatë bazohet në flukset kontraktuale të skontuara me normat e përshtatshme të tregut. Sasia e mbartur e borxhit afatgjatë dhe llogarive të tjera për t'u pagur me norma të ndryshme Interesi përafrohet me vlerën e tyre të drejtë.

Vlerat e mbartura dhe vlerat e pritshme të drejta të instrumenteve financiare më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014, janë si më poshtë (në mijë lekë):

Aktivet /Detyrimi	Kategoria	2015		2014	
		Vlerat e mbartura	Vlera e drejtë	Vlerat e mbartura	Vlera e drejtë
<b>Aktivët Afat shkurtëra :</b>					
Llogari të Arkëtueshme	KLLA	7,230,546	7,230,546	9,664,801	9,664,801
Aktivët monet. e të tjerë	KLLA	6,618,667	6,618,667	1,830,253	1,830,253
Aktive të tjera afatshk	KLLA	2,820,881	2,820,881	1,142,166	1,142,167
<b>Detyrimet :</b>					
Borxhi afatgjatë	KA	(13,297,513)	(13,297,514)	(16,842,594)	(16,842,594)
Borxhi afatshkurtër	KA	(6,204,527)	(6,204,528)	(5,722,227)	(5,722,228)
Llogaritë e pagueshme	KA	(42,586,976)	(42,586,976)	(50,830,660)	(50,830,661)
Të tjera të pagueshme	KA	(22,544,144)	(22,544,144)	(24,459,995)	(24,459,995)

KLLA Kreditë dhe Llogaritë e Arkëtueshme

KA Detyrimet financiare me koston e amortizimit

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)

### 3.5 Menaxhimi i Kapitalit

Kur flitet për menaxhimin e kapitalit objektivat e kompanisë janë të tilla për të ruajtur një vazhdueshmëri normale të aktivitetit në mënyrë që të sigurohen fitime për Aksionerët dhe përfitime për patët e Interesuara si edhe për të mbajtur një strukturë optimale kapitali në mënyrë që të reduktohet sa më shumë kosto e kapitalit.

Struktura e kapitalit aksionar nuk ka ndryshuar nga vitit i mëparshëm. Të dhënat për kapitalin aksionar dhe strukturën e tij në fund të periudhës 31 Dhjetor 2015 është si më poshtë :

Gjendja më 31,12,2015

Numeri i Aksioneve	Vlera nominale e aksionit	Aksioner :	Struktura Kapitalit regjistruar	Kapitali aksionar - ne leke
30,099,101	1,000	MZHETTS - Qeveria Shqiptare	100%	30,099,101,000
		Totali		<u>30,099,101,000</u>

### 4. Vlerësimet kritike dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet bëhen në vazhdimësi dhe bazohen në përvoja historike, duke përfshirë kohën e para ndarjes si dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë ngjarje të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësimet dhe supozimet lidhur me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas rastit, pothuajse të barabarta me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm dhe mund të shkaktojnë një rregullim material në vlerat e aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë:

#### 4.1 Vlerësime dhe supozime kritike kontabël

##### (a) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (për shembull, hua të marra ose të dhëna punonjësve) përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një numër metodash dhe bën supozime që bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë bilanci. Shoqëria përdor metodën e skontimit të fluksit të mjeteve monetare për aktive dhe detyrime financiare që nuk tregtohen në tregje aktive.

##### (b) Aktivët afatgjatë materiale

Drejtimi i shoqërisë përcakton jetën e dobishme të pritur të përdorimit dhe normat e zhvlerësimit, në lidhje me aktivët afatgjatë që ka në zotërim. Ky vlerësim bazohet në ciklet e përcaktuara të jetës së aktivitetit. Kjo mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të mundshme në treg. Ndryshimet e mundshme në jetëgjatësinë e përdorimit të aktivitetit mund të çojnë në axhustime të vlerës së tyre neto.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)*

---

*(c) Rënie në vlerë e aktiveve financiare (hua dhe llogari të Arkëtueshme)*

Shoqëria ndjek udhëzimet e SNK-ve për të përcaktuar se kur një aktiv financiar ka pësuar rënie në vlerë. Ky përcaktim kërkon gjykim të thellë. Gjatë kryerjes së këtyre gjykimeve, Shoqëria vlerëson, veç faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe shtrirjen gjatë të cilës vlera e drejtë e një investimi, është më e vogël se kostoja e tij dhe flukset e veta të mjeteve monetare.

Rigjykimi i rënies në vlerë, të llogarive të Arkëtueshme në vitin pasardhës, mund të çojnë në korigjime të vlerës së mbartur të llogarisë së arkëtueshme.

#### 4.2 Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin se Shoqëria do të ketë vijimësi të aktivitetit të saj.

Me kalimin 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar, menaxhimi dhe strategjia e shoqërisë OSHEE janë pjesë e strategjisë kombëtare që Qeveria po ndjek në të gjithë sektorët përfshirë këtu sektorin energjistik pjesë e të cilit është kjo shoqëri.

Rezultatet e aksionit të ndërmarë me mbështetje të Qeverisë i kaluan të gjitha pritshmëritë dhe në fund të 3 mujorit të parë 2015 shoqëria arriti për herë të parë të ketë një rezultat pozitiv 3 mujor që prej krijimit të saj në vitin 2007. Në fund të vitit 2015 fitimi i realizuar nga aktiviteti ishte 17 miliard Lekë ose rreth 122 milion EURO. Plani agresiv për uljen e mëtejshme të humbjes e cila në vitin 2019 pritet të shkojë në 15.2% do ta përmirësojë edhe me tej gjendjen financiare të shoqërisë.

Niveli i humbjeve në rrjet është ulur dhe vazhdon të ulet nga muaj në muaj. Arkëtimet janë rritur dhe shoqëria po vazhdon pagesat e detyrimeve edhe ato të periudhave të mëparshme.

Administrimi ka arritur në përfundimin se përgatitja e pasqyrave në bazë të parimit të vijimësisë është e drejtë.

Angazhimet dhe masat e marra nga Qeveria, në përmirësimin e situatës ekonomike e financiare, duke siguruar vijimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, po i përshkruajmë si më poshtë :

- Miratimi me VKM në Shkurt 2015, i planit të Rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike, duke vendosur objektiva konkret për të kthyer sistemin energjistik në një sistem të vetëqëndrueshëm dhe me aftësi likuiduese, për të siguruar furnizimine vazhdueshëm pa ndërprerje dhe të besueshëm të energjisë për të gjithë vendin, për të përmirësuar efikasitetine sistemit të energjisë në sektorin e shpërndarjes duke zvogëluar humbjet dhe duke përmirësuar arkëtimet ;
- Nxjerrja e Vendimeve të Qeverisë, për shuarjen me kompensim të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore që financohen nga buxheti, Kesh sha , OSHEE sha dhe Ministrisë së Financave ;
- Miratimi nga ERE në Shkurt 2015, i marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike ndërmjet KESH sha dhe OSHEE sha për vitin 2015, furnizim jo vetëm për klientët tarifor ;

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmentet ndryshe)*

- Miratimi në fund të Prillit 2015, i ligjit për Sektorin e energjisë elektrike, ku ndër të tjera bën rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;

Nga ana tjetër, Adminstrimi i Shoqërisë është përqëndruar në organizimin dhe përmirësimin e punës duke u përqëndruar:

- Në arkëtimin e faturave të energjisë, duke u përqëndruar në arkëtimin e faturës së muajit koherent dhe duke krijuar hapësira lehtësuese për arkëtimin e debitorëve të prapambetur nëpërmjet marrëveshjeve të pagesave me këste ;
- Në uljen e humbjeve teknike, nëpërmjet ndërhyrjes me investime në rrjet, duke filluar nga zonat më problematike e nga abonentët pa matje dhe duke projektuar investime në matje e rrjetin shpërndarës ;
- Në organizimin e punës dhe angazhimin maksimal të drejtuesve e profesionistëve, duke propozuar edhe riorganizim më eficient të strukturave të shoqërisë.

Si rezultat i këtij angazhimi të qeverisë dhe i administrimit të shoqërisë, :

- në fund të vitin 2015 niveli i humbjeve në rrjet është ulur me 6.47% dhe niveli i arkëtimeve është rritur me 7.71% krahasuar këto me fundvitin 2014 ;
- në fund të periudhës Prill 2016, treguesi i humbjeve ne rrjet është 2.89% më i ulët dhe treguesi i arkëtimeve është 4.72% më i lartë se objektivat e vendosura për këto tregues (sipas buxhetit).
- të ardhurat nga faturimi i energjisë janë rritur 15.9% në vitin 2015 të krahasura me vitin 2014.
- shpenzimet operative janë ulur me 20.5% në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Ndërsa në fund te Prillit 2016, Shoqëria rezulton me fitim për 2.8 mld lekë.

Në tabelat e mëposhtme paraqitet një historik i treguesve kryesorë: *(në milion LEK)*

	2014 Aktual	2015 Aktual	Deri në Prill 2016 Aktual
Marzhi bruto	9,213	20,028	7,961
Të ardhura të tjera	3,840	4,126	712
OPEX pa përfshirë amortizimin	(10,729)	(7,323)	(3,157)
Provigjionim edhe rezerva	(309)	801	(940)
EBITDA	2,015	17,632	4,576
Humbja Neto	(4,510)	15,493	2,835

	2013 Aktual	2014 Aktual	2015 Aktual	Deri në Prill 2016 Aktual
Norma e arkëtimin	80.67 %	91.90 %	99.61 %	94.72 %
Norma e humbjeve	44.74 %	37.81 %	31.34 %	30.31 %
Tarifa e KESH	2,200	2,200	3,000	3,000
Tarifa e OST	650	650	650	650

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)*

---

#### Masat në administrimin e likuiditetit

Duke përqëndruar punën në uljen e kostove dhe rritjen e arkëtive, shoqëria po likujdon detyrimet ndaj të tretëve duke ulur ato me rreth 11.3 miliard Lekë në krahasim me vitin 2014, përfshirë detyrimet koherente dhe ato të prapambetura, duke krijuar kështu një marrëdhënie të re besimi dhe partneriteti me furnitorët.

Likuidimet e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH dhe OST janë programuar në sipas vendimit të Qeverisë në Planin e Rimëkëmbjes duke programuar njëkohësisht edhe likuiditete të mjaftueshme për investimet të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes. Sipas planit të rimëkëmbjes detyrimi i OSHEE ndaj KESH dhe OST ishte të paguante 85% të faturës vjetore 2015. Në fakt pagesat gjatë vitit 2015 kanë qenë në nivelin e 99% të faturës vjetore ndaj KESH dhe 120% ndaj OST.

Është paguar kësti i detyrimit ndaj CEZ AS dhe vazhdon të krijohet rezerva monetare në bankë, për pagesën në afatin e duhur të këstit të radhës.

#### Masa të tjera

Angazhimi i Qeverisë vazhdon të jetë evident, në marrjen e masave me akte ligjore e nënligjore në mbështetje të rimëkëmbjes sistemit energjitik. Më poshtë janë aktet më kryesore për këtë çështje :

- Vazhdimi i punës i Njësisë Task-Forcë, nën drejtimin e zv/kryeministrit, për përmirësimin e nivelit të arkëtive dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, ka çuar në përmirësimin e trguesve financiarë të Shoqërisë ;
- Është ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 74 dt.27.05.2015, Grupi i Punës Ndërinstitucional për evidentimin dhe adresimin e problematikave për:
  - a. Shlyerjen e detyrimeve të ndërsjellta ku pjesë e propozimeve do jenë trajtimi i :
    - Të arketueshmeve nga Institucionet Buxhetore e joBuxhetore ;
    - Anullimi i faturave të viteve të kaluara ;
    - Detyrimet ndaj Tatimeve.
  - b- Parandalimi i krijimit të detyrimeve të tjera, si p.sh. TVSH për humbjet në rrjetin e shpërndarjes apo Tatim Fitimi për shkak tëshpenzimeve për energji nga humbjet e panjohura.
- Marrëveshja e Qeverisë me Bankën Botërore (IBRD) në fillim të Nëntorit 2014, për marrjen e Huasë në vlerën 150 mln dollarë nga të cilat për të investuar në Shoqërinë OSHEE sha, vlerën 112 mln dollarë, ka filluar të japë efektet me disbursimin e parë në fund të vitit 2015.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveçkur përmendet ndryshe)

---

Gjithashtu, organizimi i ri i Shoqërisë, me organe drejtuese Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbykqyrës dhe Administratori, ka shtuar përgjegjshmërinë e marrjes së vendimeve për aktivitetin e Shoqërisë. Kështu gjatë vitit 2015, janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme në vijim të përmirësimit të punës dhe menaxhimit sa më të mirë të shoqërisë.

- Në kuadër të punës për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura marrëveshjet e lidhura me klientët janë përmirësuar dhe përshtatur më mirë marrëdhëniet me grupet e klientëve, masën e debisë dhe planin e shlyerjes së saj.
- Plani i miratuar i investimeve jo vetëm do të plotësojë nevojat për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm të klientëve në mbarë vendin dhe zvogëlimin e kohës së ndërprerjeve dhe riparimit, por do të përmirësojë cilësinë e furnizimit dhe ndërtimin e një rrjeti të kontrolluar në parametra bashkëkohorë.
- Ndryshimet e fundit ligjore të shprehura në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe hapja e mëtejshme e tregut të energjisë elektrike diktojnë ndryshime të rëndësishme në pozitën monopol të OSHEE në shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike. Këto ndryshime janë programuar me kujdes në buxhetin e vitit 2016 dhe në programin 5 vjeçar të zhvillimit. Ndryshimet nuk do të prekin performancën pozitive ekonomiko - financiare të OSHEE edhe për 5 vjeçarin e ardhshëm.
- Shoqëria është në një proces riorganizimi dhe rikonceptimi total përsa i përket situatës financiare si dhe pozicionit të saj në sektorin energjitik ;

Vlen për tu përmendur dhe fakti që rezultati financiar i 4-mujorit 2016, ka sërish një tejkatim mbi atë të planifikuar dhe pritshmëria për treguesit e vitit 2016 është e përmirësuar edhe në krahasim me treguesit e buxhetuar.

#### Në përfundim:

Vijimësia e aktivitetit të Shoqërisë OSHEE sha, për rëndësinë që ajo ka në shpërndarjen e energjisë elektrike por edhe bazuar në përmirësimin e dukshëm të treguesve kryesorë, në masat e marra nga Administrimi e në veçanti nga Qeveria, garantojnë vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë dhe në të ardhmen e afërt daljen e saj me tregues pozitiv.



**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/ Lekë, përveçkur përmenendet ndryshe)*

**5. Aktivet Afatgjata Materiale**

Ndryshimet në zërat e Aktiveve Afatgjata Materiale për vitin 2015 paraqiten si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa dhe përmirësimi i tokave	Makineri dhe pajisje	Aktive të tjera	Total
Vlera Kontabël Bruto në 01 Janar 2015	1,030,908	3,685,151	31,815,471	1,209,344	37,740,874
Shtesa	-	94,149	1,026,584	317,727	1,438,460
Pakësime	-	-	-	(35,434)	(35,434)
Riklasifikim	-	-	837	(837)	-
Vlera Kontabël Bruto në 31 Dhjetor 2015	1,030,908	3,779,300	32,842,692	1,490,800	39,143,900
Amortizimi i Akumuluar në 1 Janar, 2015	-	(1,348,338)	(16,149,334)	(985,524)	(18,483,196)
Amortizimi	-	(219,148)	(1,749,810)	(86,461)	(2,052,445)
Vlera Kontabël Neto e Aktiveve të çregjistruara	-	-	-	-	-
Nxjerrja Jashtë Përdorimit	-	-	-	31,821	31,821
Riklasifikimet	-	-	(837)	837	-
Amortizimi i Akumuluar në 31 Dhjetor, 2015	-	(1,567,486)	(17,899,981)	(1,036,353)	(20,503,820)
AAI Neto në Përdorim në 31 Dhjetor, 2015	1,030,908	2,211,814	14,942,911	454,447	18,640,080

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Aktivitet afatgjata materiale neto në përdorim në 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Vlera kontabël neto e Aktiveve Afatgjata Materiale	18,640,080	19,257,678
Ndërtime në Proces	2,441,141	1,130,732
<b>Totali</b>	<b>21,081,221</b>	<b>20,388,410</b>

Gjatë vitit 2015 ka shtesë të AAM në një vlerë 230 mln lekë me shumë se shtesat e vitit të mëparshëm 2014. Po kështu edhe Ndërtimet në proces ka rritje me dyfishin e vitet të mëparshëm. Rritja e vlerës së Aktiveve, ka ardhur si rezultat i rritjes së investimeve në rrjetin shpërndarës të energjisë, në tension të mesëm e tension të ulët.

#### *Amorizimi*

Të dhëna për amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Afatgjata Jomateriale në 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

Amortizimi i llogaritur	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Amortizimi AAJM - menaxherial	27,088	32,207
Amortizimi AAM - menaxherial	2,052,445	2,914,466
<b>Shuma</b>	<b>2,079,533</b>	<b>2,946,673</b>
Amortizimi AAJM - Fiskal	32,851	25,394
Amortizimi AAM - Fiskal	1,725,078	1,809,752
<b>Shuma</b>	<b>1,757,929</b>	<b>1,835,146</b>
<b>Diferenca Menaxherial - Fiskal</b>	<b>321,604</b>	<b>1,111,527</b>

Amortizimi i AAM dhe AAJM llogaritet nga sistemi SAP në dy mënyra, menaxherial dhe fiskal. Në tabelën e mësipërme është rregjistruar amortizimi menaxherial, i cili ka pësuar rënie nga viti i mëparshëm për arsye të plotësimit të viteve të jetës të shumë aseteve të cilët janë amortizuar 100%.

Gjithashtu gjatë vitit 2015, janë nxjerrë jashtë përdorimit disa AAM (automjete) të cilat ishin shumë të amortizuara si fizikisht. Vlera e mbetur e këtyre AAM ka kaluar në rezultatit e vitit, ndërsa skrapimi i tyre është në proces.

Lista e pasurive të paluajtshme të shoqërisë është miratuar në pronësi me vendimi të Këshillit të Ministrave. Kalimi i titujve të pronësisë për tokën e ndërtesat nga KESH ShA, rregjistruar shumica e tyre në momentin fillestar, në pronësi të shoqërisë, akoma nuk ka përfunduar. Shoqëria kohët e fundit i ka intensifikuar përpjekjet e saj për të marrë këto tituj pronësie, por ka mundur të zotërojë vetëm një pjesë të këtyre titujve.

Inventarizimi i Aseteve, nisur gjatë vitit 2014, akoma nuk është përfunduar. Grupet e inventarizimit

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

në Drejtoritë Rajonale dhe Drejtoritë e Tensionit të Lartë kanë vazhduar punën për inventarizimin fizik të asetëve duke kryer deri në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015, rreth 50% të punës në terren dhe 30% të punës në krahasimin e inventarit fizik me atë kontabël. Ky proces po vazhdon rregullisht dhe pritet të finalizohet me krahasimin e inventarit fizik me atë kontabël për të nxjerrë diferencat e mundëshme dhe rezultatin përfundimtar të inventarizimit

#### 6. Aktivët Afatgjatë Jomateriale

Vlera neto e Aktiveve Afatgjatë Jomateriale në 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

	Marka Tregtare dhe Licenca	Të Paprekshme e në Proces	Totali 2015	Totali 2014
Vlera Bruto në 01 Janar, 2015	183,612	85,835	269,447	268,124
Shtesa	187,560	51,800	239,360	1,323
Pakësime	0	0	0	-
<b>Vlera Bruto, 31 Dhjetor, 2015</b>	<b>371,172</b>	<b>137,635</b>	<b>508,807</b>	<b>269,447</b>
Amortizimi i Akumuluar në 01 Janar 2013	(108,792)		(108,792)	(76,585)
Shtesa	(27,088)		(27,088)	(32,207)
Pakësime				-
<b>Amortizimi i Akumuluar në 31 Dhjetor 2015</b>	<b>(135,880)</b>		<b>(135,880)</b>	<b>(108,792)</b>
<b>Vlera Neto e Aktiveve Jomateriale, 31 Dhjetor 2015</b>	<b>235,292</b>	<b>137,635</b>	<b>372,928</b>	<b>160,656</b>

Vlerat e aktiveve jomateriale i referohen licencave të IT, SAP, Sistemin e Faturimit si edhe licencave të tjera për programe kompjuterike.

#### 7. Aktive Financiare

Vlera neto e aktiveve financiare në 31 Dhjetor 2015 dhe në 2014 është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të Arkëtueshme nga punonjësit	23,879	24,286
Zbritje për borxhin e keq	(21,643)	(21,703)
<b>Totali</b>	<b>2,236</b>	<b>2,584</b>

Aktivet financiare të kompanisë përbëhen nga dhënia e huave punonjësve të saj në vitet e mëparshme. Me kalimin e viteve një pjesë e kredimarrësve janë larguar nga Shoqëria duke mos pasur një adresë të saktë të tyre. Në kontabilitet janë njohur me detyrimin në 31.12.2015 minus zbritjet për kreditë e dhëna (borxhi i keq) e cila përfaqëson vlerën e palikujtuar dhe të provizionuar për punonjësit e larguar nga shoqëria.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

**8. Tatimi fitimi i shtyrë**

Tatim fitimi i shtyrë neto në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014, përbëhet si më poshtë :

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Provizjonet për kreditë e këqija	9,850,266	10,305,088
Provizjone të tjera	971,746	987,262
Zhvlersimi fiskal që tejkalon zhvlerësimin në PF	780,094	731,489
<b>Totali i Tatim fitimit të shtyrë</b>	<b>11,602,106</b>	<b>12,023,839</b>
Tatimi i shtyrë i tatueshëm i parregjistruar	(11,602,106)	(12,023,839)
<b>Tatimi i shtyrë i njohur</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Zbritjet përfaqësojnë efektin e taksave për zbritjet në llogaritë e arkëtueshme të dyshimta, zbritjet për huatë e dyshimta të punonjësve, rënien në vlerë të inventarit dhe zbritje të tjera të lidhura me debitorët.

Provizjonet e tjera përfaqësojnë efektin e taksave për provizjone të krijuara për çeshtje ligjore, kontrollet tatimore, etj.

Shoqëria nuk e ka njohur dhe as nuk e ka rregjistruar tatimin e shtyrë, për shkak të pasigurisë që ekziston në lidhje me rimarrjen e tatimit të shtyrë.

**9. Inventarët**

Të gjitha materialet të cilat përbëjnë inventarin e Shoqërisë përdoren për operacionet e mirëmbajtjes ditore ose përndërtimin e aktiveve të reja. Për materialet e përdorura në mirëmbajtje, konsumi vjetor është regjistruar në llogaritë kontabile përkatëse të shpenzimeve.

Në vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015, vlera e shpenzimeve të bazës materiale, karburanteve, kancelari etj., është 822,994 mijë lekë nga 700,529 mijë lekë në vitin 2014 .

Zhvlerësimi i inventarit gjëndje në 31 Dhjetor 2015 në vlerë totale 107,670 mijë lekë lidhet me vlerën e artikujve të përcaktuar si njësi të cilat vlerësohen se janë inventar me qarkullim të ngadalshëm dhe se mundësia e përdorimit të tyre është shumë e vogël.

Në fund të vitit 2015, është kryer inventarizimi i artikujve të stokut të magazinave dhe njëkohësisht janë evidentuar artikujt me qarkullim të ngadalshëm.

Kriteret për t'i klasifikuar si materiale me qarkullim të ngadalshëm kanë qenë: (i) vjetërsia e blerjes së tyre (kryesisht trashëguar nga viti 2012) ; (ii) njësi të papërdorshme në rrjetin aktual të shpërndarjes.

Kështu rënia në vlerë e inventarit gjëndje më 31.12.2015, është evidentuar për çdo artikull dhe sipas magazinave duke mbajtur procesverabale të veçanta për këtë proces.

Vlera e evidentuar më parë, 286,790 mln lekë, si rënie në vlerë e inventarit por që nuk kishte një analizë të saktë se për çfar grup e artikull materialesh ishte evidentuar, është rimarrë si veprim i kundërt i rënies në vlerë të kryer më parë.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

Balanca në inventar në 31 Dhjetor 2015 dhe në 2014 është si më poshtë:

	Më 31.12.2015	Më 31.12.2014
Artikuj Konsumi	2,571,440	1,247,294
Rënie në vlerë e inventarëve	(107,670)	(286,790)
<b>Totali</b>	<b>2,463,770</b>	<b>960,504</b>

Në fund të vitit 2015 është kryer inventarizimi i magazinave për materialet gjëndje. Nga komisionet e ngritura për këtë qëllim u nxorrën diferencat inventariale për çdo magazinë, të cilat ishin në vlera të vogla dhe që nuk përbënin objekt sistemimi në kontabilitet.

#### 10. Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e Arkëtueshme të Shoqërisë, përbëhen nga faturat e papaguara të energjisë elektrike dhe paraqiten si më poshtë:

	Më 31.12.2015	Më 31.12.2014
Llogari të Arkëtueshme	67,566,695	72,813,754
Minus: zbritje për llogaritë e Arkëtueshme	(60,336,149)	(63,148,953)
<b>Vlera neto e llogarive të Arkëtueshme</b>	<b>7,230,546</b>	<b>9,664,801</b>

Vlera e llogarive të Arkëtueshmeve është ulur në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i rritjes së vlerës së arkëtimit të faturave të energjisë. Janë krijuar lehtësira për konsumatorët dhe janë gjetur mënyra bashkëpunimi me ta, për pagesën e faturave koherente dhe detyrimeve të prapambetura.

Gjendja e klientëve në kontabilitet, në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015, ka difference, vlera 1,641,669 mijë lekë, më shumë se gjendja e klienteve në Billing System.

Gjatë vitit 2015, me Vendim të Këshillit Mbykqyrës është vendosur marrja në evidencë, sipas Vendimit të ERE-s, "Faturat sistemuese" të Dëmit Ekonomik lëshuar në periudhat 2008-2011, vlera 1,763,504 mijë lekë. Kjo vlerë ka çuar në paksimin e debisë së klientëve.

Në fund të vitit 2015, rezulton një diferencë, vlera 138,771 mijë lekë, ndërmjet Llogarive të Arkëtueshme në PF dhe debisë së Klientëve. Kjo vlerë (në llog.411800) përfaqëson fondet e arkëtuara pa adresë të saktë të klientit, trashëguar ndër vite. Megjithë angazhimin për indentifikimin e tyre, nuk është arritur të kalohet në kreditim të klientëve. Gjatë vitit 2015 është indentifikuar nga ky fond vlera 4,349 mijë lekë, gjithashtu është shtuar për vlerën 7,113 mijë lekë duke çuar vlerën shtesë (neto) në fund të periudhës për 2,764 mijë lekë.

## SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Një prezantim sipas kategorive të klientëve dhe periudhave të krijimit të gjendjeve, për vlerat e papaguara të llogarive të Arkëtueshme dhe provizionimi i tyre, më 31 Dhjetor 2015 paraqitet si me poshtë:

Klientet	Brenda afatit				1 vit e me shume	TOTAL
	30-90 dite	91-180 dite	181-360 dite			
Familjarë	2,691,446	967,048	683,837	1,500,088	33,133,943	38,976,362
Klientë privatë Instit. Publike e Buxhet	2,060,174	682,459	393,355	685,869	20,114,998	23,936,855
Gjendja Klienteve TOTAL	718,048	669,660	867,273	1,199,783	1,337,485	4,792,249
Zbritje për llogaritë e Arkëtueshme	5,469,668	2,319,167	1,944,465	3,385,740	54,586,426	67,705,466
		(1,002,858)	(1,361,125)	(3,385,740)	(54,586,426)	(60,336,149)

## Provizionimi

Provizionimi i klientëve është bërë sipas metodologjisë miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës, duke patu për bazë vjetërsinë e krijimit të gjendjes së klientëve.

Sipas metodologjisë përqindja e provizionit është si më poshtë:

- Llogaritë e arkëtueshme më të vjetra se 180 dite provizionohen në masën 100%
- Llogaritë e arkëtueshme më të vjetra se 61-180 ditë provizionohen në masën 70%
- Llogaritë e arkëtueshme më të vjetra se 31-60 ditë provizionohen në masën 30%
- Llogaritë e arkëtueshme 0-30 ditë provizionohen në masën 0%

Në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015, vlera e provizionit akumulativ, është më e vogël se ajo e fundvitit 2014, për vlerën 2,812,803 mijë lekë. Vlera pozitive e provizionit është rimarrë duke kaluar në të ardhura ndërsa vlera negative ka kaluar në shpenzime .

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

11. Të Tjera të Arkëtueshme

Llogari të tjera të Arkëtueshme paraqiten si me poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të Arkëtueshme ndaj personelit , neto	2,104	(4,027)
Debitorë të tjerë per jo energjinë, neto	8,084	8,154
Të Arkëtueshme nga shitja e materialeve	12,766	12,766
Shpenzime të parapaguara	117,300	95,365
Të tjera	216,857	69,404
<b>Totali</b>	<b>357,110</b>	<b>181,663</b>

Llogaritë e tjera të arkëtueshme neto, përmbajnë gjithashtu të arkëtueshmë sipas detajeve të mëposhtme, sipas vlerës së aktivitetit të krijuar dhe provizionimit të tyre :

a) Të Arkëtueshme ndaj personelit

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Te arkëtueshme nga personeli	4,401	(1,729)
Provizione te detyrimeve te personelit	(2,298)	(2,298)
<b>Totali</b>	<b>(2,104)</b>	<b>(4,027)</b>

Të Arkëtueshme nga punonjësit rrjedhin nga gjopa vënë punonjësve si rezultat i auditimit të brendshëm. Zbritjet lidhen me faktin që një pjesë e këtyre punonjësve janë larguar nga Shoqëria.

b) Të Arkëtueshme nga KESH sh.a. në bazë neto

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të Arkëtueshme nga KESH Sha	1,917,247	1,938,647
Zbritje për të Arkëtueshme nga KESH Sha	(1,917,247)	(1,938,647)
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Kjo vlerë rrjedh nga marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe KESH sh.a në pjesën e dytë të vitit 2008, kur të dy shoqëritë ishin në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë.

Kjo vlerë megjithëse është pranuar si balancë nga ndarja, akoma nga KESH ShA nuk është njohur si detyrim. Edhe kjo e drejtë nga KESH është përfshirë në problematikat për zgjidhje nga komisioni i posaçëm ngritur me Udhër të Kryeministrit.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

Diferenca nga viti i mëparshëm ka të bëjë më axhustimin e arkëtimeve e faturave të energjisë elektrike të para vitit 2007, të drejta këto për tu arkëtuar nga KESH që nga ndarja e shoqërive.

*(c) Të Arkëtueshme-të verbër me bazë neto*

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të Arkëtueshme- të verbër	3,038,536	3,048,213
Zbritje për të Arkëtueshme nga KESH Sha	(3,038,536)	(3,048,213)
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Ligji nr. 8098, datë, 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, jep mundësinë, përveç të tjerash, të reduktimit të çmimit për energjinë e blerë për Konsumim familjar ndaj personave të verbër. Ky ligj është zbatuar deri në Prill 2012, ku sipas ligjit Nr.26 datë 05.04.2012, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa ndryshime në ligjin Nr.8098 për të verbërit. Në mbështetje të Ligjit Nr.26 të Kuvendit të Shqipërisë doli VKM Nr.404 datë 20.06.2012, sipas të cilit të verbërit sipas kategorive do të kompesoheshin për faturën e energjisë me shtesë monetare në pensionin e tyre.

Dispozitat e mësipërme theksojnë qartë se personat të cilët kanë përfituar nga statusi i të verbërit paguajnë 20% të faturës së energjisë elektrike dhe diferenca prej 80%, paguhet nga shteti.

Në këtë mënyrë OSHEE sha, ka të drejtë të zbresë këtë diferencë prej detyrimeve që i paguhen shtetit. Detyrimet që Shoqëria i paguan shtetit janë detyrime fiskale të tilla si: TVSH, Tatimi mbi Fitimin dhe Taksa Kombëtare, pra diferenca e mësipërme duhet të zbritet nga këto detyrime.

Vlera e këti detyrimi 3,038,536 mijë lekë, megjithëse i provizionuar, pretendohet të përfitohet nga shteti nëpërmjet paksimit të detyrimeve tatimore dhe është përfshirë në problematikat për zgjidhje nga komisioni i posaçëm ngritur me Udhër të Kryeministrit.

*(d) Debitorë të tjerë që nuk lidhen me energjinë, neto*

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Klientë-lidhje të reja	5,828	5,708
Klientë- qira dhënie	2,103	2,266
Klientë - të tjerë	12,909	181
<b>Totali</b>	<b>20,840</b>	<b>8,919</b>

Klientët për lidhje të reja trashëgoohen që nga vitit 2009-2012 ndërsa efekti i vitit 2015 është vlera 121 mijë lekë e cila është arkëtuar në fillim të vitit 2016.

Vlera e Klientëve për qira përfshin detyrimet koherente të fundvitit 2015 dhe vlerën 941 mijë lekë të një klienti për detyrim të krijuar nga vitit 2014 dhe që ndiqet në proces gjyqësor.

Në klientët e tjerë është detyrimi dy shoqërive për arkëtimin nga shitja e skrapit në periudhën 2009-2010, edhe kjo në proces gjyqësor.



**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

*(e) Debitorëtë tjerë, neto*

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Debitorë të tjerë që nuk lidhen me energjinë	461,754	344,856
Zbritje për Debitorë të tjerë	(244,897)	(254,051)
<b>Totali</b>	<b>216,857</b>	<b>90,805</b>

Në vlerën e debitorëve përfshihen :

- Ekzekutime nga Njësitë Vendore per taksa e tarifa vlera 190,940 mijë lekë, Ekzekutime nga përmbarimi vlera 76,450 lekë, Garanci për ankime të taksave e tatimeve vlera 41,037 lekë, të cilat ndiqen me procese gjyqësore ;
- Vlera 149,708 mijë lekë për debitor pa adresë vendosur në proces shqyrtimi ;
- Detyrime të tjera nga punonjësit apo të tretë të cilat janë në proces arkëtimi.

**12. Mjete Monetare dhe ekuivalente me to**

Aktivët monetare në bilanc i korrespondojnë vlerave të mjeteve monetare në arkë e bankë, të përcaktuara si më sipër.

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Llogari bankare, arka dhe ngurtesuara	6,618,652	1,489,495
Para në tranzit	15	340,758
<b>Totali</b>	<b>6,618,667</b>	<b>1,830,253</b>

Gjendja e mjeteve monetare në bankë dhe në arkë në 31.12.2015 sipas llogarive bankare është si më poshtë vijon, në lekë, :

512110	Banka Raiffeisen në Lek	88,396,352
512111	Banka Raiffeisen në Euro	246,569
512112	Banka Raiffeisen në Dollare	144,423
512113	Banka Raiffeisen Arketimet në Lek	35,601
512120	Banka Kombetare Tregetare në Lek	173,946,988
512121	Banka Kombetare Tregetare në Euro	33,705
512122	Banka Kombetare Tregetare Arketimet në Lek	24,757
512130	Banka Intesa Sanpaolo në Lek	51,517,393
512131	Banka Intesa Sanpaolo në Euro	4,525,475
512139	Credins Ener Project në Lek	(144)
512140	Banka Credins në Lek	44,614,121
512141	Banka Credins në Euro	57,942
512142	Banka Credins Arketimet në Lek	4,265
512143	Credins bank në Lek	83,530,252
512144	Credins bank në Lek	599,099
512145	Credins Bank në Euro	4,009,754
512146	Credins bank escr në Euro	1,690,237,634

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

512147	Credins Bank në GBP	14,927
512148	Credins Project BB në Lek	400,000,000
512149	Credins Rec Doc Piu në Lek	574,537
512152	Banka Union Arketimet në Lek	15,012,377
512162	Banka Pro Credit në Lek	2,452,998
512182	Banka Tirana Arketimet në Lek	3,640,040
512190	Banka Societe General në Lek	(6,619)
512193	Banka Societe General Arketimet në Lek	1,132,485
512202	Banka Kombetare Greke Arketimet në Lek	0
512220	Veneto HQ në Lek	51,943,666
512221	Veneto arketime në Lek	55
512300	Llogari bankare te bllokuara per garanci në Lek	4,000,082,932
531100	Arka - në Lek	182,153
531200	Arka - EURO + usd	1,288,278
531300	Arka - USD	409,828
581000	Transferime te brendshme në Lek	15,439
	<b>Totali</b>	<b>6,618,667,279</b>

Llogaria 512300, në vlerën totale 4,000,082,932 leke, ka të rregjistruar depozita të vendosura në bankë si dhe garancitë e vendosura, si më poshtë në lekë :

Garanci / Te ngurtesuara	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Banka Raiffeisen	20,506.02	20,506,.02
Banka Credins, në Lekë	3,035,198,426.00	30,000,000.00
Banka Credins, në Lekë	864,864,000.00	0.00
<b>Totali</b>	<b>3,900,082,932.02</b>	<b>30,020,506.02</b>

Depozita	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Banka Raiffeisen	35,000,000.00	0.00
Banka SGA	65,000,000.00	0.00
<b>Totali</b>	<b>100,000,000.00</b>	<b>0.00</b>

### 13. Kapitali Aksioner

Kapitali themeltar i shoqërisë është i pandryshuar në vlerë nga viti i mëparshëm. Shoqëria është themeluar më 19 Qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin Nr.862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 Dhjetor 2006. Kjo Kompani u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Shoqëria Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.

Më 29 Maj 2009, CEZ a.s, Pragë, u bë pronar i 76% të aksioneve të Kompanisë, 24% të aksioneve mbetën në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga METE.

Në Qershor 2014, Qeveria e Shqipërisë, lidhi Marrëveshje me CEZ a.s, për zgjidhjen me mirkuptim të çeshtjes së detyrimeve dhe të pronësisë (aksioneve). Kjo marrëveshje e miratuar me ligjin nr.114/2014 dt.31.07.2014, vendosi transferimin i aksioneve nga CEZ AS shtetit shqiptar, anulimin e të ardhurave të arkëtueshme (detyrimeve) dhe shumën e zgjidhjes me pajtim (detyrimi i ri ndaj CEZ AS).

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Më datën 23.10.2014, aksionet e Shoqërisë u rregjistruan 100% në pronësi të Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë e Sipërmarrjes, si aksioner i vetëm.

Më datë 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjistruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.

#### 14. Huamarrja

Shoqëria, ka detyrim për hua ndaj KESH sha dhe OST sha, si dhe detyrim afat gjatë ndaj CEZ a.s.

Huatë ndaj KESH sha, janë pjesë e detyrimeve që ju transferuan Shoqërisë, në momentin e ndarjes, KESH sha OSHEEsha (ish OSSH). Për këto hua, është lidhur marrëveshje afatgjatë ripagimi, të firmosur ndërmjet KESH dhe OSSH në 10 Mars 2009. Termat e huave ndryshojnë në varësi të maturitetit dhe normës së aplikuar të interesit.

Huaja ndaj OST sha, ka të bëjë me transferimin e N/Stacionit Kalimash në pronësi të OSHEE sha, sipas marrëveshjes së huasë me afat shlyerje 5 vite, për të cilën është mbyllur pagesa në vitin 2015.

Detyrimi afat gjatë ndaj CEZ a.s, përbën vlerën e marrëveshjes për zgjidhjen me pajtim të detyrimeve sipas ligjit nr.114/2014 dt.31.07.2014, me afat shlyerje për katër vitet, deri në vitin 2018. Në vitin e mbyllur, janë bërë pagesat përkatëse të detyrimit dhe interesit.

Norma mesatare e ponderuar e interesit, për të gjitha huamarrjet, në 31 Dhjetor 2015, për pjesën afatgjatë është 2.01% dhe për pjesën afatshkurtër të huave afatgjata, është 6.08%.

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014, normat e interesit ishin respektivisht 2.01 % dhe 6.08 %.

Huatë janë marrë dhe i detyrohen institucioneve të mëposhtme:

Huadhënësi	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
KESH (Huatë 1 deri 16)	10,817,850	11,090,870
OST (Huaja 17)	0	101,534
CEZ A.S (Huaja 20)	8,168,050	11,911,900
Interesi i përlogaritur	516,142	382,381
<b>Total</b>	<b>19,502,042</b>	<b>23,486,685</b>

Në PF, detyrimi ndaj CEZ a.s me 31.12.2015 tregon detyrimin e maturuar dhe është njohur për diferencë ndërmjet detyrimit total në fund të periudhës (sipas marrëveshjes) vlera 8,682,960 mijë lekë, dhe vlerës së interesit të pamaturuar përfshirë në detyrim, vlera 514,910 mijë lekë referuar llogarive (471400 & 410) "Shpenzime të përlogaritura ndaj CEZ për Interesa".

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Një listë e huave afatgjata (pjesa afatë gjatë e huasë), e ndarë sipas monedhës, normës së interesit dhe afatit të maturimit paraqitet si më poshtë vijon :

	Monedha	Norma interesit	Maturiteti	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2014
Hua 1	JPY	2.3%	16 Vjet	1,548,229	1,613,795
Hua 2	KRË	3.0%	24 Vjet	649,529	697,668
Hua 3	USD	0.3%	30 Vjet	1,170,409	1,123,844
Hua 4	XDR	3.1%	7 Vjet	86,551	256,889
Hua 5	USD	3.1%	7 Vjet	26,935	76,686
Hua 6	EUR	4.1%	4 Vjet	0	133,284
Hua 7	EUR	0.4%	31 Vjet	1,018,913	1,027,407
Hua 8	EUR	2.0%	5 Vjet	0	1,088
Hua 9	EUR	1.0%	20 Vjet	157,954	174,683
Hua 10	EUR	0.3%	30 Vjet	1,206,854	1,235,399
Hua 11	EUR	0.8%	30 Vjet	540,809	580,783
Hua 12	EUR	0.8%	34 Vjet	1,004,915	1,174,898
Hua 13	EUR	0.8%	6 Vjet	0	23,825
Hua 16	EUR	4.8%	15 Vjet	336,463	373,400
Hua 20	EUR	3.79%	4 Vjet	5,549,953	8,348,944
				<b>13,297,514</b>	<b>16,842,594</b>
				<b>6,204,528</b>	<b>5,722,228</b>
Pjesa Afatshkurtër e huave afatgjata				<b>6,204,528</b>	<b>5,722,228</b>
TOTAL Hua Afatgjata				<b>19,502,042</b>	<b>22,564,822</b>

Lista e kredive për pjesën afatshkurtër (përfshirë interesin e maturuar) është e detajuar si më poshtë vijon:

	Mon	Hua AfShk	Kalkulimi i penaliteteve për pagesa me vonesë
Huaja 1	JPY	755,491	Int. i huasë (2.30%) + 2 % mbi këstin/et e maturuar
Huaja 2	KRË	211,607	Int. i huasë (3.00%) + 2% mbi këstin/et e maturuar.
Huaja 3	USD	14,521	Int. i huasë (0.30%) + Lib 6 mujor + 1% mbi këstin/et e maturuar
Huaja 4	XDR	845,456	Int. i huasë (3.13%) + 1%
Huaja 5	USD	263,110	Int. i huasë. (3.13%) + Lib 6 mujor + 1%
Huaja 6	EUR	768,768	Int. i huasë. (2.00%) + 1.25% + Euribor
Huaja 7	EUR	12,006	Int. i huasë (0.40%) + 0.25% deri në 35 ditë, 5% më tepër se 35 ditë
Huaja 8	EUR	91,761	Int. i huasë (2.00%) + 0.25% deri në 35 ditë, 5% më tepër se 35 ditë
Huaja 9	EUR	44,151	Int. i huasë (1.00%) + 0.4% deri në 35 ditë, 5% më tepër se 35 ditë
Huaja 10	EUR	7,555	Int. i huasë (0.25%) + 0.25% deri në 35 ditë, 5% më tepër se 35 ditë
Huaja 11	EUR	91,783	Int. i huasë (0.75%) + Norma bazë <sup>1</sup> + 3% mbi këstin/et e maturuar
Huaja 12	EUR	148,487	Int. i huasë (0.75%) + Nor.a Bazë + 3% mbi këstin/e të e matur.
Huaja 13	EUR	163,636	Int. i huasë (0.75%) + Norma Bazë + 3% mbi këstin/et e maturuar
Huaja 16	EUR	168,575	Interes mesatar i bonove me maturitet 1V + 3%
Huaja 20	EUR	2,618,097	Interesi i llogaritur 3.79%
<b>Totali</b>		<b>6,204,528</b>	

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

---

*Detyrimi ndaj CEZ :*

*Detyrimi, sipas Marrëveshjes, në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015 :*

a. Principal - Detyrimi afat gjate, vlera	5,788,640
b. Principal Detyrimi afat shkurtër, vlera	<u>2,894,320</u>
<b>Totali Detyrimet sipas Marrëveshjes</b>	<b>8,682,960</b>

*Në vlerën e detyrimit, përfshihet edhe detyrimi për interesin i pamaturuar :*

a. Detyrimi afat gjate - interes	238,687
b. Detyrimi afat shkurtër - interes	<u>276,223</u>

**Totali Detyrimi për Interesin 514,910**

Në PF, detyrimi ndaj CEZ a.s me 31.12.2015 tregon detyrimin e maturuar dhe është njohur për vlerën 8,168,050 mijë lekë, diferenca ndërmjet detyrimit total në fund të periudhës (sipas marrëveshjes) vlera 8,682,960 mijë lekë, dhe vlerës së interesit të pamaturuar përfshirë në detyrim, vlera 514,910 mij lekë referuar llogarive (471400 & 410) "Shpenzime të përlogaritura ndaj CEZ për Interesa".

*Huatë ndaj KESH*

Interesi i maturuar, detyrim i papaguar në fund të periudhës (ndaj KESH ShA), vlera 516,142 mijë leke, është përfshirë në pjesën afat shkurtër të huave.

Pjesa afatshkurtër e Huave Afatgjata, ku përfshihet pjesa afatshkurtër e papaguar e viteve 2013, 2014, 2015 si dhe pjesa afatshkurtër e vitit 2016, është 5,688,386 mln lekë.

Detyrimet ndaj KESH sha, për principalin e huave dhe të interesave të maturuara gjatë vitit, nuk janë paguar. Kështu, në periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2015, shoqëria i detyrohet KESH-it, detyrime të mbetura pa paguar, vlerën 3,045,351 mije lekë, nga e cila 2,529,209 mijë lekë principal dhe 516,142 mijë lekë interesa të maturuara.

Diferencat e trashëguara në huatë nga KESH ShA, ndërmjet bilancit dhe detyrimit sipas Marrëveshjes, në përbushje edhe të rekomandimeve të Ekspertëve të PF të vitit 2014, janë sistemuar në një llogari detyrimi në shqyrtim duke saktësuar detyrimin me Marrëveshjen e njëkohësisht duke rakorduar me KESH ShA në fund të periudhës së mbyllur 2015.

Shoqëria nuk ka hua afat shkurtër.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

**15. Llogaritë e Pagueshme (Furnitorë)**

Llogaritë e pageshme të Shoqërisë paraqiten si vijon:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Blerje e energjisë nga KESH	37,470,596	37,890,972
Furnitorë të tjerë	1,395,398	1,535,844
Të tjerë furnitorë energjie nga importi	2,671,827	2,531,434.8
Kuota e trasmentimit (OST)	7,753,504	8,711,806
Furnitorë për investime	291,881	63,472
Furnitorë të huaj	31,240	79,127
Rivlerësimi i Furnitorëve	(27,470)	18,004
<b>Totali</b>	<b>42,586,976</b>	<b>50,830,661</b>

Shoqëria, energjinë për shitje konsumatorëve (tariforë), 4,459,444 Mëh, e ka blerë nga KESH ShA. Ndërsa energjinë për mbulimin e humbjeve, 2,035,422 Mëh, e ka blerë nga KESH-sha sasia 505,379 Mëh si dhe nga furnitorë të huaj sasia 1,530,043 Mëh (si EFT, GSA, GEN-I, Antix, Kurum, NOA, AXPO, etj.) sipas kontratave dypalëshe.

**16. Detyrime për taksat dhe sigurimet shoqërore**

Detajet e këtyre llogarive janë si vijon:

Detyrimi	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	84,201	68,870
Kuota e sindikatës	501	476
Tatimi mbi të ardhurat personale	38,629	14,676
TVSH e pageshme neto	211,186	364,287
Shteti Tatim Taksa	6,190,462	5,595,107
Të tjera	18,945	2,924
<b>Totali</b>	<b>6,543,924</b>	<b>6,046,339</b>

Detyrimet për sigurime, sindikatë, TAP dhe TVSh, janë detyrimet koherente për pagesë.

Detyrimet evidentuar për Tatime e Taksa, në vlerën 6,190,462 mijë lekë, përfshijnë kryesisht detyrimet për TVSh-në, Tatim Fitimin dhe gjobat sipas njoftim vlerësimeve tatimore të periudhave të mëparshme si dhe gjobat e mamatëvonesat nga SIT.

Detyrimet ndaj organeve tatimore në PF janë të njëjta me detyrimet sipas SIT.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

**17. Detyrime të tjera afatshkurtra**

Detyrime të tjera afatshkurtra lidhen me paga të pagueshme personelit, të pagueshme për Tarifën e TV si dhe me kreditorët e tjerë e shpenzimet e llogaritura, sipas ndarjes së mëposhtëme :

Detyrimi	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Paga të pagueshme	254,147	212,438
Taksa e televizorit	286,781	109,236
Kreditorë të tjerë	559,787	46,505
Shpenzime të llogaritura	13,557,689	15,210,443
<b>Total</b>	<b>14,659,404</b>	<b>15,578,622</b>

Rritja e vlerës së kreditorëve të tjerë në fund vitin 2015, nga fundviti 2014, ka të bëjë me kalimin në këtë llogari të diferencave të llogarive pa analiza, ku pjesa më e madhe është e diferencës së llogarive të huave ndaj KESH Sha.

Sistemimi i këtyre diferencave të llogarive janë bërë në bazë të Vendimit të Aksionarit të datës 29 Janar 2016.

Një ndarje e Shpenzimeve të Llogaritura sipas natyrës, paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Shërbime Poste dhe Telekomunikacioni	321,2013	334,907
Tarifa e Angazhimit të BERZH dhe IFC	0	34,252
Energji e përlllogaritur	8,032,637	8,708,061
Shërbimi i trasmetimit të energjisë	482,188	482,188
Të përlllogaritura të tjera	4,721,651	5,561,035
<b>Totali i Shpenzimeve të Llogaritura</b>	<b>13,557,689</b>	<b>15,210,443</b>

Shërbime Poste, si shpenzime të përlllogaritura, përbëhet kryesisht nga shërbime të kryera nga Posta Shqiptare, për arkëtim fature të energjisë elektrike e shërbime postare, kjo kryesisht për periudhën përpara vitit 2014.

Ka angazhim nga Qeveria për adresimin e këtij problemi dhe gjetjen e një zgjidhje për rakordimin e detyrimeve reciproke me Postës Shqiptare. Pas këtij momenti do të ketë edhe një evidentim të saktë të këtyre shpenzimeve.

**Energjia e përlllogaritur**,përbëhet nga kostot e blerjes së energjisë deri në fund të periudhës së mbyllur më 31 Dhjetor 2015, kjo përlllogaritur për furnitorët si më poshtë :

- KESH sha, vlera 8,032,637 mijë lekë ;
- EFT AG, vlera 306,644 mijë lekë ;
- GSA , vlera 482,156 mijë lekë ;

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

Shërbime, vlera e mbetur si shpenzim i përlogaritur në fund të periudhës, i përket kryesisht shërbimeve të ndryshme gjatë fundvitit 2015, verifikim matje, auditim PF, shërbim të ruajtjes fizike, e të tjera, faturat e të cilave kanë ardhur në fillim të vitit 2016.

Shërbimi i trasmetimit të energjisë nga OST sha, i përket shërbimit të kryer në vitin 2012 për një faturë të papranuar nga Shoqëria OSHEE.

Të përlogaritura të tjera, në ulje të vlerës gjatë vitit 2015, ka ndikim sistemimi i vlerës së përlogaritur për shpenzime të shoqërisë DIA. Shoqërinë DIA pati ngritur padi ndaj shoqërisë OSHEE duke pretenduar pagesë të kryerjes së disa shërbimeve të mbledhjes së borxhit. Gjykata e arbitrazhit (Vienna International Arbitral Centre), mori vendim në dhjetor 2015 duke vendosur përfundimin e procedurave të arbitrazhit. Në mbyllje të kësaj çështje, vlera e rregjistruar në vitin 2011 si shpenzim i përlogaritur është sistemuar në fund të vitit 2015.

Tabela e shpenzimeve të përlogarituar, sipas furnitorëve dhe shpenzimeve është si më poshtë :

<u>Nr.</u>	<u>Furnitori</u>	<u>Vlera</u>	<u>Pershkrimi</u>
1	KESH	(8,026,662)	Shpenzime per fatura energjie
2	KESH	(5,975)	Shpenzime per fatura energjie te H/C Lokale
3	KESH	(3,695,851)	Shpenzime per fatura penalitetesh te deri 2013
4	OST	(482,188)	Shpenzime per fatura transm energjie te 2012
5	EFT	(306,644)	Shpenzime per fatura energjie te paardhura 2015
6	GSA	(482,156)	Shpenzime per fatura energjie te paardhura 2015
7	3G	(29,708)	Shpenzime fatura kolaudim matje te paardhura 2015
8	Posta	(319,992)	Shpenzime fatura te arketimeve etj te paardhura
9	Audituesit	(56,000)	Sherbime auditimi PF, Fat.2015
10	Te tjerë	(152,513)	Shpenzime per fatura te paardhura te vitit 2015
	<b>Totali</b>	<b>(13,557,689)</b>	

## 18. Provigjionet

Ndarja e Provigjioneve në zëra është si më poshtë:

	<u>Më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>I përlogaritur</u>	<u>I përdorur</u>	<u>Më 31 Dhjetor 2015</u>
Përfitimet e pensionit	12,123	12,123	-	-
Provigjione të tjera	4,928,917	584,177	398,776	4,743,515
Çështje gjyqësore	1,565,682	635,654	804,762	1,734,791
Pushime të papaguara	75,026	75,026		
<b>Total i Provigj</b>	<b>6,581,748</b>	<b>1,306,980</b>	<b>1,203,538</b>	<b>6,478,306</b>
Provigj. afatshkurtra	6,569,625			6,478,306
Provigjione afatgjata	12,123			-

Pjesën kryesore të provigjionimit gjendje në fund të periudhës, e përbën vlera e përlogaritur për penalitete në periudhën deri fund 2012, ndaj KESH sha vlera 2,181,322 mijë lekë dhe ndaj OST sha, vlera 2,353,776 mijë lekë.



OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

19. Shitja e Energjisë

Të ardhurat e Shoqërisë paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Familjarët	24,318,011	22,678,469
Konsumatorët privatë	19,117,243	14,809,976
Entet qeveritare	6,322,123	5,442,649
Shitja totale e energjisë (e faturuar)	49,757,377	42,931,094
Tarifat e lidhjes (të faturuara)	645,104	480,858
<b>Totali</b>	<b>50,402,481</b>	<b>43,445,265</b>

Këtu janë evidentuar të ardhurat nga shitja e enegjisë elektrike dhe tarifa e lidhjeve të reja. Ndërsa të ardhurat nga qiratë dhe diferenca çmimi, janë klasifikuar tek kategoria e të ardhurave të tjera, shënimi më poshtë.

20. Të Ardhura të Tjera

Gjatë vitit 2015, të ardhurat e tjera të Shoqërisë janë të përbëra sipas tabelës më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Shërbimet	36,336	18,755
Të ardhura nga penalitetet për pagesa me vonesë	7,998,316	3,685,037
Të ardhura nga shitja e Aktiveve fikse	4	-
Të tjera	146,482	132,250
Qiratë	1,072	2,710
Të ardhura nga diferenca çmimi	372	1,515
<b>Totali</b>	<b>8,182,581</b>	<b>3,840,267</b>

Të ardhurat nga penalitetet për pagesat me vonesë përbëhet nga këto kategori të ardhurash :

- Kamatëvonesa, të ardhura nga shuarja me kompensim e detyrimeve, sipas VKM-ve, ndërmjet OSHEE ShA, KESH ShA dhe Ministrisë së Financave për Institucionet Buxhetore e Jo Buxhetore, vlera totale 4,048,302 mijë lekë ;
- Kamatëvonesa të paguara nga vetë klientët, vlera 3,946,147 mijë lekë, si dhe
- Penalitete paguar nga furnitorët për mosrespektim të kontratave, vlera 3,867 mijë lekë.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

**21. Blerje e energjisë elektrike**

Shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike për vitin 2014 klasifikohen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Energji elektrike - Nga KESH me çmim të rregulluar	13,378,333	9,489,270
Energji elektrike - Prodhim vendas me çmim tregu	654,053	206,348
Energji elektrike e importuar	12,381,553	20,250,518
<b>Totali</b>	<b>26,413,938</b>	<b>29,946,136</b>
Sasia e blerë në MëH	<b>6,494,866</b>	<b>6,935,245</b>

**Transmetimi i energjisë**

Energjia e blerë është transmetuar nga OST Sha dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015, shpenzimet për tarifën e transmetimit janë 3,968,787 mijë lekë nga 4,252,544 mijë lekë në vitin 2014.

**22. Shpenzime të personelit**

Ky zë përmban pagat dhe kontributet për sigurime shoqërore si dhe të tjera përfitime që mund të kenë patur punonjësit.

	2015		2014	
	Total	Stafi Menaxh.	Totali	Stafi Menaxh.
Paga bazë	2,767,256	2,060	2,276,820	367
Kompensime të tjera	840,357		594,789	
Kontributet e Sigurimeve shoqërore	562,443	-	470,582	-
<b>Totali</b>	<b>4,170,057</b>		<b>3,342,191</b>	<b>367</b>

Numri mesatar i punonjësve 5,762 4,931

Shpenzimet për paga të Stafit Menaxherial, janë ato të paguara për Këshillin Mbikqyrës të shoqërisë. Rritja e këtij shpenzimi vjen ngaqë gjatë vitit 2014 KM ka funksionuar vetëm për gati dy muaj.

**23. Shpenzime të tjera, neto**

Në këtë grup shpenzimesh, janë përfshirë shërbimet e tjera të blera nga palët e treta, qiratë, gjoba e penalitete ndaj tatimeve dhe sipas vendimeve gjyqësore, taksa e tarifa të tjera, provizione të krijuara për klientët e debitorët, të detajuara si më poshtë:

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Shërbime nga të tretë (të nënkontraktuar)	326,107	1,595,137
Posta dhe telefoni	49,547	69,174
Qera	334,486	290,226
Gjoha e penalitete	1,346,263	4,375,081
Krijimi dhe kthimi i Provigjionimeve tjera	436,822	79,171
Krijimi i Zbritjeve për Llogaritë e Arkëtueshme	(1,049,300)	230,172
Krijimi/(Rimarrja)izbritjeve për inventarët	(179,120)	-
Të tjera	264,532	389,660
<b>Totali</b>	<b>1,529,037</b>	<b>7,028,621</b>

**24. Shpenzimet Financiare, neto**

Shpenzimet financiare të Shoqërisë përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Shpenzime Interesi	(532,276)	(412,548)
Të ardhura nga depozitat bankare afatshkurtra	49,280	3,947
Të tjera shpenzime financiare (garancitë)	(475,595)	(440,521)
Rezultati neto nga diferencat e kursit	(378,757)	(295,168)
<b>Totali</b>	<b>(1,337,347)</b>	<b>(1,144,289)</b>

*a) Fitime nga kursi i këmbimit*

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Fitime nga kursi i këmbimit	458,108	68,553
Humbje nga kursi i këmbimit	(836,864)	363,721
<b>Totali</b>	<b>(378,757)</b>	<b>(295,168)</b>

*b) Fitime nga kursi i këmbimit*

Fitimet nga kursi i këmbimit vijnë si rezultat i efektit të ndryshimit të kurseve në llogaritë e mëposhtme:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2013
Depozita bankare	17,284	19,690
Furnitorë	120,013	11,780
Kredi	320,801	37,077
Overdrafte	-	-
Të tjera	10	5
<b>Totali</b>	<b>458,108</b>	<b>68,553</b>

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

c) Humbje nga kursi i këmbimit

Humbjet nga kursi i këmbimit vijnë si rezultat i efektit të ndryshimit të kurseve në llogaritë e mëposhtme:

	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2013
Depozita bankare	430,894	47,351
Furnitorë	46,040	19,362
Kredi	359,893	297,008
Overdrafte	-	-
Të tjera	37	0
<b>Totali</b>	<b>836,864</b>	<b>363,721</b>

25. Informacion mbi Palët e lidhura

Duke qenë shoqëri me kapital 100% shtetëror, marrëdhëniet me palët e lidhura përfshijnë aktivet dhe detyrimet që lidhen me shoqëritë me kapital shtetëror dhe institucionet buxhetore.

Aktivët afatshkurtra

*Të arkëtueshme nga Klientë*

Klientë	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Institucione dhe njësi të zotëruara nga shtetit	1,330,786	949,500
<b>Totali</b>	<b>1,330,786</b>	<b>949,500</b>

Të pagueshme tregëtare, detyrime të tjera, provizione

KESH ShA	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të pagueshme ndaj KESH pwr blerjen e energjisë	30,470,596	37,890,972
Shpenzime të llogaritura e të tjera për KESH	11,781,764	10,896,527
Provizion per gjobat nga KESH	2,181,322	2,181,322
<b>Totali</b>	<b>44,433,682</b>	<b>50,968,821</b>

OST ShA	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të pagueshme ndaj OST për tarifën e transmetimit	7,753,516	8,711,818
Shpenzime të llogaritura për OST	482,866	482,504
Provizion per gjobat nga OST	2,353,776	2,353,776
<b>Totali</b>	<b>10,590,158</b>	<b>11,548,098</b>

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
<b>Posta Shqipëtare</b>		
Të pagueshme tregtare ndaj Postës Shqiptare	723,070	803,964
Shpenzime të llogaritura për Posta Shqiptare	319,992	331,534
<b>Totali</b>	<b>1,043,062</b>	<b>1,135,498</b>
<b>Taksa e Tatime</b>		
Taksa të tjera të pagueshme	6,206,922	5,596,107
TVSH e pagueshme, neto	211,186	364,287
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	84,201	68,870
Tatimi mbi të ardhurat personale	38,629	14,676
Tatimi në burim	2,485	1,923
Të pagueshmet për taksën e televizionit	286,782	109,236
<b>Totali</b>	<b>6,830,205</b>	<b>6,155,099</b>
<b>Huatë</b>		
KESH ShA	11,333,992	11,473,251
OST ShA	0	101,535
<b>Totali</b>	<b>11,333,992</b>	<b>11,574,786</b>
<b>Të ardhura dhe Shpenzime</b>		
<b>Të Ardhura</b>		
Shoqëri publike	6,330,130	5,442,649
Të ardhura nga kamatëvonesat	4,048,302	941,884
<b>Totali</b>	<b>10,378,432</b>	<b>6,384,533</b>
<b>Shpenzime</b>		
KESH - tarifa të rregulluara e mbulim i humbjeve	15,966,773	9,694,498
Tarfa e transmetimit të energjisë	3,968,787	4,252,544
Shpenzime me Posta Shqiptare	494,036	490,620
Shpenzime interesi me KESH	125,069	181,013
Shpenzime interesi me OST	254	373
<b>Totali</b>	<b>20,554,919</b>	<b>10,366,504</b>

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

26. Llogaritja e Tatimit mbi Fitimin

Përbërësit e Tatimit mbi Fitimin të përllogaritur janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Tatimi mbi fitimin e llogaritur	(2,770,167)	(2,435,034)
Tatimi i shtyrë	-	-
<b>Totali</b>	<b>(2,770,167)</b>	<b>(2,435,034)</b>

	Ushtrimore 2015	Tatimore 2015
Të Ardhurat	58,585,062	58,585,062
Shpenzimet	(40,321,695)	(40,321,695)
Të panjohura		204,415
<b>Fitim / (Humbja)</b>	<b>18,263,367</b>	<b>18,467,782</b>
Tatim Fitimi (15%)		2,770,167
Tatim Fitimi Parapagimë		-
Tatim Fitimi për tu paguar		2,770,167

Të dhëna për shpenzimet e panjohura sipas natyrës së shpenzimit, janë si më poshtë, në lekë :

Shpenzimet e panjohura :	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Blerje energjie	1,904,875	11,251,154,474
Uje	1,965,014	1,284,316
Diferenca Kursi & Inventar	-	8,222,814
Shpenzime nga shërbime tjera	1,102,275	10,032,583
Shpenzime ligjore e permbarimore	94,062,400	258,704,921
Shërbime udhëtim/djeta	-	5,620,945
Shpenzime Postare e te arketimit faturave	(1,821,125,872)	34,581,888
Shpenzime per Taksa	1,868,678	57,142,086
Shpenzime per dhurata /	1,404,800	-
Shpenz. Penalitete, Gjoha e Demshperblime	1,346,262,671	4,375,081,356
Shpenzime Financiare	1,046,963,414	853,068,707
Amortizim AQT	321,604,363	1,111,526,696
Shuma te parashikuara per shpenzime	(791,597,815)	342,588,020
<b>Totali</b>	<b>204,414,803</b>	<b>18,309,008,807</b>

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

Diferencat ndërmjet shpenzimeve dhe tatimit mbi fitimin, të llogaritura sipas normës ligjore dhe shpenzimeve të tatimit mbi fitimin të siguruar nga fitimet para tatimit janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Të ardhurat përpara tatimit mbi fitimin	18,263,367	2,075,452
Norma ligjore e tatimit mbi fitimin në Shqipëri	15%	15%
Llogaritja e "parashikuar" e tatimit mbi fitimin	2,739,505	311,318
Efekti tatimor i:	18,263,367	2,075,452
Ndryshime në normën ligjore dhe fiskale	0%	0%
Shpenzime të pazbritshme	204,415	18,309,009
Të ardhura të tatuara ose të përjashtuara	-	-
Rregullime në lidhje me tatimin aktual mbi fitimin për periudhat e mëparshme	-	-
Ndryshimi në taksat e shtyra të Arkëtueshme e të paregjistruara	-	-
<b>Tatimi mbi të ardhurat</b>	<b>(2,770,167)</b>	<b>(2,435,034)</b>
<b>Norma efektive e tatimit mbi fitimin</b>	<b>-1500%</b>	<b>-117.33%</b>

#### Tatim mbi fitimin Aktiv/Detyrim

Tatimi mbi Fitimin Aktiv/ Detyrim në 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014:

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
<b>Tatimi mbi fitimin e Shoqërisë i arkëtueshëm/(Detyrimi)</b>		
Çelja	(2,835,034)	(556,976)
Parapagimet/Pagesa	1,455,000	156,976
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(2,770,167)	(2,435,034)
Kompesim detyrimesh	39,218	0
<b>Gjendja në fund</b>	<b>(4,110,983)</b>	<b>(2,835,034)</b>

Gjatë vitit 2015 nuk janë kryer parapagim për tatim fitimin e periudhës së mbyllur.

Është bërë pagesë vlera 1,455,000 mijë lekë për detyrimin e tatim fitimit të periudhës 2014 si dhe është bërë kompensim i detyrimit të Tatim Fitimit me pagesat nga Albpetroll në vlerën 39,218 mijë lekë, sipas miratimit nga DRTTM.

Gjendja në fund, vlera 4,110,983 mijë lekë, përfaqëson detyrimin për tu paguar ndaj Tatimeve për: tatimin mbi fitimin e mbetur pa paguar nga vitit i mëparshëm, vlera 1,340,816 mijë lekë dhe Tatim Fitimin si detyrim i periudhës 2015, vlera 2,770,167 mijë lekë.

**OSHEE SH.A**  
**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015**  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

**27. Menaxhimi i kapitalit**

Një nga qëllimet kryesore të Shoqërisë mbetet ruajtja e një prirjeje pozitive dhe për të përmirësuar përfitimet e Shoqërisë, jo vetëm për mbështetjen e planeve të investimeve, por edhe për konsolidimin e mëtejshëm dhe stabilizimin e strukturës së kapitalit në vitet në vijim.

	Më 31 Dhjetor 2015	Më 31 Dhjetor 2014
Totali i borxhit afatgjatë	13,297,514	16,842,594
Totali i huasë afatashkurtër	6,204,528	5,722,228
<b>Totali i borxhit</b>	<b>19,502,041</b>	<b>22,564,822</b>
Më Pak: Aktive Monetare	(6,618,667)	(1,830,253)
<b>Totali i borxhit, neto</b>	<b>12,883,374</b>	<b>20,734,569</b>
Humbja përpara tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave të tjera (Shpenzime)	19,600,714	(931,162)
Plus: Zhvlerësimi dhe amortizimi	2,079,534	2,946,673
Humbja para Interesave, tatimit mbi fitimin, zhvlerësimit dhe amortizimit	21,680,248	2,015,511
Kapitali Aksioner total	(52,755,156)	(71,248,356)
Borxhi total	19,502,041	22,564,822
<b>Kapitali total</b>	<b>(36,253,115)</b>	<b>(48,683,534)</b>
<b>Raporti Borxhi/Kapital</b>	<b>- 53,79 %</b>	<b>- 46.35%</b>

**28. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara**

*Angazhimet e qerasë operacionale - Shoqëria si qeramarrës*

Shoqëria ka firmosur marrëveshje të qirave operative, në lidhje me disa ndërtesa. Kontratat e qirave kanë një jetëgjatësi mesatare midis 1 viti deri në 3 vjet dhe me opSION rinovimi.

Nuk ka kufizime të vendosura mbi qiramarrësin që rrjedhin nga këto marrëveshje qiraje.

Shpenzimet e qirave operative në periudhën korrente (viti 2015), për ndërtesat janë 201,733 mijë lekë.

Gjithashtu ka kontratë qiramarrje për automjete me afat 3 vjeçar me të drejtë rinovimi.

Shpenzimet e qirave në periudhën korrente (viti 2015), për automjetet janë 131,479 mijë lekë. Për periudhën e vitit në vazhdim 2016 deri në përfundim të kontratës në fund të muajit Shkurt 2017, shpenzimet do të jenë 130,303 mijë lekë.



OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)

---

*Detyrimet e kushtëzuara - Çështjet ligjore*

Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria është përfshirë në çështje të ndryshme ligjore. Shoqëria kryen vlerësimin e probabilitetit të të fituarit apo humbjes së çështjeve dhe në rastet kur është e mundur që të ndodhë një dalje fluksesh monetare, atëherë krijon provizionet për shpenzime.

Më 31 Dhjetor 2015 Shoqëria ka qenë e përfshirë në një numër çështjesh ligjore, me klientë konsumatorë të energjisë, ish-punonjës, Bashki e Komuna për taksa vendore etj.

Gjatë vitit 2015, shoqëria është paditur në 1888 çështje gjyqësore me një vlerë të pretenduar për 3,857 mln lekë. Për kundërshtimin e tyre janë angazhuar Juristët e shoqërisë por edhe Zyra Kosulence, duke çuar mundësinë e detyrimit për të paguar në më pak se gjysmën e pretendimit të paditësve.

Nga vlerësimi i probabilitetit të humbjes së çështjeve por edhe duke përlogaritur vlerën e mundshme të përfitimit nga paditësit, shoqëria ka përcaktuar provizionimin i çështjeve të ngritura në vitin 2015, vlera 805 mln lekë.

Gjithashtu janë ekzekutuar gjatë vitit 2015 vendime gjyqësore të çështjeve në gjykim deri në fund të vitit 2014, vlera 636 mln lekë, vlerë e cila ka qenë e provizionuar sipas viteve të ngritura të çështjeve gjyqësore dhe që gjatë vitit 2015 janë evidentuar si rimarrje të provizionit.

## 29. Ngjarje pas datës së bilancit

Me Vendim të Asamblesë së Aksionarit të datës 11 Maj 2016, është vendosur zbatimi i vendimit të Këshillit Mbikqyrës për rregjistrimin e vlerës së faturave sistemuese të dëmit ekonomik.

Në zbatim të këtij vendimi, në rregjistrat kontabël të vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2015, është bërë rregjistrimet i paskimit të klientëve dhe rimarrja e provizionimit të tyre, duke bërë sistemimet përkatëse në humbjet e akumuluar nga periudhat e mëparshme ku efekti mbi të cilën është zero.

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 74 dt.27.05.2015, për evidentimin dhe adresimin e problematikave të shoqërive të sistemit energjitik, gjatë periudhës Prill - Qershor 2016, është arritur evidentimi i detyrimeve reciproke të gjendjes më 31.12.2015, duke u finalizuar në akt rakordimet dypalëshe me shoqëritë KESH ShA dhe OST ShA.

Është intesifikuar puna në evidentimin e detyrimeve me shoqërinë Posta Shqipëtare ShA dhe pritet finanizimi i rakordimit e adresimi i diferencave të paidentuara.

Në fillim të muajit Maj 2016, është marrë nga Tatimet situata tatimore e gjendjes më 31.12.2015, ku ishin evidentuar detyrimet e shoqërisë sipas SIT.

Diferencat e ndërmjet rregjistrave kontabël të shoqërisë dhe situatës në SIT, u rregjistruan dhe janë përfshirë në PF të vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2015.

OSHEE SH.A  
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE  
Për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2015  
*(Shumat janë shprehur në000/lekë, përveç kur përmendet ndryshe)*

---

Gjatë vitit 2015 janë kryer procedurat e duhura për evidentimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve elektrike (tel), ku procedura përfundimtare është miratuar nga aksionari më 26 Maj 2016.

Në muajin Qershor 2016, është marrë informacioni nga Drejtoria Ligjore për statusin e çeshtjeve ligjore në proces, duke llogaritur për ta provizionimin përkatës e duke e marrë në evidencën kontabël në periudhën e mbyllur viti 2015.

Asambleja e Aksionarit ka vendosur më datën 29 Janar 2016, miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës për raportin e Ekspertëve të analizës së debitorve e kreditorve të viteve 2011-2014, Në bazë të këtyre vendimeve, u bënë sistemimet e llogarive debitore e kreditore për tepricat e rezultuara pa analizat përkatëse pasqyruar në PF të vitit 2014. Diferencat debitore u rregjistruan në llogarinë Debitorë në shqyrtim” ndërsa diferencat kreditore u rregjistruan në llogarinë “Kreditorë në shqyrtim”.

Në bazë të Vendimit të Këshillit Ministrave nr.317 dt.27.04.2016, duke filluar nga data 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjistruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.


Politikat ekonomiko-finaciare mbeten të pandryshuara. Angazhimi i strukturave organizuese dhe gjithë punonjëve është në nivele shumë të larta për realizimin e objektivave për vitin 2016.

---

# **PROÇEDURA Për Klasifikimin e Informacionit**


**Version 1.0**

## **Sektori i Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse**

 <b>OSHEE</b> <small>OPERATORI I SHPËRNDARJEVE      SE ENERGIJË ELEKTRIKE</small>	<b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve          Mbështetëse</b>  <b>Procedurë Operacionale</b>	<b>Version 1.0</b>
---	---	--------------------

<b>Roli</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Emri Mbiemri</b>	<b>Firma</b>	<b>Data e Firmosjes</b>
Autori	Shefe e Njësisë së Sistemeve Mbështetese dhe Parandalimit të Rrjedhjes së Informacionit	Eriselda Malaj		--/--/2016
Mbikëqyrësi i dokumentit	Drejtori i Drejtorisë së Qeverisjes së Korporatës	Ermal Gjinaj		--/--/2016
Sektori i Dokumentimit të Proçeseve dhe Përputhshmërisë	Shefe e Sektorit të Dokumentimit të Proçeseve dhe Përputhshmërisë	Erina Rexhepi		--/--/2016
Pjesëmarrës në përshkrimin e proçeseve	Këshilltar	Andi Erebara		--/--/2016
Struktura përgjegjëse për dokumentin	Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.	Johan Sterjo		--/--/2016
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	Drejtori i Departamentit të Zhvillimit të Biznesit	Altin Uka		--/--/2016
Autorizuesi I-rë	Drejtor i Divizionit të Administrimit të Koorporatës	Përparim Nebiaj		--/--/2016
Autorizuesi II-të	Administratori	Adrian Çela		--/--/2016

Drejtori i Drejtorisë/Departamentit/Divizionit përkatës, në përputhje me detyrat e tij funksionale, siguron zbatimin e procedurës së mëposhtme. Zbatimi korrekt i të gjitha pikave të këtij dokumenti është subjekt i kontrollit nga Auditi i Brendshëm. Respektimi i rregullave të punës do të monitorohet dhe cdo sjellje në kundërshtim me to do të jetë subjekt i masave disiplinore.

	<b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse Procedurë Operacionale</b>	<b>Version 1.0</b>
---	--	--------------------

## PËRMBAJTJA

1.	Hyrje .....	4
2.	Aplikimi.....	4
3.	Qëllimi .....	4
4.	Fjalori i termave.....	4
5.	Rolet dhe përgjegjësitë .....	5
6.	Struktura organizative.....	6
7.	Procedura .....	7
7.1	Nivelet e Klasifikimit.....	8
7.2	Kërkesat për mbrojtjen.....	9
7.3	Kërkesat e mbrojtjes për informacionet e klasifikuara .....	10
8	Aneksë .....	14
9	Baza Ligjore .....	15
10	Historiku I Rishikimeve të Dokumentit .....	16

## 1. Hyrje

Procedura operacionale jep një përshkrim të të gjithë hapave që duhen ndërmarrë nga të gjitha strukturat përgjegjëse brenda shoqërisë, të përfshira në proces, në mënyrë që të menaxhohet me efikasitet i gjithë procesi të cilit i referohet kjo procedurë.

## 2. Aplikimi

Këto politika aplikohen për të gjithë informacionet: të gjeneruara, të aksesuara, të modifikuara, të transmetuara, të ruajtura në format elektronike apo fizike.

Politikat për klasifikimin e informacionit vlen për të gjithë punonjësit e OSHEE SH.A.

## 3. Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë kriteret dhe kërkesat e mbrojtjes për informacionin e brendshëm të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A. (OSHEE SH.A.), si dhe të përcaktojë rolet dhe përgjegjësit për procesin e klasifikimit.

## 4. Fjalori i termave


**Informacioni** – dokumentimi i proceseve të marra nga dëshmitë e auditit dhe vlerësimi i tij në mënyrë objektive për të përcaktuar shkallën se sa të përmbushur janë kriteret e auditimit.

**Sistemet e sigurimit dhe menaxhimit të informacioneve (ISMS)**- politikat, procedurat, planet, proceset, praktikat, rolet, përgjegjësit, burimet dhe strukturat të cilat janë përdorur për të mbrojtur dhe ruajtur informacionin. Përfshin të gjitha elementet që shoqëria përdor për të menaxhuar dhe kontrolluar rreziqet e tyre të sigurisë së informacionit.

**Klasifikimi I Informacionit** – procesi i përcaktimit të nivelit të klasifikimit së informacionit.

**Zotëruesi i informacionit** –person ose entitet që i janë dhënë përgjegjësi formale për sigurimin e informacionit. Zotëruesit e informacionit janë përgjegjës formalisht për tu siguruar që asetet, informacionet janë të siguruara siç duhet kundër përdoruesve të paautorizuar.

**Mirëmbajtësi i të dhënave** - Kontrollues i nivelit të sigurisë për të siguruar që informacioni i shoqërisë OSHEE SH.A. është i mbrojtur, në bazë të politikave të përcaktuara nga zotëruesi i informacionit.

 <p>OSHEE OPERATORI I SHPËNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE</p>	<p><b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse</b></p> <p><b>Procedurë Operacionale</b></p>	<p><b>Version 1.0</b></p>
---	---	---------------------------

**Përdoruesit e Sistemit** - Përdorin informacionin e shoqërisë OSHEE SH.A. sipas rregullave të përcaktuara në këtë politikë.

**Menaxheri i Sigurisë** - Informon të gjithë përdoruesit e sistemit të informacionit OSHEE SH.A. rreth politikave dhe procedurave të klasifikimit të informacionit.

**Personat e autorizuar nga titullari me anë të një autorizimi.** - Titullari i kompanisë nëse informacioni është për palët e treta, për çdo informacion tjetër titullari i divizionit.

**Kriptografi** - është praktika e sigurimit të konfidencialitetit, integritetit, autenticitetit, disponibilitetit të informacionit të klasifikuar nëpërmjet enkriptimit dhe dekriptimit të tij.

**Enkriptim** - është procesi i transformimit të informacionit në mënyrë të tillë që të fsheh përmbajtjen e tij.

**Dekriptim** - është procesi i kundërt i kriptimit.

**Miratimi i akseseve** – komisioni i klasifikimit të informacionit do të përcaktojë edhe akseset përkatëse.

#### **Akronime:**


DTI	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
DAK	Divizioni i Administrimit të Koorporatës
ISMS	Sistemet e sigurimit dhe menaxhimit të informacioneve
OSHEE SH.A	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A.

## **5. Rolet dhe përgjegjësitë**

### **Zotëruesi i informacionit ka për detyrë të:**

- Përcaktojë nivelin e klasifikimit për informacionin specifik bazuar në fushën e tyre të përgjegjësisë,
- Rishikojë në mënyrë periodike nivelet e klasifikimit të informacionit për të siguruar që të dhënat e biznesit janë klasifikuar siç duhet në çdo kohë,
- Miratojë aksesin e informacionit në fushën e tyre të përgjegjësisë.

### **Mirëmbajtësi i të dhënave ka për detyrë të:**

	<b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse</b>  <b>Procedurë Operacionale</b>	<b>Version 1.0</b>
---	--	--------------------

- Kontrollon nivelin e sigurisë për të siguruar që informacioni i shoqërisë OSHEE SH.A. është i mbrojtur, në bazë të politikave të përcaktuara nga zotëruesi i informacionit,
- Monitoron nëse politikat e sigurisë kanë arritur qëllimin e tyre,
- Informon zotëruesit e informacionit në rast të ndonjë dobësie apo mangësie, të cilat mund të ndikojnë në konfidencialitetin, integritetin ose disponueshmërinë e informacionit të shoqërisë.

#### **Përdoruesit e Sistemit të Informacionit kanë për detyrë të:**

- Përdorin informacionin e shoqërisë OSHEE SH.A. sipas rregullave të përcaktuara në këtë politikë,
- Emërtojnë saktë informacionin e kompanisë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë politikë dhe rregullave të përcaktuara nga zotëruesit e informacionit,
- Përdorin informacionin e kompanisë vetëm për qëllime të përcaktuara të kompanisë,
- Raportojnë çdo përdorim të paautorizuar ose keqpërdorim të informacionit të kompanisë.

#### **Menaxheri i Sigurisë së Informacionit ka për detyrë të:**

- Informon të gjithë përdoruesit e sistemit të informacionit OSHEE SH.A. rreth politikave dhe procedurave të klasifikimit të informacionit,
- Realizojnë trajnime ndërgjegjësuese për përdoruesit të cilat do të sigurojnë zbatimin më efektiv të politikave të klasifikimit të informacionit.

## **6. Struktura organizative**

Pronësia e procedurës operacionale të punës, i përket Sektorit të Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse / Njësia e Sistemeve Mbështetëse dhe Parandalimit të Rrjedhjes së Informacionit pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në DAK.

Pozicioni i kësaj njësie, brenda strukturës së shoqërisë OSHEE SH.A. është si më poshtë:






## 7. Procedura

Në mënyrë që të ruaj konfidencialitetin e duhur, integritetin dhe disponueshmërinë e aseteve të informacionit, OSHEE SH.A. duhet të sigurojë që ato janë të mbrojtura kundër akseseve të paautorizuara, zbulimeve apo modifikimeve.

Llojet e ndryshme të informacionit kërkojnë masa të ndryshme të sigurisë në varësi të ndjeshmërisë së tyre.

Ky dokument përcakton një strukturë për klasifikimin e informacionit të OSHEE SH.A. si publike, të brendshme, konfidenciale ose sekrete.

	<b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse</b>  <b>Procedurë Operacionale</b>	<b>Version 1.0</b>
---	--	--------------------

## 7.1 Nivelet e Klasifikimit

Çdo informacion në OSHEE SH.A.do të klasifikohet në katër nivele:

- PUBLIKE
- I BRENDSHËM
- KONFIDENCIAL
- SEKRET


Përcaktimi i niveleve të klasifikimit në OSHEE SH.A është dhënë si më poshtë:

<b>Kategoria e Informacionit</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shembull</b>
<b>Publike</b>	Informacione që nuk kanë përmbajtje sensitive në lidhje me OSHEE SH.A, informacione të cilat janë publike ose mund të bëhen publike pa implikime për OSHEE SH.A. , klientët e OSHEE SH.A. dhe palëve të treta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Broshurat e kompanisë,</li> <li>• Njoftimet publike,</li> <li>• Raportet vjetore,</li> <li>• Buletinet,</li> <li>• Të tjera...</li> </ul>
<b>I Brendshëm</b>	Informacion sensitiv i cili është për përdorim të brendshëm në OSHEE SH.A. Informacionet e klasifikuar si të brendshme nuk duhet të dalin jashtë OSHEE SH.A. -së pa konfirmim nga titullari.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Politikat dhe procedurat e OSHEE SH.A.,</li> <li>• Struktura organizative e OSHEE SH.A.,</li> <li>• Diagramat e sistemit informative,</li> <li>• Dokumentacionet e sistemeve informative,</li> <li>• Të tjera...</li> </ul>

Kategoria e Informacionit	Përshkrimi	Shembull
<b>Konfidencial</b>	Informacioni që OSHEE SH.A. shkëmben me klientët e saj si pjesë e angazhimeve të tyre. Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial do të rezultojë në një shkelje marrëveshje konfidencialiteti me klientin.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhënat e planifikimit të burimeve,</li> <li>• Rezultatet e kërkimit të tregut,</li> <li>• Planet dhe strategjitë promovuese,</li> <li>• Strategjitë e Biznesit OSHEE SH.A.,</li> <li>• Planet financiare të OSHEE SH.A.,</li> <li>• Raportet e brendshme të auditit,</li> <li>• Kontratat.</li> </ul>
<b>Sekret</b>	Informacionet më sensitive të biznesit OSHEE SH.A., zbulime të paautorizuar apo modifikime, të cilat ndikojnë seriozisht kompanisë së OSHEE SH.A., konkurrencës dhe reputacionin të saj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrata speciale,</li> <li>• Detajet e sigurisë,</li> <li>• Informacioni i pagave,</li> <li>• Informacionet e tenderave,</li> <li>• Studimet e ndjeshme ekonomike,</li> <li>• Kostot               <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpenzimet për blerjen e energjisë</li> <li>○ Kostot e prodhimit të energjisë</li> <li>○ Kostot e shmangura</li> <li>○ Kostot e integruara të planifikimit të burimeve</li> <li>○ Kostot dhe normat e tjera</li> </ul> </li> <li>• Të tjera...</li> </ul>

## 7.2 Kërkesat për mbrojtjen

Çdo klasifikim tjetër përveç klasifikimit publike duhet të jetë i kufizuar në çdo kohë në të gjithë njësitë e OSHEE SH.A.. Akses për të parë një informacion të tillë duhet të kenë vetëm ata punonjës të cilët kanë të drejta nga titullari i kompanisë për të hyrë në informacion.

	<b>Sektori I Garantimit të Cilësisë dhe Sistemeve Mbështetëse</b>  <b>Procedurë Operacionale</b>	<b>Version 1.0</b>
---	--	--------------------

Të gjitha palët e treta dhe kontraktorët të cilët kanë akses në informacionet e biznesit OSHEE SH.A. të klasifikuar si të BRENDSHME, KONFIDENCIALE ose SEKRET si fillim duhet të nënshkruajë marrëveshje Mos-Deklarimi para se ti lejohet akses për këtë kategori informacioni.

Kërkesat më të detajuara të mbrojtjes së informacionit për secilën prej nivelet e përcaktuar për klasifikimet përcaktohen në pikën 7.3.

Kërkesat e mbrojtjes janë përcaktuar për fushat e mëposhtme:


- Ruajtja në formatin fizike.
- Rruajtja në formatin elektronik.
- Ruajtja në pajisje të lëvizshme (removable)
- Aksesim I informacionit
- Etiketimi
- Printimi
- Fax-imi
- Komunikimi me email(i brendshëm dhe i jashtëm)
- Komunikimi me mesazhe të çastit.
- Shkatërrimi në formë elektronike
- Shkatërrimi në formë letër

### 7.3 Kërkesat e mbrojtjes për informacionet e klasifikuara

Emërtimi	Publike	I Brendshëm	Konfidenciale	Sekrete
<b>Ruajtja në formë fizike.</b>	Nuk ka kërkesa të veçanta	Ruajtja e rregullt në mjediset fizike të OSHEE SH.A..	Duhet të ruhen në vende të mbyllura dhe të sigurta.  Çelësat duhet ti kenë në zotërim vetëm personat e autorizuar nga titullari me anë të një autorizimi. nga titullari me anë të një autorizimi.	Duhet të ruhen në vende të mbyllura dhe të sigurta.  Çelësat duhet ti kenë në zotërim vetëm personat e autorizuar nga titullari me anë të një autorizimi.


